



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

KURRIKULAT LËNDORE/PROGRAMET MËSIMORE

Klasa e dhjetë

Prishtinë, 2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 319/01B
Datë: 11/04/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit, nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 5 dhe Ligji nr. 04/L032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

1. Të zbatohet Plani dhe Programi lëndor për klasën e dhjetë të shkollës së mesme të lartë në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi duhet të zbatohet në të gjitha shkollat mesme të larta-klasët e dhjeta në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i datës: 3 gusht,2017, Ref. Nr.157/01B
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë dhe pas realizimit, identifikimit të gabimeve në programe lëndore të botuara për klasën e dhjetë të shkollës së mesme të lartë në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës, si dhe pasi që është i domosdoshëm shfuqizimi i atyre programeve me gabime dhe aprovimi i programeve të rishikuara, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
2. Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
3. Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
4. Departamentit të Inspektimit të Arsimit, MASHT;
5. Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar, MASHT;
6. Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, MASHT;
7. Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, MASHT;
8. Divizionit për Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore, MASHT;
9. Të gjitha Drejtorive Komunale të Arsimit;
10. Arkivit, MASHT.



Shqipëri Bytyqi,
Minister/MASHT

PËRMBAJTJA

Hyrje 6

Plani mësimor 7

1. FUSHA KURRIKULARE: GJUHË DHE KOMUNIKIM 9

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 1.1. Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 10
- 1.2. Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave natyrore) 19
- 1.3. Gjuhë angleze (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 26
- 1.4. Gjuhë gjermane (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 51
- 1.5. Gjuhë frënge (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 69

2. FUSHA KURRIKULARE: ARTE 77

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 2.1. Art figurativ (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 78
- 2.2. Art muzikor (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 92

3. FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË 100

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 3.1. Matematikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 101
- 3.2. Matematikë (Gjimnazi i shkencave natyrore) 114

4. FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT NATYRORE 129

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 4.1. Biologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 130
- 4.2. Biologji (Gjimnazi i shkencave natyrore) 139
- 4.3. Fizikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 152
- 4.4. Fizikë (Gjimnazi i shkencave natyrore) 164
- 4.5. Kimi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 177
- 4.6. Kimi (Gjimnazi i shkencave natyrore) 186
- 4.7. Gjeografi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 197
- 4.8. Gjeografi (Gjimnazi i shkencave natyrore) 210

5. FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE MJEDISI 222

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 5.1. Edukate qytetare (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 223
- 5.2. Histori (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor) 232
- 5.3. Histori (Gjimnazi i shkencave natyrore) 245

6. FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA 260

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

- 6.1. TIK (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 261

7. FUSHA KURIKULARE: EDUKATË FIZIKE, SPORTE DHE SHËNDET 270**Kurrikulat lëndore/programet mësimore**

7.1. Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësor dhe Gjimnazi i shkencave natyrore) 271

Hyrje

Në klasën e dhjetë kurrikulat lëndore/programe mësimore kontribuojnë në procesin e përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve duke i përgatitur për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktiv dhe për t'u bërë kompetent në zhvillimet shoqërore. Programet mësimore u mundësojnë nxënësve për t'u përgatitur për klasat në vazhdimësi, për studime të mëtutjeshme dhe inkuadruar me sukses në tregun e punës. Prandaj, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, shoqëror, socio - emocional dhe fizik.

Kurrikulat lëndore/programet mësimore të lëndëve mësimore të klasës së dhjetë janë hartuar për dy lloje të gjimnazeve, Gjimnazin e shkencave shoqërore – gjuhësore dhe Gjimnazin e shkencave natyrore. Ato janë hartuar për lëndët që janë përcaktuar me plan mësimor për shtatë fushat kurrikulare, Gjuhët dhe Komunikimi, Artet, Matematikë, Shkencat e Natyrës, Shoqëria dhe Mjedisin, Jeta dhe Puna, si dhe Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti.

Në këtë klasë mësimi edhe pse organizohet nëpërmjet lëndëve mësimore, mësimdhënësit/et duhet të bëjnë përpjekje që të bëjnë mësimdhënie të integruar duke i koordinuar planifikimet në mes vete. Mësimdhënësit/et duhet ndërlidhur mësimdhënien me situatat jetësore dhe me bazë konteksti, për t'iu mundësuar nxënësve që të kuptojnë drejt proceseve shoqërore dhe natyrore, marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu. Gjithashtu mësimdhënësit/et përmes mësimdhënies së secilës lëndë, përfshirë edhe mësimdhënësit e mësimimit me zgjedhje, edhe në këtë klasë të nxënësit duhet të bëjnë përpjekje që t'i zhvillojnë dhe arrijnë kompetencat që janë përcaktuar në shkallën e pestë të Kurrikulës.

Plani mësimor

Fushat e kurrikulës	Lëndet mësimore	Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore				
		Klasat			Totali për lëndë mësimore	Totali për fusha kurrikulare
		10	11	12		
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	4	4	4	12	27
	Gjuhë angleze	3	3	3	9	
	Gjuhë e dytë e huaj	2	2	2	6	
	Gjuhë të tjera	/	/	/	/	
Artet	Art muzikor	1	1	0	2	5
	Art figurativ	1	1	1	3	
Matematikë	Matematikë	3	3	2	8	8
Shkencat e natyrës	Biologji	2	/	/	2	10
	Fizikë	1	1	/	2	
	Kimi	2	/	/	2	
	Astronomi	/	/	/	/	
	Gjeografi	2	2	/	4	
Shoqëria dhe mjedisi	Edukatë qytetare	1	1	2	4	23
	Histori	2	2	3	7	
	Psikologji	/	2	2	4	
	Filozofi dhe Logjikë	/	/	3	3	
	Sociologji	/	2	3	5	
Jeta dhe puna	TIK	2	2	1	5	5
Ed.fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	2	2	2	6	6
Pjesa zgjedhore	Pjesa zgjedhore	2	2	2 ⁴	6	6
Totali – orë mësimore / minimale		30	30	30	90	90
Aktivitete jashtëkurrikulare						

Fushat e kurrikulës	Lëndet mësimore	Gjimnazi i shkencave natyrore				
		Klasat			Totali për lëndë mësimore	Totali për fusha kurrikulare
		10	11	12		
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	3	3	4	10	21
	Gjuhë angleze	2	2	2	6	
	Gjuhë e dytë e huaj	2	2	1	5	
	Gjuhë të tjera	/	/	/	/	
Artet	Art muzikor	1	/	/	1	2
	Art figurativ	1	/	/	1	
Matematikë	Matematikë	4	4	4	12	12
Shkencat e natyrës	Biologji	3	2	3	8	32
	Fizikë	2	3	3	8	
	Kimi	2	3	3	8	
	Astronomi	/	/	2	2	
	Gjeografi	2	2	2	6	
Shoqëria dhe mjedisi	Edukatë qytetare	/	/	/	/	6
	Histori	2	/	/	2	
	Psikologji	/	2	/	2	
	Filozofi dhe logjikë	/	2	/	2	
	Sociologji	/	/	/	/	
Jeta dhe puna	TIK	2	1	2	5	5
Ed.fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	2	2	2	6	6
Pjesa zgjedhore	Pjesa zgjedhore	2	2	2	6	6
Totali – orë mësimore / minimale		30	30	30	90	90
Aktivitete jashtëkurrikulare						

FUSHA KURRIKULARE: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave të
natyrës)

Gjuhë angleze (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Gjuhë gjermane (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Gjuhë frënge (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrja

Mësimi i lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasën e dhjetë, gjimnazi i shkencave shoqërore - gjuhësor, është i fokusuar në përvetësimin e njohurive kulturore e letrare, në formimin gjuhësor si individ e si qytetar. Programi për këtë klasë ndihmon formimin individual të nxënësit nëpërmjet leximit të teksteve të të gjitha llojeve, po kryesisht të veprave letrare të njohura nga Antika deri te letërsia e Rilindjes Evropiane por edhe te letërsitë e tjera. Kjo u bën të mundur nxënësve të krijojnë perspektivën historike të hapësirës kulturore e letrare. Përmes kësaj, favorizohet formimi i nxënësve si individë, duke i aftësuar ata edhe për përdorimin e gjuhës shqipe me qëllim të strukturimit më të mirë të mendimeve, gjykimeve e aftësive të tyre kreative. Nxënësit arrijnë të organizojnë mendimet e tyre dhe të prezantojnë me gojë e me shkrim probleme e tema kulturore dhe letrare. Niveli i përvetësimit të shkathtësive të komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) avancohet sipas kërkesave të klasës, shkallës dhe nivelit.

Nxënësit në këtë klasë avancojnë shkathtësitë e përdorimit të gjuhës për debate dhe ese; zhvillojnë shkathtësitë narrative (rrëfimi në tregim dhe roman) dhe shkathtësitë e përdorimit të gjuhës së figurshme, njohin diskurset e tjera letrare dhe joletrare. Nxënësit zotërojnë gjuhën si një medium për prezantim të informacioneve duke shprehur pikëpamje të përgjithshme.

Njohuritë e fituara nga trashëgimia kulturore kombëtare dhe botërore si dhe njohuritë e fituara përmes analizës së ideve e argumenteve përkatëse, kontribuojnë në formimin kulturor, intelektual , emocional dhe qytetar.

Gjuha trajtohet si bazë e të menduarit, komunikimit, të mësuarit dhe të shikuarit të botës si element thelbësor i identitetit dhe kulturës. Nxënësit duhet të zotërojnë shkathtësitë e gjuhës për të kuptuar idetë dhe informacionet, ndërveprimet shoqërore për të bërë hulumtime në të fushat tjera të mësimi, dhe për të shprehur veten në mënyrë të qartë dhe për të vlerësuar natyrën e shoqërinë.

Qëllimi

Programi i kësaj klase ka për qëllim përforcimin e arritjeve të mëparshme dhe zhvillimin e njësive të reja që kanë të bëjnë me gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe dhe të përbotshme. Të njëjtën kohë, nxënësi zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti, rrit nivelin e komunikimit me diskurset orale, letrare dhe joletrare duke synuar arritjen e kulturës së mendimit të pavarur.

Të gjitha këto duhet t'i shërbejnë nxënësit për arritjen e rezultateve lëndore dhe zhvillimin e kompetencave kryesore të Kurrikulës.

Temat dhe rezultatet

Nxënësit në Klasën e dhjetë duhet t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), nga temat e përcaktuara në tabelën e më poshtme. Temat kanë dalë nga konceptet dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) *Gjuhët dhe Komunikimi* për shkallën e pestë të Kurrikulës (Shk5), të cilat mund t'i shihni në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë

Shkathtësitë e komunikimit

- Të dëgjuarit dhe të folurit
- Të lexuarit
- Të shkruarit (Të gjitha temat realizohen nëpërmjet shkathtësive të komunikimit)

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Tekstet letrare dhe jo letrare	<ul style="list-style-type: none"> • Letërsi e vjetër shqipe: kultura, historia, religjioni, retorika, diskurset • Latiniteti - koncepti kulturor; Humanizmi dhe nacionalja • M. Barleti, • Gjon Buzuku • Diskursi biblik, letërsia kishtarë dhe etnia të tekstet e vjetra shqipe, 	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon kontekstin historik e kulturor të shkrimit të vjetër shqip, shkrimin si dokument dhe si kulturë letrare si dhe diskurset kulturore e ato letrare. - Identifikon aspekte të latinitetit e humanizmit në kulturën shqiptare krahas njohjes së elementeve të retorikës letrare dhe diskurseve. - Dallon diskursin historik, fiksional dhe retorik-heroik: përpunon <i>Parathënie</i>, komenton fragmente nga <i>Historia e Skënderbeut</i>. - Bën komente dhe analiza gjuhësore e kulturore të <i>Mesharit</i>: me fokus në disa nga parabolat e himnet religjioze ku del në pah diskursi i përkushtimit shpirtëror. - Dallon diskursin biblik brenda kulturës dhe letërsisë shqiptare duke fituar njohuri nga retorika, diskurset dhe zhanret e ndryshme.

	<ul style="list-style-type: none"> • Pjetër Budi • Frang Bardhi • Pjetër Bogdani • Jul Variboba • Bejtexhinjtë: N. Frakulla, H. Z. Kamberi e M. K. Çami • Epika gojore dhe hyrja në aventurë, balada dhe legjendarja, heroikja, historikja dhe mitologjikja shqiptare; • Balada dhe përralla shqiptare 	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon kontekstin kulturor të poezisë së Budit, letraren nga joletrarja, motivi biblik dhe atë etnik. - Njeh diskursi apologjik-retorik te <i>Apologjia e Skënderbeut</i>. - Dallon kontekstin e shfaqjes së veprës <i>Cuneus prophetarum</i>; interpreton fragmente nga <i>Të primit përpara letërorit, Krijimi i rruzullimit, Këngët e sibilave, Ligjërata</i> - Kupton kontekstin kulturor arbëresh dhe interpreton vargje nga <i>Gjella e Shën Mërisë Virgjër</i>, duke analizuar strukturën e ndërliqshme letrare, religjioze e gjuhësore. - Identifikon dimensionin kulturor, tematik e gjuhësor të bejtexhinjve. - Identifikon zhanrin e divanit, ritmin dhe diskursin personal te Frakulla, diskursin social dhe atë satirik te Kamberi dhe temën e dashurisë te M. K. Çami. - Dallon tiparet kryesore të epikës gojore/ aventurës në epikë; kupton heroiken, legjendaren dhe mitologjiken si diskurse nëpërmes aventurës së heroit te <i>Martesa e Halilit</i> - Dallon strukturat gjuhësore letrare e mitologjike nga ato historike. - Krahason karakteristika të baladës dhe përrallës shqiptare.
--	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Klasika indo-evropiane • Epi i Gilgameshit: • Klasika greke - Homeri • Eskili • Aristofani • Lirika greke; llojet dhe diskurset poetike-përkushtuese dhe personale • Aristoteli • Klasika latine - Virgjili • Letërsia e Mesjetës - esencat kulturore • Mistika persiane • D. Aligieri 	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon linjat kryesore të epikës indo-evropiane, - Dallon diskursin fantastik; temën e pavdekësisë, hyjnore, njerëzore e shtazore te Gilgameshi. - Identifikon klasikën greke përmes pjesëve të zgjedhura nga Homeri duke kuptuar esencën e epit, temën e luftës dhe të kthimit, nocionin e mitit dhe at të historisë. - Identifikon esencën e tragjedisë. - Identifikon esencën e komedisë. - Identifikon llojet letrare të odes, ditirambit, elegjisë, himnit, idilës; shembuj nga Safo dhe poetë të tjerë. - Krahason nocionin e poetikës, retorikës e tragjedisë sipas Aristotelit. - Identifikon elemente të vargut latin nga Virgjili /<i>Eneida</i>. - Identifikon tipare të temës, heroit e vargut të <i>Këngës së Rolandit</i> dhe Beowulfit dhe i krahason ato me ciklin e këngëve kreshnike për <i>Mujin e Halilin</i>. - Dallon poezinë mistike persiane dhe ndikimin e saj në letërsinë dhe kulturën shqiptare, shembuj nga Rumi. - Identifikon fillimin e letërsive nacionale dhe tonin alegorik të vargjeve alegorike nga <i>Ferri</i>.
--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • M. de Servantes • Teatri elizabetian /Shekspiri • Shfaqja e Klasicizmit • Imazhi poetik nga Lindja e Largët/haiku 	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton tipare të prozës së Kohërave Moderne. Ilustrime nga <i>Don Kishoti</i>. - Interpreton esencat e teatrit elizabetian - ilustrime nga <i>Hamleti</i> i Shekspirit, temat dhe heroi. - Identifikon nocionin e Klasicizmit përmes shembujve nga krijimtaria e Molierit. - Dallon strukturën poetike të haikut japonez nga vargjet e Bashosë duke bërë paralele letrare Perëndim-Lindje.
Gjuha figurative dhe jofigurative	<ul style="list-style-type: none"> • Elemente të diskursit letrar dhe joletrar, gjuha dhe letërsia (gjuha figurative dhe jofigurative e pranishme të tekste të ndryshme letrare dhe joletrare) 	<ul style="list-style-type: none"> - Krahason gjuhën e thjeshtë figurative dhe shprehjet letrare. - Dallon dhe përdor gjuhën figurative dhe jofigurative sipas tekstit të caktuar.
Kulturë, Kritikë	<ul style="list-style-type: none"> • Kultura religjioze dhe ajo letrare; • Kultura tradicionale/gojore dhe ajo e shkruar; • Diskursi kodifikues/etnik të Kanunit; • Konceptet/konteksti kulturor e letrar klasik (grek/latin), i Mesjetës dhe i Rilindjes Evropiane. 	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon kulturën religjioze nga ajo letrare. - Identifikon diskursit e ndryshme, kulturore, religjioze e letrare. - Dallon kulturën tradicionale nga ajo e shkruar. - Identifikon diskursin kodifikues/etnik të Kanunit. - Kupton konceptet dhe kontekstin kulturor e letrar grek/latin, të Mesjetës dhe të Rilindjes Evropiane. - Identifikon ditirambin, oden, himnin, komedinë, tragjedinë, poemën. - Dallon temat letrare nga letërsia e përbotshme dhe ajo kombëtare.
Sistemi gjuhësor	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuha standarde dhe gjuha e letërsisë, 	<ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i shqipes standarde nga gjuha e letërsisë.

	<ul style="list-style-type: none"> • Mbiemri/Ndajshtimi • Pikësimi dhe efektet letrare • Format e sentencave/ fjalive/ funksioni • Pjesët e ligjëratës dhe fjalia (funksioni morfosintaksor) • Fjalia dhe stili • Procesi i shkrimit • Eseja • Ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, • Trajtat e pashtjelluara të foljes • Gjuha te letërsia e vjetër dhe te krijimtaria gojore • Gjuha standarde dhe gjuha 	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i mbiemrit/ndajshimit dhe funksioneve të tij në tekste letrare dhe jo letrare. - Përdor pikësimin/drejtskrimin për efekte letrare. - Analizë e sentencave efektive dhe të kombinuara/ rishikimi i modeleve të sentencave bazike dhe hyrje në modelet e sentencave të reja. - Identifikimi i (i kohëpaskohshëm) i pjesëve të ligjëratës dhe funksioneve të tyre morfosintaksore. - Analizon stilistikën e fjalive të kombinuara e sentencave efektive duke sprovuar modelin e ri të sentencës/paragrafit. - Zhvillon strategjinë e shkrimit, si zgjerimi apo reduktimi i sentencës/paragrafit. - Shkruan lloje të ndryshme të esesë (auto/biografike dhe hulumtuese). - Kupton ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, shembuj nga letërsia e vjetër. - Praktikon trajtat e pashtjelluara të foljes. - Dallon gjuhën standarde nga gjuha e teksteve të vjetra shqipe dhe nga gjuha e folur. - Praktikon struktura të ndërliqshme
--	---	---

	e folur	gramatikore me shkrim e me gojë
--	---------	---------------------------------

Udhëzime metodologjike

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë metodat që vënë nxënësin në qendër të procesit të të nxënit duke i dhënë të nxënit edhe vlera aplikative. Të nxënit duhet të organizohet në atë mënyrë që të zhvillohen njëkohësisht të folurit, shkrimi dhe leximi në nivele të larta të komunikimit.

Procesi i mësimdhënies për këtë klasë bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit duhet t'i arrijnë kompetencat e tyre për klasë nëpërmjet të nxënit dhe qasjes së integruar. Metodrat, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e kompetencave.

Mësimdhënia duhet fokusuar në situata praktike të të nxënit të njohurive gjuhësore, letrare e kulturore duke u nxitur të komunikojnë së bashku, të përdorin qartë dhe rrjedhshëm gjuhën gjatë komunikimit në klasë dhe në jetën e përditshme. Puna organizohet në grupe e çifte por nxitet edhe puna individuale kreative.

Vëmendje e veçantë i kushtohet leximit: leximit analitik dhe atij të shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të teksteve të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nxit pavarësimin e nxënësve për leximin e teksteve letrare dhe joletrare. Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Gjuha shqipe është në lidhje të drejtpërdrejta me tema nga lëndët e tjera si edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arte, kulturë etj.

Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, burimet, formën dhe strategjinë në shërbim të zhvillimit të kompetencave gjuhësore të nxënësit.

Nxënësit duhet të nxiten të komunikojnë së bashku, të përdorin gjuhën qartë gjatë komunikimit në klasë dhe në jetën e përditshme për tema të ndryshme.

Udhëzimet për vlerësim

Për lëndën Gjuhë shqipe dhe Letërsi vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të

mësimnxënies. Vlerësimi për këtë lëndë nxënësve u siguron informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së rezultateve të lëndës për klasë por krahas kësaj ai bëhet pjesë e formimit të tyre intelektual.

Në këtë klasë vlerësimi duhet të përqendrohet në dallimet dhe krahasimet e elementeve letrare, gjuhësore e kulturore të kësaj periudhës nga Antikiteti e deri te Rilindja Evropiane, nga Meshari i Buzukut (1555) e deri te atmosfera pararomantike shqiptare. Vlerësimi i të shprehurit të qartë me gojë e me shkrim, i njohjes së kategorive gramatikore e kulturore, i shkrimit pragmatik e letrar, i stilistikës gjuhësore e letrare, bëhet synim parësor në këtë klasë. Vlerësimi duhet të fitojë vëmendje të veçantë edhe sa i përket zhvillimit të temës në tërësi duke u përqendruar në paraqitjen e qartë të ideve dhe aftësisë për t'i dhënë ato në mënyrë të përmbledhur.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Mësimdhënësi mund të përdorë të gjitha burimet, mjetet dhe materialet të cila ndihmojnë arritjen e rezultateve të lëndës dhe kompetencave të shkallës së pestë (Shk5).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrja

Mësimi i lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasën e dhjetë, gjimnazi i shkencave natyrore, është i fokusuar në përvetësimin e njohurive kulturore e letrare, formimin kulturor e gjuhësor si individ e si qytetar. Programi për këtë klasë ndihmon formimin individual të nxënësit nëpërmjet leximit të teksteve të të gjitha llojeve, po kryesisht të veprave letrare të njohura nga Antika deri te letërsia e Rilindjes Evropiane por edhe te letërsitë e tjera. Kjo u bën të mundur nxënësve të krijojnë perspektivën historike të hapësirës kulturore e letrare. Përmes kësaj, favorizohet formimi i nxënësve si individë, duke i aftësuar ata edhe për përdorimin e gjuhës shqipe me qëllim të strukturimit më të mirë të mendimeve, gjykimeve e aftësive të tyre kreative. Nxënësit arrijnë të organizojnë mendimet e tyre dhe të prezantojnë me gojë e me shkrim probleme e tema kulturore e letrare. Niveli i përvetësimit të shkathtësive të komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) avancohet sipas kërkesave të klasës, shkallës dhe nivelit.

Nxënësit në këtë klasë avancojnë shkathtësitë e përdorimit të gjuhës për debate dhe ese; zhvillojnë shkathtësitë narrative (rrëfimi në tregim dhe roman) dhe shkathtësitë e përdorimit të gjuhës së figurshme, njohin diskurset e tjera letrare dhe joletrare. Nxënësit zotërojnë gjuhën si një medium për prezantim të informacioneve duke shprehur pikëpamje të përgjithshme.

Njohuritë e fituara nga trashëgimia kulturore kombëtare dhe botërore si dhe njohuritë e fituara përmes analizës së ideve e argumenteve përkatëse, kontribuojnë në formimin kulturor, intelektual , emocional dhe qytetar.

Gjuha trajtohet si bazë e të menduarit, komunikimit, të mësuarit dhe të shikuarit të botës si element thelbësor i identitetit dhe kulturës. Nxënësit duhet të zotërojnë shkathtësitë e gjuhës për të kuptuar idetë dhe informacionet, ndërveprimet shoqërore për të bërë hulumtime në të fushat tjera të mësimin, dhe për të shprehur veten në mënyrë të qartë dhe për të vlerësuar natyrën e shoqërinë.

Qëllimi

Programi i kësaj klase ka për qëllim përforcimin e arritjeve të mëparshme dhe zhvillimin e njësive të reja që kanë të bëjnë me gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe dhe të përbotshme. Të njëjtën kohë, nxënësi zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti, rrit nivelin e komunikimit me diskurset orale, letrare dhe joletrare duke synuar arritjen e kulturës së mendimit të pavarur.

Të gjitha këto duhet t'i shërbejnë nxënësit për arritjen e rezultateve lëndore dhe zhvillimin e kompetencave kryesore të Kurrikulës

Temat dhe rezultatet

Nxënësit në Klasën e dhjetë duhet t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), nga temat e përcaktuara në tabelën e më poshtme. Temat kanë dalë nga konceptet dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) *Gjuhët dhe Komunikimi* për shkallën e pestë të Kurrikulës (Shk5), të cilat mund t'i shihni në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë.

Shkathtësitë e komunikimit

- Të dëgjuarit dhe të folurit
- Të lexuarit
- Të shkruarit (Të gjitha temat realizohen nëpërmjet shkathtësive të komunikimit)

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Tekstet letrare dhe jo letrare	<p>Letërsi e vjetër shqipe: kultura, historia, religjioni, retorika, diskurset, latiniteti, humanizmi</p> <p>M. Barleti,</p> <p>Gjon Buzuku</p> <p>Elemente të diskursi biblik</p> <p>Pjetër Budi e Frang Bardhi</p> <p>Pjetër Bogdani</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon kontekstin historik dhe kulturor të shkrimit të vjetër shqip, latinitetin e humanizmin, shkrimin si dokument dhe si kulturë letrare si dhe diskurset kulturore e ato letrare. - Dallon diskursin historik, fiksional dhe atë retorik-heroik: përpunon <i>Parathënie</i>, komenton fragmente nga <i>Historia e Skënderbeut</i>. - Kupton elemente të rëndësishme gjuhësore e kulturore të <i>Mesharit</i>. - Dallon diskursin biblik brenda kulturës dhe letërsisë shqiptare duke fituar njohuri nga retorika, diskurset dhe zhanret e ndryshme. - Dallon kontekstin kulturor të poezisë së Budit, letraren nga joletrarja, motivi biblik dhe atë etnik duke e krahasuar me diskursin apologjik-retorik të <i>Apologjia e Skënderbeut</i>. - Dallon kontekstin e shfaqjes së veprës <i>Cuneus prophetarum</i>; interpreton fragmente

	<p>Jul Variboba</p> <p>Bejtexhinjtë: N. Frakulla, H. Z. Kamberi e M. K. Çami</p> <p>Epika gojore dhe hyrja në aventurë, balada dhe legjendarja, heroikja, historikja dhe mitologjikja shqiptare;</p> <p>Balada dhe përralla shqiptare</p> <p>Epi i Gilgameshit:</p> <p>Klasika greke - Homeri</p> <p>Eskili, Aristofani, Aristoteli</p> <p>Lirika greke; llojet dhe diskutet poetike-përkushtuese dhe personale</p> <p>Nga Klasika Latine te Letërsia e Mesjetës – kultura dhe poetika</p>	<p>nga kjo vepër.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kupton kontekstin kulturor arbëresh dhe interpreton vargje nga <i>Gjella e Shën Mërisë Virgjër</i>, duke analizuar strukturën e ndërliqshme letrare, religjioze e gjuhësore. - Identifikon dimensionin kulturor, tematik e gjuhësor të bejtexhinjve. - Identifikon zhanrin e divanit, ritmin dhe diskursin personal te Frakulla, diskursin social dhe atë satirik te Kamberi dhe temën e dashurisë te M. K. Çami. - Dallon tiparet kryesore të epikës gojore/aventurës në epikë; kupton heroiken, legjendaren dhe mitologjiken si diskurse nëpërmes aventurës së heroit te <i>Martesa e Halilit</i> - Krahason karakteristika të baladës dhe përrallës shqiptare. - Dallon diskursin fantastik; temën e pavdekësisë, hyjnore, njerëzore e shtazore te Gilgameshi. - Identifikon klasikën greke përmes pjesëve të zgjedhura nga Homeri duke kuptuar esencën e epit, temën e luftës dhe të kthimit, nocionin e mitit dhe atë të historisë. - Dallon esencën e tragjedisë e të komedisë dhe kupton nocionet e poetikës e retorikës sipas Aristotelit. - Identifikon llojet letrare të odes, ditirambit, elegjisë, himnit, idilës; shembuj nga Safo dhe poetë të tjerë. - Identifikon elemente të vargut latin nga Virgjili /<i>Eneida</i>, krahason tipare të <i>Këngës së Rolandit</i> dhe <i>Beowulfit</i> dhe i krahason ato me këngët për <i>Mujin e Halilin</i>. - Analizon elemente të poezisë mistike të Rumit dhe fokusohet në vargun e D. Aligjerit (<i>Komedia Hyjnore</i>) te <i>Ferri</i> dhe fillimin e letërsive nacionale.
--	--	--

	Teatri elizabetian (Shekspiri), Servantesi dhe Haiku	<ul style="list-style-type: none"> - Nxjerr paralele letrare mes teatrit elizabetian - (ilustrime nga <i>Hamleti</i> i Shekspirit) dhe Haiku japonez (Basho). Interpreton prozen e Servantesit; ilustrime nga <i>Don Kishoti</i>.
Gjuha figurative dhe jofigurative	Gjuha figurative dhe jofigurative e pranishme të tekste të ndryshme letrare dhe joletrare	<ul style="list-style-type: none"> - Krahason gjuhën e thjeshtë figurative dhe shprehjet letrare. - Dallon dhe përdor gjuhën figurative dhe jofigurative sipas tekstit të caktuar.
Kulturë, Kritikë	<p>Kultura religjioze dhe ajo letrare; Kultura tradicionale/gojore dhe ajo e shkruar;</p> <p>Diskursi kodifikues/etnik të Kanuni;</p> <p>Konceptet/konteksti kulturor e letrar klasik (grek/latin), i Mesjetës dhe i Rilindjes Evropiane.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon kulturën religjioze nga ajo letrare. - Dallon diskutet e ndryshme, kulturore, historike e letrare. - Dallon kulturën tradicionale (gojore) nga ajo e shkruar. - Identifikon diskursin kodifikues/etnik të Kanunit. - Shpjegon konceptet dhe kontekstin kulturor e letrar grek/latin, të Mesjetës dhe të Rilindjes Evropiane. - Identifikon ditirambin, oden, himnin, komedinë, tragjedinë, poemën. - Dallon temat letrare nga letërsia e përbotshme dhe ajo kombëtare.
Sistemi gjuhësor	<p>Gjuha standarde dhe gjuha e letërsisë,</p> <p>Mbiemri/Ndajshtimi</p> <p>Pikësimi dhe efektet letrare</p> <p>Pjesët e ligjëratës dhe fjalia (funksioni morfosintaksor)</p> <p>Fjalia dhe stili</p> <p>Procesi i shkrimit</p> <p>Eseja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon shqipen standarde nga gjuha e letërsisë. - Identifikon mbiemrin/ndajshtimin dhe funksionet e tij në tekste letrare dhe jo letrare. - Përdor drejtshkrimin dhe pikësimin për efekte letrare. - Identifikon (kohëpaskohshëm) pjesët e ligjëratës dhe funksionin e tyre morfosintaksor. - Bën analizë stilistike të fjalive të kombinuara. - Zhvillon strategji të shkrimit, si zgjerimi apo reduktimi i sentencës/paragrafit. - Shkruan lloje të ndryshme të esesë (auto/biografike dhe hulumtuese).

	<p>Ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes,</p> <p>Trajtat e pashtjelluara të foljes Gjuha te letërsia e vjetër dhe te krijimtaria gojore</p> <p>Gjuha standarde dhe gjuha e folur</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, shembuj nga letërsia e vjetër. - Përdor trajtat e pashtjelluara të foljes. - Dallon gjuhën standarde nga gjuha e teksteve të vjetra shqipe dhe nga gjuha e folur. - Praktikon struktura të ndërliqshme gramatikore me shkrim e me gojë.
--	--	--

Udhëzime metodologjike

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë metodat që vënë nxënësin në qendër të procesit të të nxënit duke i dhënë të nxënit edhe vlera aplikative. Të nxënit duhet të organizohet në atë mënyrë që të zhvillohen njëkohësisht të folurit, shkrimi dhe leximi në nivele më të larta të komunikimit.

Procesi i mësimdhënies për këtë klasë bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit duhet t'i arrijnë kompetencat e tyre për klasë nëpërmjet të nxënit dhe qasjes së integruar. Metodrat, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e kompetencave.

Mësimdhënia duhet fokusuar në situata praktike të të nxënit të njohurive gjuhësore, letrare e kulturore duke u nxitur të komunikojnë së bashku, të përdorin qartë dhe rrjedhshëm gjuhën gjatë komunikimit në klasë dhe në jetën e përditshme. Puna organizohet në grupe e çifte por nxitet edhe puna individuale kreative.

Vëmendje e veçantë i kushtohet leximit: leximit analitik dhe atij të shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të teksteve të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nxit pavarësimin e nxënësve për leximin e teksteve letrare dhe joletrare. Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Gjuha shqipe është në lidhje të drejtpërdrejta me tema nga lëndët e tjera si edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arte, kulturë etj.

Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, burimet, formën dhe strategjinë në shërbim të zhvillimit të kompetencave gjuhësore të nxënësit.

Nxënësit duhet të nxitin të komunikojnë së bashku, të përdorin gjuhën qartë gjatë komunikimit në klasë dhe në jetën e përditshme për tema të ndryshme

Udhëzimet për vlerësim

Për lëndën Gjuhë shqipe dhe Letërsi vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi për këtë lëndë nxënësve u siguron informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së rezultateve të lëndës për klasë por krahas kësaj ai bëhet pjesë e formimit të tyre intelektual.

Në këtë klasë vlerësimi duhet të përqendrohet në dallimet dhe krahasimet e elementeve letrare, gjuhësore e kulturore të kësaj periudhës nga Antikiteti e deri te Rilindja Evropiane, nga Meshari i Buzukut (1555) e deri te atmosfera pararomantike shqiptare. Vlerësimi i të shprehurit të qartë me gojë e me shkrim, i njohjes së kategorive gramatikore e kulturore, i shkrimit pragmatik e letrar, i stilistikës gjuhësore e letrare, bëhet synim parësor në këtë klasë. Vlerësimi duhet të fitojë vëmendje të veçantë edhe sa i përket zhvillimit të temës në tërësi duke u përqendruar në paraqitjen e qartë të ideve dhe aftësisë për t'i dhënë ato në mënyrë të përmbledhur.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Nga mësimdhënësi mund të përdoren të gjitha burimet, mjetet dhe materialet të cila ndihmojnë arritjen e rezultateve të lëndës dhe kompetencave të shkallës së pestë (Shk5).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë angleze (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Introduction

Learning is a complex process of discovery, collaboration, and inquiry facilitated by language. Composed of interrelated and rule/governed symbol systems, language is a social and uniquely human way of representing, exploring, and communicating meaning. Language is essential for forming interpersonal relationship, understanding social situations, extending experiences, and reflecting on thought and action. Language is the primary basis of all communication and the primary instrument of thought. It is an essential tool in the development of all six competencies foreseen in the Kosovo Curriculum Framework.

Consequently, the program of English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Learners' background knowledge, skills and attitudes will be used as a means of developing communicating abilities: interpreting, expressing and negotiating meaning through oral and written texts. As the learners develop communication skills, they also increase their linguistic accuracy and develop language learning strategies.

In the English language program learners will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

- interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).
- patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artefacts and symbols (culture).
- sounds, written symbols, vocabulary, grammar and discourse (language).
- cognitive, socio-affective and meta-cognitive process (general language education).

Learners will learn to communicate in English through the process of 'comprehension', 'production' and 'negotiation'. **Comprehension** involves deriving meaning or significance from an oral or written text. **Production** is expressing meaning by creating oral and written texts to suit different participants, topics, purposes, and reasons for communication. **Negotiation** is the *interaction process*: participants in the communication process must adjust to the needs and intentions of others. Integral to all three processes are the communicative intents or functions of communication, reporting or describing, persuading, or advocating and so on, which are developed in the experience / communication component. Learners will also learn about the language and how to use it: the sound – symbol system, vocabulary, grammar and discourse elements that are required to convey ideas and enhance communication in an oral or written context.

Goals

The long-term goals in the study of English language are cultural understanding and effective communication with representatives of various cultures worldwide. The development of cultural understanding and linguistic proficiency is a complex process involving a variety of language experiences and exposure to the culture of the people whose language is being studied. At this particular stage and grade learners should:

- reinforce, develop and deepen their language proficiency and language learning skills, gained at previous level, and should broaden them gradually, aiming at increasing language awareness and broadening their communicative ability.
- Develop an appreciation of the social, economic, political and linguistic factors that characterize the human experience across cultures.
- deepen the level of understanding of their own culture and other cultures, where English is spoken as a first, second, or an international language.
- apply the gained knowledge and skills in real-life circumstances, being aware of the world around them, interacting with people of their own and representatives of other cultures in a manner accepted in a civilised society.

Topical content and learning outcomes

Concept	Topics	Subject learning outcomes for topic
Literary & non-literary texts	Topic 1 Residence <ul style="list-style-type: none"> • Home & shelters • Amenities • Living outdoors 	<ul style="list-style-type: none"> • Listens /reads short recorded/print text (advertisements, brochures...) and extracts essential information and shares it with peers and teachers and school community • Understands and extracts the essential information from short, recorded passages on a range of topics • Listens/reads and extracts specific information and makes use of it in shaping his personal opinion (dates, figures) • Listens/views and understands the main points of broadcast on familiar topics and topics of personal interest and responds orally or in writing; • Understands the gist of TV news, interviews, announcements, and films without too much effort and responds orally or in writing. • Describes places, events and experiences with an improving accuracy and fluency • Compares and contrasts information extracted from electronic and print media and uses it in their own work • Demonstrates fair degree of competence in delivery needing some support from interlocutor (peers, teachers, and other speakers)

	<p>Topic 2</p> <p>Daily life</p> <ul style="list-style-type: none"> • Activities at home • School life & community activities • Paid jobs & volunteering • Fund-raising event: Talent show 	<ul style="list-style-type: none"> • Reads texts of fair complexity in English comparing the information found in sources in the mother tongue. • Listens/reads passages relating to specific topics and expands his vocabulary • Listens/reads and expands his knowledge and understanding developed in other school subject • Values paid jobs and community work by demonstrating initiative in planning such activities • Develops further his/her creativity by producing oral and written texts of reasonable length on topics of community and social interest and presents them to peers and teacher, and wider school community • Contributes to school events by participating in planning, conducting fund raising events for different target group beneficiaries
	<p>Topic 3</p> <p>Leisure & pleasure</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lifestyles • Media • Information, education/entertainment • My favourite book/author/film 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and makes use of information from various sources identifying relevant information • Discusses personal lifestyle comparing it to their peers' lifestyle in English speaking countries • Uses media for a range of purposes (information, education, entertainment) • Summarizes texts read in the source language (English or mother tongue) and translates them into the target language (mother tongue or English). • Demonstrates understanding that different media texts reflect different points of view; • Compares media texts from different sources concerning the same event or character and identifies similarities and differences; • Compares media texts in the target language and mother tongue identifying and depicting similarities and differences;

		<ul style="list-style-type: none"> • Produces media messages for different purposes and different types of intended audiences (commercials for specific products, for teenagers: boys/ girls; adults: men/ women; elderly)
<p>Topic 4</p> <p>Education & career</p> <ul style="list-style-type: none"> • Learning styles • Out-of-school learning • Education & learning resources • Career opportunities • Plans & ambitions • Education, investment for future 		<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and makes use of information from various sources identifying relevant information • Explores and identifies his preferred learning style and recognizes the value of experiential and self-directed learning • Uses a numbers of reading strategies before, during and after reading to understand more complex texts • Activates his prior knowledge, using visualization and, summarizing paragraphs during reading and synthesizing ideas to broaden understanding • Discusses career opportunities with peers, taking into consideration advantages and disadvantages of various options • Values the education opportunities and options provided by demonstrating readiness to engage in self-directed learning
<p>Topic 5</p> <p>Public services</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emergency services • Public security • Telecommunications • Healthcare 		<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and compares relevant information regarding public services throughout the world and draws conclusions relating to similarities and differences • Discusses the advantages and disadvantages of public services using appropriate terminology • Listens/reads/views materials from diverse sources and makes use of the information gathered in their own work • Produces texts evaluating the quality of particular public services for particular purpose and intended audience, justifying their opinion

		<ul style="list-style-type: none"> • Produces descriptive oral and written texts relating public services using grade appropriate vocabulary and structures • Presents orally or in writing the features of public services comparing them with the ones in the target culture countries • Produces texts evaluating the quality of particular public services for particular purpose and intended audience, justifying their opinion • Discusses with confidence the advantages and shortcomings of public services based on information gathered • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
	<p>Topic 6 A matter of life & death</p> <ul style="list-style-type: none"> • Take a deep breath! • Stress is all around us • Physical & mental health maintenance • Health-related campaigns 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and compares relevant information relating to health issues and healthy lifestyles • Views documentary programmes relating to physical and mental health, and stress-management issues • Listens/reads/views and responds orally and/or in writing proposing solutions to particular health maintenance issues • Contributes to health-related campaigns by participating in initiating and conducting promotional activities for particular target groups (teenagers, adults, elderly...)
	<p>Topic 7 The world of fashion</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shopping • Money & prices • Clothes and accessories • Charity event: Spring-clean your house 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts and compares information regarding fashion around the world, comparing it to traditional and current trends • Reads/listens/ views materials regarding the world of money, comparing currencies and prices in different parts of the worlds • Reads/listens to texts relating to teenage fashion comparing teenage culture in the target culture world and their own culture • Engages in discussion with peers and teacher regarding

		<p>trends in fashion</p> <ul style="list-style-type: none"> • Undertakes together with peers a survey/investigation in order to identify vulnerable groups needing support • Contributes to charity events in initiating, organizing, and conducting charity events to aid particular target groups
	<p>Topic 8</p> <p>Travel</p> <ul style="list-style-type: none"> • Countries and places • Travel rules and tips • Globetrotters • School excursions 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and compares relevant information regarding various countries in places • Listens/reads/views particular programmes relating to travel and transport extracting specific information • Engages in discussion with peers and teacher regarding travel and transport • Produces persuasive media messages for target audience promoting a particular type of travel (poster, advertisement, audio/video message...) • Explores the information relating to benefits of getting acquainted with people of different nations and cultures in aiding cultural understanding and facilitating communication between people • Contributes to school excursions by initiating, organizing and conducting such events
Figurative & non-figurative language	<p>Topic 1</p> <p>Residence</p> <ul style="list-style-type: none"> • Home & shelters • Rooms and furniture • Amenities • Living outdoors 	<ul style="list-style-type: none"> • Listens /reads short recorded/print text (advertisements, brochures...) and extracts essential information, distinguishing different shades of meanings • Listens/reads and extracts specific information distinguishing between facts and opinions • Discusses various types of homes and shelters expressing preferences and justifying their opinions • Explores, extracts, reads, compares and presents orally and/or in writing the common features of homes and shelters in our environment and other areas in the world • Engages in discussion with peers and teacher regarding types of accommodation

		<ul style="list-style-type: none"> • Reads/listens to texts and extracts relevant vocabulary in order to enrich his/her lexical fund • Infers the meaning of words from the context • Uses level and grade appropriate print/ electronic/online dictionaries and reference materials to check spelling, pronunciation, and meaning • Distinguishes between formal and informal language • Together with peers plans and conducts a survey regarding the most popular suburb in the city • Discusses the issue of homelessness and together with peers designs a survey questionnaire
	<p>Topic 2</p> <p>Daily life</p> <ul style="list-style-type: none"> • Activities at home • School life & community activities • Paid jobs & volunteering • Fund-raising event: Talent show 	<ul style="list-style-type: none"> • Describes orally and/or in writing various home and school activities • Compares teenage opportunities for volunteering and paid jobs in their own and the target culture • Values paid jobs and community work by demonstrating initiative in planning such activities • Demonstrates creativity by contributing to school events presenting his own work • Integrates knowledge from other subject and presents his own work in the target language • Reads texts of fair complexity in English comparing the information found in sources in the mother tongue • Infers the meaning of words from the context • Demonstrates understanding that words acquire different meanings in different contexts • Uses level and grade appropriate print/ electronic/online dictionaries and reference materials to check spelling, pronunciation, and meaning • Distinguishes between formal and informal language used in different situations and with different interlocutors

	<p>Topic 3</p> <p>Leisure & pleasure</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lifestyles • Media • Information, education/entertainment • My favourite book/author/film 	<ul style="list-style-type: none"> • Compares lifestyles in the countries of the target culture with their own • Uses the Internet for information, communication, and entertainment being cautious of privacy and safety issues • Communicates with teacher and peers, and other people using Internet (emails, mailing lists, groups, social networks) • Drafts his/her writing using computer programs, like spell-checkers for accuracy, online dictionaries, vocabulary lists, as well as specific IT tools for presentations of their work; • Integrates knowledge from other subject and presents his own work in the target language • Creates text and video messages and sends them using ICT • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues • Writes texts of a variety of lengths (book/film review, biography...)
	<p>Topic 4</p> <p>Education & career</p> <ul style="list-style-type: none"> • Learning styles • Out-of-school learning • Education & learning resources • Career opportunities • Plans & ambitions • Education, investment for future 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores and identifies his preferred learning style and recognizes the value of experiential and self-directed learning • Discusses career opportunities with peers, taking into consideration advantages and disadvantages of various options • Values the education opportunities and options provided by demonstrating readiness to engage in self-directed learning • Drafts his/her writing using computer programs, like spell-checkers for accuracy, online dictionaries, vocabulary lists, as well as specific IT tools for presentations of their work; • Creates text and video messages and sends them using ICT; • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues. • Creates text and video messages and sends them using ICT

		<ul style="list-style-type: none"> • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues • Writes texts of a variety of lengths (book/film review, biography...)
	<p>Topic 5 Public services</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emergency services • Public security • Telecommunications • Healthcare 	<ul style="list-style-type: none"> • Produces texts evaluating the quality of particular public services for particular purpose and intended audience, justifying their opinion • Produces descriptive oral and written texts relating public services using grade appropriate vocabulary and structures • Demonstrates understanding that words may have direct and metaphorical meanings • Presents orally or in writing the features of public services comparing them with the ones in the target culture countries • Discusses with confidence the advantages and shortcomings of public services based on information gathered • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
	<p>Topic 6 A matter of life & death</p> <ul style="list-style-type: none"> • Take a deep breath! • Stress is all around us • Physical & mental health maintenance • Health-related campaigns 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and compares relevant information relating to health issues and healthy lifestyles • Views documentary programmes relating to physical and mental health, and stress-management issues • Listens/reads/views and responds orally and/or in writing proposing solutions to particular health maintenance issues • Contributes to health-related campaigns by participating in initiating and conducting promotional activities for particular target groups (teenagers, adults, elderly...)

	<p>Topic 7</p> <p>The world of fashion</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shopping • Money & prices • Clothes and accessories • Charity event: Spring-clean your house 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts and compares information regarding fashion around the world, comparing it to traditional and current trends • Reads/listens to texts regarding the world of money, comparing currencies and prices in different parts of the worlds • Reads/listens to texts relating to teenage fashion comparing teenage culture in the target culture world and their own culture • Undertakes together with peers a survey/investigation in order to identify vulnerable groups needing support • Contributes to charity events in initiating, organizing, and conducting charity events to aid particular target groups
	<p>Topic 8</p> <p>Travel</p> <ul style="list-style-type: none"> • Countries and places • Travel rules and tips • Globetrotters • School excursions 	<ul style="list-style-type: none"> • Explores, extracts, and compares relevant information regarding various countries in places • Listens/reads/views particular programmes relating to travel and transport extracting specific information • Engages in discussion with peers and teacher regarding travel and transport • Produces persuasive media messages for target audience promoting a particular type of travel (poster, advertisement, audio/video message...) • Explores the information relating to benefits of getting acquainted with people of different nations and cultures in aiding cultural understanding and facilitating communication between people • Contributes to school excursions by initiating, organizing and conducting such events
<p>Criticism, theory, history</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrates understanding of similarities and differences between the target culture and their own culture using them in bridging the culture gap and aiding communication across cultures • Demonstrates understanding by identifying the content and

		<p>relevance of news items, articles and reports related to everyday problems, or to issues of personal interest in the target language and culture</p> <ul style="list-style-type: none"> • Together with team-mates analyses, classifies, and organizes data collected through surveys on various topics of personal, educational, or community interest in the target culture and their own • Engages with his team-mates in sharing work and responsibility, and performs his/her part in presenting the findings of the survey in agreed form (talk, PowerPoint presentation, poster presentation, debate) • Shares his work with peers and teacher in class and engages in giving and receiving feedback • Develops his proof-reading and self-correcting ability by using the reference tools (online/print dictionaries, reference books...) • Independently, or together by mates, or guided by the teacher, explores the rules and regularities in the language system • Compares and contrasts particular linguistic features of the target language and the mother tongue • Presents his/her report on various topics to peers and teacher and includes it into class materials to be displayed, read and peer-evaluated by class-mates and teacher • Seeks and provides information in unfamiliar real-life situations and finds solution to problems justifying his/her choices • Reads/listens/views various materials in a range of sources and expands his knowledge and understanding developed in other school subjects relating to the target culture • Demonstrates understanding that different media texts reflect different points of view • Recognizes stereotypes and preconceived ideas
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrates understanding and recognizes the influence of the target culture on their own • Compares, contrasts and applies social conventions across cultures in oral and written communication
Language exponents	Topic 1 Residence <ul style="list-style-type: none"> • Describing • Expressing likes, dislikes, and preferences • Comparing and contrasting • Present tenses • Adjectives • Adverbs of frequency • Clause patterns • Word order – statements/ questions • Vocabulary field – residence, household utensils • Idioms related to home • Word and sentence stress 	<ul style="list-style-type: none"> • Describes, places, events and experiences with an improving accuracy and fluency • Describes orally and/or in writing different types of residences, expressing likes, dislikes and preferences • Compares and contrasts information extracted from electronic and print media and uses it in their own work • Demonstrates fair degree of competence in delivery needing some support from interlocutor (peers, teachers, and other speakers) • Presents reasons for different types of accommodation relating it to social, economic and climatic issues, using grade appropriate vocabulary and structures • Builds his personal vocabulary, by using and reusing items orally and in writing and makes attempts at storing them in long-term memory • Presents orally and/or in writing the common features of homes and shelters in our environment and other areas in the world • Produces descriptive oral and written texts relating to his home/ rooms in it/ his own room • Discusses with confidence the advantages and disadvantages of different types of homes with fair degree of fluency • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation

	<p>Topic 2</p> <p>Daily life</p> <ul style="list-style-type: none"> • Describing actions and activities • Giving and requesting information • Making requests • Expressing approval and disapproval • Present & past tenses • Adverbials • Word order - phrases • Statements • Questions • Imperatives • Vocabulary field – occupations • Word and sentence stress • Falling and rising intonation 	<ul style="list-style-type: none"> • Describes orally and/or in writing daily activities occurring at home, in school, and in community • Seeks and provides information from other speakers • Produces descriptive oral and written texts relating to school, community and the world of work using grade appropriate vocabulary and structures • Presents orally or in writing the features of the globalised world of work using grade appropriate vocabulary and structures • Builds his personal vocabulary, by using and reusing items orally and in writing and makes attempts at storing them in long-term memory • Discusses with confidence the advantages and disadvantages of different types of jobs with fair degree of fluency using appropriate stress and intonation in statements and questions • Independently and/or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation • Performs at a talent show as part of fund-raising event for humanitarian purposes
	<p>Topic 3</p> <p>Leisure & pleasure</p> <ul style="list-style-type: none"> • Describing feeling and emotions • Expressing likes and dislikes, and preferences • Expressing moods • Present simple and continuous tenses • Word order 	<ul style="list-style-type: none"> • Uses Internet for information, communication, and entertainment being cautious of privacy and safety issues; • Expresses his opinions, likes, dislikes, preferences, and moods, using grade appropriate vocabulary and structures • Communicates with teacher and peers, and other people using Internet (emails, mailing lists, groups, social networks) • Enriches his vocabulary by using and reusing items orally and in writing and makes attempts at storing them in long-term memory

	<ul style="list-style-type: none"> • Exclamations • Vocabulary field – Sports and leisure activities • Sport related idioms 	<ul style="list-style-type: none"> • Produces media messages for intended purpose and audience • Creates oral and written texts and video messages and sends them using ICT • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes texts of a variety of lengths (book/film review, biography...) • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
	<p>Topic 4</p> <p>Education & career</p> <ul style="list-style-type: none"> • Making plans • Expressing hopes and ambitions • Modal type of verb phrases • Future tenses • Word order • Comparison of adjectives to a higher degree • Vocabulary field – education • Education related idioms 	<ul style="list-style-type: none"> • Discusses with peers and other English speakers' future plans, hopes and ambitions using grade appropriate vocabulary and structures • Discusses with confidence the advantages and disadvantages of different education career paths with fair degree of fluency • Drafts his/her writing using computer programs, like spell-checkers for accuracy, online dictionaries, vocabulary lists, as well as specific IT tools for presentations of their work; • Creates oral and written text and video messages and sends them using ICT; • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues. • Creates text and video messages and sends them using ICT • Uploads his/her work on the web taking care of privacy and security issues • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system

		<ul style="list-style-type: none"> • Writes texts of a variety of lengths regarding the topics covered/studied • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
	<p>Topic 5 Public services</p> <ul style="list-style-type: none"> • Expressing opinions • Describing • Comparing and contrasting • Making generalisations • Present perfect and past simple tense • Categories of nouns • Adverbs of manner • Word classes • Vocabulary field – public services • Business related idioms 	<ul style="list-style-type: none"> • Discusses with confidence the advantages and shortcomings of public services based on information gathered • Expresses his opinion, based on relevant information, comparing and contrasting public services and making generalisations • Produces descriptive oral and written texts relating public services using grade appropriate vocabulary and structures • Presents orally or in writing the features of public services comparing them with the ones in the target culture countries • Together with peers initiates and conducts surveys relating to public services and presents the results of the survey in various forms (text, graphic organizer, poster, flier) • Produces texts evaluating the quality of particular public services for particular purpose and intended audience, justifying their opinion • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
	<p>Topic 6 A matter of life & death</p> <ul style="list-style-type: none"> • Describing people, situations, events • Expressing compassion and support • Expressing disappointment • Reporting statements 	<ul style="list-style-type: none"> • Compares and contrasts information regarding healthy lifestyles and the dangers of the modern world using grade appropriate vocabulary and structures • Discusses with confidence the issues of physical and mental health maintenance • Produces descriptive and persuasive texts relating to health and fitness issues • Produces texts of a variety of lengths for different purposes and audiences concerning health and fitness (posters, fliers, PowerPoint presentations, media messages)


<ul style="list-style-type: none"> • Tenses - miscellaneous • Word order • Concord of tenses • Vocabulary field – health and fitness • Health related idioms 	<ul style="list-style-type: none"> • Contributes to health-related campaigns by participating in initiating and conducting promotional activities for particular target groups (teenagers, adults, elderly...) • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
<p>Topic 7 The world of fashion</p> <ul style="list-style-type: none"> • Describing objects and their features • Describing people and their appearance • Comparing and contrasting information • Tenses – miscellaneous • Comparison of adjectives to the same degree • Vocabulary field – clothes and accessories, money and currencies • Fashion related idioms 	<ul style="list-style-type: none"> • Describes accurately orally and/or in writing, people, objects and their features • Compares and contrasts orally or/and in writing information regarding the current trends in fashion in the world and in our country using grade appropriate vocabulary and structures • Engages in discussion with peers and teacher regarding current trends in fashion comparing it with the past • Produces texts of a variety of lengths for different purposes and audiences concerning current trends in fashion the teenage world (posters, fliers, PowerPoint presentations, media messages) • Contributes by initiating, organizing, and conducting charity events to aid particular vulnerable target groups • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
<p>Topic 8 Travel</p> <ul style="list-style-type: none"> • Describing places, 	<ul style="list-style-type: none"> • Compares and contrasts orally or/and in writing relevant information regarding various countries and places pointing out their distinctive features using grade appropriate

	<p>countries, cities</p> <ul style="list-style-type: none"> • Comparing and contrasting information • Expressing opinions • Agreeing and disagreeing • Interrupting politely • Tenses - Miscellaneous • Word order • Adjectives and adverbs • Vocabulary field – countries, nationalities • Idioms related to travel 	<p>vocabulary and structures</p> <ul style="list-style-type: none"> • Engages fairly confidently in discussion with peers and teacher regarding travel and transport • Produces descriptive texts relating to countries and places explored/ visited for particular purpose intended audience • Produces persuasive media messages for target audience promoting a particular type of travel (poster, flier, advertisement, audio/video message...) • Presents information relating to benefits of getting acquainted with people of different nations and cultures in aiding cultural understanding and facilitating communication between people • Contributes to school excursions by initiating, organizing and conducting such events • Independently or guided by the teacher notices rules and regularities in the language system • Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation
--	---	--

Uidelines for using the syllabus

All the learning outcomes in the syllabus are written based on four concepts: Literary and non-literary texts, Figurative and non-figurative language, Criticism, theory and history, and Language system. Each topic in this syllabus should integrate all four concepts; therefore concepts should not be developed as separate, but interconnected with one another within one topic since each concept helps the development of student's knowledge, skills, values and attitudes.

In the syllabus there are all the topics that will be developed during one school year, with teaching contents for each topic. Teachers should develop the topic which is based on four concepts, laying out teaching units in logical order.



The learning outcomes in the syllabus are expectations of each student's knowledge, skills, values and attitudes in the end of this school year. Teacher's role is to develop all students' communicative skills: listening, speaking, reading, and writing. In the syllabus there are learning outcomes based on these skills which are measurable and which affect directly student's success. There are also some immeasurable outcomes which are important because through them students develop their values and attitudes.

Methodological guidelines

In order to achieve the targeted aims and learning outcomes and equip learners with required competencies, Grade Ten English Language Syllabus promotes the most contemporary approaches in language teaching and learning. First and foremost, it promotes communicative approaches, task-based and project-based learning in order to facilitate learner interaction and collaboration, as well as develop learner autonomy and creativity. Thus, learning-centred approaches are favoured over the traditional approaches. Below are some brief guidelines regarding the methodology to be used by the teachers in their classrooms in order to motivate learners, as well as to facilitate their learning.

The Communicative Approach and Task-Based Learning

The overall aim of the English Language Curriculum is to enable learners to communicate successfully. Successful communication means getting our message across to others effectively. The Communicative Approach to language learning aims at facilitating genuine interaction with others, whether they live in the neighbourhood, in a distant place, or on another continent.

In language learning, the attention of the learners may be focused on particular segments, or on the language as a whole. In cases when we want to focus learners' attention on particular segments, then a segment may be a grammatical structure (a tense), a language function (expressing gratitude), a vocabulary area (food and drinks), or a phonological feature (stress or particular sounds).

Since communication basically means sending and receiving messages, learners should develop the four language skills, which are the core of communication. Development of *receptive skills*, that is *listening* and *reading* skills, will enable learners to receive messages and, depending on tasks they are expected to fulfill, select essential information. However, since language skills do not occur in isolation, but are normally integrated for communicative purposes, after having received a message, learners should be able to make decisions, and respond appropriately. In a situation which involves language, their response is a communicative function, which is performed by one of the *productive skills* either by *speaking* or by *writing*.

The Learning – Centred Classroom

The objective of learning-centred teaching is to make teachers aware of the importance of learner autonomy in the classroom. The teacher has a role, to support and help learners. The learners learn more actively and with enjoyment. The environment requires a learning-centred approach that relies on participant's share in the learning,

and responsibility for furthering discussion. In all cases learners need clear guidelines and preparation for effective discussion and participation.

The major aim, or set of aims will relate to the development of learning skills. Such aims may include the following:

- To provide learners with efficient learning strategies;
- To assist learners identify their own preferred ways of learning;
- To develop skills to negotiate the curriculum;
- To encourage learners to adopt realistic goals and a timetable to achieve these goals;
- To develop learners' skills in self-evaluation.

The use of the mother tongue in the classroom

Contrary to the principles of the direct method and natural approach in language learning, which favour exclusive use of the target language, excluding the mother tongue completely from the classroom, most recent approaches today suggest that the use of the mother tongue at particular stages of foreign language learning may prove useful.

While there is clearly a place for the mother tongue in the classroom, teachers should make efforts to keep the use of the mother tongue to a minimum. Instead of translating words and/or asking learners to translate, they should demonstrate, act, use simple drawings and/or pictures, explain, give simple definitions. If teachers readily intervene with translation, as soon as learners are provided with an 'equivalent' word or expression, as soon as their curiosity is satisfied, they may lose interest in that particular item. In consequence, the English word or expression is easily forgotten and cannot be easily recalled. This method is easiest for teacher and learner, but may be the least memorable.

Vocabulary learning

Vocabulary teaching and learning is central to learning English. Words have a central place in culture, and learning words is seen by many as the main task in learning another language.

At level 3 learners know how to express themselves using a range of vocabulary and expressions.

L 3	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ to set the task, to give explanations and monitor the 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ in pairs or small groups to cooperate and take the right 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Using given words to complete a specific

	learner; <ul style="list-style-type: none"> ▪ to encourage the use of bilingual and English-English dictionaries. 	decision with the help of dictionaries if needed ; <ul style="list-style-type: none"> ▪ to store new words through diagrams, write word lists, produce word-cards and so on. 	task; <ul style="list-style-type: none"> ▪ classifying items into lists; ▪ matching words to other words e.g. collocations, synonyms, opposites.
--	---	--	---

The Role of Grammar

If we see language as a building, the words as building blocks or bricks, and grammar as the architect's plan, than we must admit that without a plan, even a million bricks do not make a building. Similarly, one may know a million English words, but if s/he does not know how to put them together, s/he cannot speak English (Sesnan, 1997).

In the light of this statement, the question is not whether to teach grammar or not, but *how* to teach it. We should consider which approach to adopt in teaching grammar, whether to teach form before meaning, or meaning before form, and what strategies and techniques to use in order to enable learners to put their knowledge of grammar into use and communicate effectively. It is the teacher's responsibility to estimate which approach would yield best effects at a particular stage of learning, or with a particular class.

L 3	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ To set and monitor the development of activities; ▪ To focus on meaning, form and context; ▪ To raise learners' awareness as to 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ To solve problems, and puzzles, fulfil tasks, and take part in activities; ▪ To make conscious efforts to work out the rules independently; ▪ To increase their 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Solving problems and puzzles ; ▪ Discussions, and debates; ▪ Guided and free writing.

	what they have learned.	awareness and keep record of their own learning.	
--	-------------------------	--	--

At this level of education, learners should be ready not only to notice the regularities in language, but also to make a conscious effort to work out the rules. They should be ready to deal with more complex sentences, including coordinated and subordinated clauses. Therefore, teachers should increase the learners' awareness about their progress in learning, as well as to encourage them to work independently and keep record of their own learning.

Teachers should always bear in mind that grammar is not an aim on its own, but is closely connected with communication. It should not be used as a driving force, but should arise out of other classroom activities.

Cross-curricular issues

Since English Language is not taught and learnt for its own sake, but is seen as aim and vehicle, the Grade Ten English Language Syllabus integrates topics that directly relate to other subjects, such as: arts, culture, technology, history, geography, media literacy, civic education, and similar. All these are in the function of equipping learners with first of all the communicative competence, as well as other competencies foreseen in the Level Three Core Curriculum. Teachers are encouraged to use a range of oral and written texts, media excerpts, and documentaries from different disciplines in order to scaffold learners' interest in exploring cross-curricular issues, either guided by the teacher, or collaborating with their peers, or autonomously in order to enable them to develop their critical thinking, as well as their problem-solving skills. By doing so, teachers will provide plenty of opportunities for learners to develop their creativity using different forms of expressing themselves individually, or with their peers.

Assessment and evaluation guidelines

Generally speaking, there are two types of assessment: formative assessment and summative assessment. Formative assessment is applied when we want to see where our learners stand, and what needs to be done in order to support them further in their learning. We do not conduct formative assessment in order to grade our students. Summative assessment is usually administered at the end of the unit, or term, or year in order to grade learners. However, the grade should not be based on the final test, or exam only. Rather, the grade should include the sum of all assessments undertaken by the teacher throughout the process.

There are many reasons for assessing learners. Some of them are: to compare learners with each other; to see if learners have reached a particular standard; to help the learners' learning; to check if the teaching programme is successful.

Teaching means changing the learner. Teachers will always want to know how effective their teaching has been- that is, how much their learners have changed.

This change can be observed in: the amount of English learners know; the quality of the English they use; and their ability to use English.

The general word for measuring the change is assessment. Naturally if we want to assess how much learners have changed, we have to know exactly what they already **know** and what they can already **do**, which means that we do not only assess their knowledge, but their skill as well.

There are different types of assessment (or evaluation) and teachers need to use them in different circumstances:

- Self-assessment (self-evaluation) is used when we want to encourage the learners to monitor their own progress (also guide them in doing so)
- Group assessment (group-evaluation) is effective when we want to develop the spirit of team work, in which learners need to take responsibility for their share of work, as well as for the responsibility for the success of the team as a whole.
- Individual assessment (evaluation) is used when we want to sum up all the
- Combination of group and individual assessment
- The use of work samples, portfolios and projects.

If teachers want to find out how effective their teaching has been, or if they want to evaluate the learners' progress, then **tests** are used. Tests are conducted in class by the teacher. They measure the results of learners' performance. Teaching and testing always go hand-in-hand. Questions are often asked to check if the learners have understood what has been said. Equally, they may be asked to find out whether a particular point needs to be taught. We instinctively know why we ask a question: whether it is to teach or to test something.

Some major reasons for testing are:

- To diagnose learners' standard on arrival at a particular stage or grade;
- To measure learners' progress during the course;
- To find out how much pupils have learned;
- To find out the quality of learning, as well as of teaching;
- To find out how many of the class have learned what they were supposed to learn;
- To motivate pupils;
- To show the teacher what to teach next and how to teach it.

There are different kinds of tests, such as:

- Diagnostic tests
- Placement tests
- Proficiency tests
- Achievement tests

Evaluation is definitely a wider concept and process than testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing someone's performance.

Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

With the evaluation we are making attempts to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school. Consequently, teachers are strongly encouraged to apply formative assessment whenever possible, in order to ensure the learning to happen and develop learners' competencies as envisioned in the Core Curriculum for this level.

Guidelines for teaching materials, tools and resources

In order to achieve the targeted aims and learning outcomes, and cover the topical content of the grade ten syllabus teachers should select teaching materials from course book(s) of **pre-intermediate level**. These materials and aids should primarily be age-appropriate, which means that they should be dedicated to teenagers and/or young adults.

Apart from this, teachers are encouraged to use supplementary materials to suit the learners' needs, that is, their background knowledge their interests, and motivation. Supplementary materials (video tapes, documentary films, drama activities, projects, contests and quizzes, and similar), may be used either within regular English classes, or within additional activities planned by the school curriculum (choice subjects, extra-curricular activities, and similar).

Suggested online resources

<https://www.youtube.com/watch?v=NG2zyeVRcbs&list=PLFT01amlq1Qtr0qd-hvp5oAVpAVIIECE1>

<https://www.youtube.com/watch?v=NG2zyeVRcbs&list=PLFT01amlq1Qtr0qd-hvp5oAVpAVIIECE1>

<http://www.englishforeveryone.org/>

<http://www.eslcafe.com/quiz/>

<http://www.manythings.org/vocabulary/games/l/words.php?f=body-1>

<http://www.englishclub.com/esl-quizzes/>

<http://www.cdiponline.org/index.cfm?fuseaction=stories&topicID=1>
<http://www.esl-lab.com/>
<http://www.bbc.co.uk/worldservice/learningenglish>
<http://iteslj.org/ESL.html>
<http://www.manythings.org/>
<http://a4esl.org/>
<http://www.english-at-home.com/>
<http://foreignborn.com>
<http://www.bbc.co.uk/worldservice/learningenglish>
<http://www.britishcouncil.org/learnenglish>
<https://ed.ted.com/lessons>
<https://lyricstraining.com/>
<https://www.ted.com/talks>
<http://learnenglishteens.britishcouncil.org/>
<https://www.teachingenglish.org.uk/teaching-teens>
<https://www.ted.com/watch/ted-ed>
<https://americanenglish.state.gov/search/solr?f%5B0%5D=bundle%3Aresource>
<https://busyteacher.org/atoz/>
<https://www.k12reader.com/grade-level/grades-k-12/>

Media

www.cnn.com
www.bbc.co.uk/
[BBC English Radio.](#)
[BBC World Service.](#)
<http://www.mirror.co.uk>
<http://www.thebigproject.co.uk/news/>

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë gjermane (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Njohja e gjuhëve të huaja krijon hapsirë dhe liri më të madhe të lëvizjes e me këtë edhe vetëbesim dhe është një ndër kushtet kryesore të kualifikimit për tregun botëror të punës, njëkohësisht është edhe kusht paraprak për njohjen me kulturat e tjera.

Me situatën e re të krijuar në Kosovë u krijuan edhe mundësitë e kontaktit më të shpeshtë me Europën e me këtë u krijuan edhe mundësitë për mësimin më të lehtë të gjuhëve të huaja.

Për shkak të migrimëve të shumta në vendet gjermanofolëse në një mënyrë janë krijuar edhe lidhjet me gjuhën dhe kulturën gjermane. Por, kohëve të fundit janë të shpeshta edhe ardhjet e gjermanofolësve në Kosovë, qoftë si të punësuar në vendin tonë, apo edhe si turistë. Kjo ka krijuar nevojën edhe për kualifikime të ndryshme të nxënësve të shkollave profesionale. Madje, për këtë lloj shkollimi edhe materialet e literatura më e re, është kryesisht në gjuhën gjermane, duke qenë se Gjermania prinë në Evropë për zhvillimin e teknikës, shkencës, mjeksisë, etj.

Poashtu mundësia e përgatitjes profesionale e të rinjëve tanë në vendet gjermanofolëse është dukshëm më e madhe se sa në vendet tjera. Arsyet tashmë dihen.

Të gjitha këto janë arsye që mësimdhënien moderne e gjuhëve të huaja duhet t'u ofrojë të rinjve shkathhtësitë dhe njohuritë e duhura për një botë shumëgjuhëshe, të cilat ua bëjnë të mundur atyre të jenë të aftë të veprojnë edhe jashtë kufinjëve të gjuhës së tyre amtare.

Gjuha Gjermane në klasën e 10-të mësohet me 2 orë në javë. Me këtë numër të orëve duhet të arrihet niveli A1/1, sipas “Kornizës programore për gjuhën gjermane si gjuhë e huaj” e Konferencës së Ministrisë Gjermane të Kulturës, e cila përsëri orientohet në Kornizën e Rekomanduar Evropiane të Gjuhëve të Huaja.

Qëllimi

Qëllimet kryesore të mësimdhënies së gjuhës gjermane në klasën e X janë:

- Të zhvillohen katër shkathhtësitë gjuhësore;
- të aftësohen nxënësit për t'u marrë vesh në situata të thjeshta gjuhësore, brenda dhe jashtë shkollës, me njerëz që i përkasin kulturës dhe gjuhës gjermane;
- të aftësohen nxënësit të krahasojnë kulturën gjermane me kulturën dhe traditën vetjake, si dhe të shfrytëzojnë këto pikëpamje në profilet arsimore të zgjedhura nga ata;
- të aftësohen nxënësit të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorimin më të vetëdijshëm të gjuhës amtare;
- të aftësohen që t'i zhvillojnë në mënyrë të pavarur njohuritë e fituara në gjuhën gjermane për t'i aplikuar ato në profesionet e tyre të ardhshme.
- Të mësuarit e gjuhës gjermane në Kosovë është ndihmë edhe e përgatitjes së nxënësve për të kryer provimet e njohura ndërkombtarisht të gjuhës gjermane, të cilat i organizon kryesisht Instituti Gëte. Këto

provime ju shërbejnë nxënësve dhe studentëve në të ardhmen për të studiuar, punuar në vendet gjermanofolëse e gjetiu, ku flitet gjuha gjermane.

Shkathësitë e komunikimit

Shkathësitë receptive

Të dëgjuarit dhe të lexuarit

Shkathësitë produktive

Të folurit dhe të shkruarit

Temat dhe rezultatet

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënësve të lëndës për temë (RNL)
Tekstet letrare e jo letrare Sistemi i gjuhës	<p>Temat bosht që propozohen për mësimin e gjuhës gjermane në klasën e dhjetëe për të arritur kompetencat e parapara me kornizën e kurrikulës janë:</p> <p>- Informatat personale, përshendetjet, prezantimi, profesionet, familja</p> <p>- Shoppingu, mobilitet, produktet, zyrja dhe teknika</p> <p>- Koha e lirë, komplimentet, takimet, ushqimi, ftesat</p> <p>- Udhëtimi, mjetet e transportit, rrjedha e ditës dhe planifikimi, festat</p>	<p>Të dëgjuarit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dëgjon dhe kupton fjalë dhe fjali të thjeshta të cilat kanë të bëjnë me atë vet, familjen apo gjerat e njohura nga libri, kur i flitet shumë ngadalë dhe me kujdes, i përsëriten fjalitë disa herë, kur bëhet pauzë më e gjatë gjatë të folurit dhe bashkëbiseduesi është i gatshëm t'i ndihmojë; - kupton udhëzime të thjeshta që i drejtohen atij ngadalë dhe qartë dhe reagon sipas tyre. - kupton pyetjet që i bëhen për shëndetin, vendbanimin, familjen, kohën e lirë - kupton dialogje të shkurtëra, tekste të shumë të shkurtëra e këngë të thjeshta të dëgjuara e të njohura nga libri shkollor, <p>Të folurit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon kontakte të thjeshta gjuhësore, si: përshendetë (Guten Tag!; Guten Morgen! Hallo!), përgjigjet në pyetjet e thjeshta, prezantohet (Ich heiße ...; Mein Vorname ist ...; Mein Nachname ist ...), pyet për emrin (wie heißt du?; wo wohnst du?) - Kupton udhëzimet e thjeshta: schreibe ab;

		<p>ergänze; dhe përgjigjet në pyetje. p.sh. Er schreibt, sie schreiben nicht, etj.</p> <p>-me fjali të thjeshta mund ta prezantojë veten, dhe të pyes të tjerët për veten, p.sh. wo sie wohnen?, woher sie kommen?, was für Leute sie kennen?, dhe mund t'iu përgjigjet pyetjeve të kësaj natyre.</p> <p>- me fjali shumë të thjeshta përgjigjet, shprehet me shprehje shumë të thjeshta, kryesisht të izoluara, për veten e familjen dhe njerëzit e vendet</p> <p>- kupton pyetjet që i bëhen për shëndetin, vendbanimin, familjen, kohën e lirë dhe përgjigjet me shprehje të thjeshta, kryesisht të izoluara, p.sh. Wie geht es Ihnen? – Danke, gut. – Ich habe Halschmerzen.- Ich möchte spielen.;</p> <p>Përshkruan aktivitete të thjeshta, i emërton objektet e aktivitetet dhe i përshkruan ato: Das ist eine... / Das ist mein .../ das ist die....</p> <p>- përdorë shprehje shumë të shkurtëra të njohura, duke bërë shumë pauza që të gjejë shprehjen e duhur.</p> <p>- gjatë të folurit tregon një zotërim të kufizuar të strukturave shumë të thjeshta gramatikore në një repertoar të fjalive të mësuara përmendësh.</p> <p>- merret vesh në formë shumë të thjeshtë rreth temave nga libri, nëse bashkëfolësi ëshë i gatshëm të flasë shumë ngadalë dhe ta përsërisë e thotë ndryshe, dhe ndihmon tëformulojë atë qëmundohet ta thotë.</p>
		<p>Tëlexuarit:</p> <p>- lexon dhe kupton fjalë e fjali shumë të thjeshta.</p> <p>- lexon dhe kupton tekste shumë të shkurtëra dhe të thjeshta nga teksti mësimordhe dallon</p>

		emrat dhe fjalët e njohura, sidomos nëse janë të përcjellura me fotografi.
		- lexon dhe kupton porositë e thjeshta në një kartolinë, apo e-mail të shkurtër.
		Të shkruarit: -përshkruan fjali e tekste të shkurtëra - bartë të dhënat e shkruara për një person në një formular. - plotëson një formular me të dhëna personale që kanë të bëjnë me emrin, mbiemrin, adresën, nacionalitetin, etj

Udhëzime metodologjike

Forma komunikative e mësimdhënies

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore u duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehen dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta. Tri gjetjet e psikologjisë së të mësuarit dhe neurodidaktikës veçanërisht të rëndësishme për mësimin e gjuhës janë:

1. Interesi dhe emocionet zgjohen më së miri përmes tregimeve.
2. Kujtesa jonë punon me imazhe.
3. Të forcohen përsëritjet dhe motivimi.

Njeriu mëson me të gjitha shqisat. Për këtë arsye, materiali mësimor duhet të jipet nëpërmjet kanaleve të shumta dhe të lidhura në mënyrë optimale së bashku. Ky lloj i prezantimit e mbanë më gjatë vëmendjen e zgjuar.

Forma të ndryshme të të mësuarit përmes këngëve, përmes lojërave të ndryshmekrijojnë një rrjet të përkryer: një rrjet që ka nëshënjestër rritjen e suksesit të mësuarit të gjuhës.

1. Rradhitje e qartë e rrafsheve gjuhësore

Është e nevojshme, posaçërisht në nivelin fillestar të mësimdhënies, që t'u jepet një theks i veçantë rrafsheve të ndryshme gjuhësore, si

- Përpunimit të vokabularit (fjalësit)
- Përpunimit të teksteve

- Strukturat gjuhësore

Kjo do të thotë: të caktohen prioritetet brenda një njësie mësimore.

Nuk mundet p.sh. që të zhvillohet edhe vokabulari i ri edhe strukturat të reja gjuhësore.

Mënyra më e drejtë do të ishte që së pari të përpunohet dhe trainohet vokabulari, I cili paraqitet në leksionet e caktuara.

Pastaj vokabulari I përpunuar do të futet në struktura të reja sintaktike.

Mësuesi, brenda mësimdhënies komunikative, zgjedhë situata të tilla gjuhësore, të cilat janë të afërta me përditshmërinë, ashtu që strukturat e ushtruara të jenë natyrale e jo artificiale.

3. Realizimi i një ore përmes objektivave

Përcaktimi i qartë i objektivave, është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vet në përcaktimin e objektivave më specifike. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënëset/it e zotërojnë materien e përpunuar- atëherë mesimdhënësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të reja në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimi ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

Gjithashtu është e rëndësishme që në fazën e “e njoftimit me temën e re” (Sprachbegegnung)” të hyhet mundësisht shpejtë në thelb të “problemit” me një motivim me të cilin arrihet objektivi dhe jo të shkohet rrugëve anësore, të cilat do t’i lejonin nxënëses/sit të hamenden rreth asaj se çka në të vërtetë mund të jetë qëllimi i orës mësimore.

4. Përcaktimi i saktë i objektivave

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcaktuara më parë mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcaktojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektivi specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Përcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë:

Mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënëset/sit nuk mund ta bëjnë zotërimin e mjaftueshëm të materies. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t’u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi.

Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë.

Sipas hulumtimeve nxënëset/sit mesatarë janë në gjendje që për një orë mësimi të mbajnë mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

5. Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënëset/sit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flasin këto arsye:

- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.
- Grafemat e gjermanishtës dhe të shqipës nuk përputhen në çdo rast. Pasi që nxënset/sit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet “përgjithësimi” ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. E mu kjo mund të shmanget nëse mësimi fillon me të dëgjuarit dhe pastaj lëvizë mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të shkruarit.

6. Puna aktive dhe konkrete

Një dallim në mes të mësimin të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe përveç orës së mësimin pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t'u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimin si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televisionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakatave, mozaqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

7. Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

Tipat akustik (ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit- veshit);

Tipat vizuel- (pamor) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

Tipat motorik (ata nxënë gjuhën më se shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

8. Llojlojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrinë atë është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytëdhënëse, por edhe lojrat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimin.

9. Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimeve se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen..

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, si për shembull përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimin, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet ndër të tjera të parashtrohen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për trainimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se, nxënëset/sit nuk bënë t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

10. Diferencimi

Ndodhë shpesh që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha.

Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzhitet në mësim apo të pengojë të tjerët duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dymundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej që të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla gjejejisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dyforma duhet të shikohen më për së afërmi:

Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ

-*Diferencimi kuantitativ* do të thotë, se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s' do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit "e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm që

të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj në se është nevoja ia japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit megjithatë i ka edhe të metat e tij, sepse me an të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë tjera: dallimi në mes të të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejtë.

-*Diferencimi kualitativ* shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jipen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë ansh temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj, që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, me grupin B grupin me arritje të mesme dhe me grupin C grupin me arritje më të dobëta. Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi) e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi) e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi) diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.		
Grupi A Përpunimi i tërë tekstit. Detyra kreative shtesë	Grupi B Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, psh. Artikelhilfe	Grupi C Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.

Shpesh dëgjohet edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit e që është:

Tek kjo mënyrë e zhvillimit të mësimin nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast treshkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejtë, se kjo nuk mund të vlejë gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejtë dhe mirë objektivin e orës mësimore.
- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi, është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e paktë, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënëjanë të ndryshme pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

11. Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Artikulationsstufen	<i>Methodische Absichten</i>
<i>1. prachbegegnung</i>	Begegnung mit der neuen Sprachsituation,

	z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer- oder Schülervortrag.
2. pracherarbeitung	Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen.
3. Sprachübung	Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprechhandlungen. Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt. Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele
4. prachanwendung	Übertragen des Gelernten auf neue Situationen: Im Klassenzimmer Im außerschulischen Bereich

Këshillohet që temat të zgjidhen nga fushat që propozohen nga “Korniza programore për gjuhën gjermane si gjuhë e huaj” e Konferencës së Ministrisë Gjermane të Kulturës, e cila përsëri orientohet në Kornizën e Rekomanduar Evropiane:

<ul style="list-style-type: none"> - Grundlegende Existenz Erfahrungen - Die persönliche Identität - Partnerbeziehungen - Alltag und Familie - Individuum und Gesellschaft - Wohnen - Erziehung - Arbeit - Versorgung - Gesundheitsfürsorge 	<ul style="list-style-type: none"> - Freizeitgestaltung - Sport - Mensch und Natur - Mobilität und Verkehr - Kommunikation - Wissenschaft und Technik - Kunst und Kreativität - Norm- und Wertorientierung - Zeitlich-historische Erfahrungen - Geistige und seelische Dimensionen
---	--

Udhëzimet për vlerësim

1. Mundësitë praktike

Mësuesi i ka të lira disa mundësi për vlerësim. Mësuesi para se të bëjë vlerësimin duhet të mendojë se çfarë forme të vlerësimit do të zbatojë, sepse nuk është secila mënyrë e vlerësimit njësojë e përshtatshme për verifikimin e njohurive të nxënësit.

Në përgjithësi janë tri fusha të mëdha veprimesh (aftësishë), të cilat vlerësohen:

1. Riprodhimi(reprodukimi)- nënkupton riprodhimin nga nxënësi e asaj që është mësuar më parë.
2. Riorganizimi- nënkupton bartjen e të mësuarës në situata të ngjashme(p.sh. nëse nxënësit i mësohet vendi i foljes në fjali të varur, duhet të jetë i aftë të aplikojë foljen në fjali tjera të varura).
3. Transferi- nënkupton bartjen e të së mësuarës në situata plotësisht të reja.

Kryesisht i njohim tri sfera të mëdha tek vlerësimi:

1. mënyra e të vlerësuarit me shkrim: prej nxënësit pritet një përgjigje me shkrim.
2. mënyra e të vlerësuarit oral: prej nxënësit pritet një përgjigje me gojë.
3. mënyra e të vlerësuarit të veprimeve: prej nxënësit pritet një veprim aktiv, p.sh. tek ushtrimet ku kërkohet rradhitja

Në vijim do të paraqiten vetëm mënyrat e të vlerësuarit me shkrim. Ato janë mënyra më objektive dhe zbatohen më së shpeshti në shkollë.

1.1. Përgjigjet seleksionuese

Siç tregon edhe vetë emri, nxënësi gjatë përgjigjes në një pyetjeje ka mundësinë e zgjedhjes, të dallojë ose të zgjedhë, tek përgjigjjet e shumta të dhëna, në mes të të saktës dhe të pasaktës. Edhe këtu ka mundësi të ndryshme.

- **Përgjigjet alternative**

Nxënësit t jipen dy mundësi të përgjigjes. Ai duhet të identifikojë një përgjigje si të saktë dhe shenjojë atë.

Shembull: rrethoje përgjigjen e saktë.

Berlin ist die Hauptstadt von BRD.	richtig <input type="radio"/>
	falsch <input type="radio"/>

Fjalja e dhënë është e formuluar qartë.

Duke supozuar, se nxënësi i kupton të gjitha nocionet, fjalia do të rrethohet si e saktë. Përparësia e përgjigjeve alternative është e qartë: Ato formulohen, zbatohen dhe vlerësohen shpejtë dhe lehtë.

Të metat janë të dukshme:

Mundësia, që të qëllohet zgjidhja e drejtë, është saktë 50%, sepse vetëm njëra nga zgjidhjet është e saktë.

- **Përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes**

Përkundër përgjigjeve alternative, përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes i japin nxënësit më shumë mundësi për zgjedhje, prej të cilave ai duhet të gjejë të saktën.

Shembull: rrethoje përgjigjen saktë.

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter der Straße.
	<input type="radio"/> über der Straße.
	<input type="radio"/> in der Straße.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Nxënësi, që të mund ta rrethojë zgjidhjen e saktë, duhet t'i njohë parafjalët e përdorura në shembull. Ai duhet ato t'i dallojë dhe t'i krahasojë. Në krahasim me përgjigjet alternative mundësia që të qëllohet përgjigjia e saktë bie; tek ky shembull është 25%.

Tek përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes duhet të kihet parasysh disa pikë: shtruarja e pyetjeve dhe përgjigjet duhet të kenë një lidhje logjike.

Shembull: rrethoje përgjigjen saktë

Die Fliege	<input type="radio"/> fliegt auf den Kopf	des Vaters.
	<input type="radio"/> landet auf dem Kopf	
	<input type="radio"/> schwebt auf den Kopf	
	<input type="radio"/> befindet sich auf dem Kopf	

Në këtë rast nxënësi mund të ketë probleme gjatë të rrethuarit të zgjidhjes së saktë. Ndoshta edhe ndonjë gjermanofolës nuk do të mund të dinte se cila zgjidhje do të ishte më e mira, sepse tek mundësitë e dhëna bëhet fjalë para së gjithash për një çështje stili gjuhësor.

Përgjigjet jo të sakta që janë dhënë afër përgjigjeve të sakta duhet të kenë një lidhje të arsyeshme më pyetjen. Nëse nuk është ashtu, atëherë detyra me mundësi të shumta të zgjedhjes nën këto rrethana do të shëndërrohet në detyrë me përgjigje alternative. Kjo ndodhë atëherë, nëse nxënësit, në shikim të parë, zgjidhjet e pasakta i duken si përgjigje alternative.

Shembull : rrethoje përgjigjen saktë

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter dem Wasser.
	<input type="radio"/> über der Mauer.
	<input type="radio"/> in der Blume.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi tri zgjidhjet e para do t'i eliminojë menjëherë si të pasakta. Nga përgjigjia me mundësi të shumta të zgjedhjes nuk do të mbetet asgjë. Ndërtimi dhe formulimi nuk guxon t'ia lehtësojë nxënësit zgjidhjen.

Das Auto	<input type="radio"/> stehst unter der Straßen.
	<input type="radio"/> stehen über der Straßen.
	<input type="radio"/> steht auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi do të mund të zgjedhë mundësinë e tretë shumë shpejtë si të vetmën të saktë, sepse vetëm tek kjo mundësi kallëzuesi në njëjës përputhet me kundrinën e cila gjithashtu qëndron në njëjës.

1.2. Përgjigjet rregulluese

Karakteristikë e përgjigjeve rregulluese është se nxënësi duhet të rregullojë një sistem të dhënë. Këtu ekzistojnë dy mundësi :

- Klasifikim
- Rradhitje

përgjigjet klasifikuese

Nxënësit i jipen dy grupe fjalësh apo fjalishë. Ata kanë për detyrë që një pjese të grupit të parë t'i shtohet pjesa përkatëse e grupit të dytë.

Shembull : Klasifiko.

1. Peter	a) Griechenland
2. Armend	b) Deutschland
3.	c) Spanien
Giuseppe	d) Kosova
	e) Türkei
	f) Italien

Shembull: Çka përshtatet? Klasifiko.

1. die Schule	a) der Lehrer	d) das Geld	g) der Sandkasten
2. der Spielplatz	b) die Arbeit	e) die Maschine	h) der Schüler
3. die Fabrik	c) die Rutsche	f) das Tor	i) der Meister

Përgjigjet klasifikuese kanë përparësinë, sepse mësuesi mundet shumë mirë të vërtetojë, se a e ka kuptuar nxënësi logjikisht një problem.

- **përgjigjet rradhitëse**

Detyrë e nxënësve është që t'i vëjë në rradhë të duhur fjalitë, shkronjat dhe fjalët.

Shembull:

Vëri fjalitë në rradhën e duhur.

1. Es ist acht Uhr.
2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung.
3. Der Wecker klingelt.
4. Liridon kommt zu spät zur Schule.
5. Liridon hat verschlafen.
6. Der Autofahrer bremst scharf.
7. Er springt aus dem Bett.
8. Der Fahrer schimpft Liridon.
9. Er läuft schnell Weiter.

Zgjidhjen e drejtë të kësaj detyre mund ta lehtësojë një rradhë fotografishë.

Shembull: rradhiti shkronjat.

schueRt	
hrreeL	
Seluch	
mbsret	

Edhe tek ky shembull mund të paraqiten fotografi për lehtësimin e gjetjes së zgjidhjes.

Shembull: Rradhiti shkronjat drejtë.

Der	bremst	Autofahrer	Scharf
a	B	c	D

Shembull:

Rradhiti shkronjat drejtë në kutitë e rendit të parë.

Shkruaj shkronjën e fjalës joadekuate në kuti.

a) Der b) bremst c) Autofahrer d) groß e) scharf

Në këtë shembull shihet problematika. Si të bëhet vlersimi nëse dy nxënës vijnë me këto zgjidhje:

Nxënësi 1: *Der Autofahrer scharf bremst.*

Nxënësi 2: *Der Autofahrer bremst groß.*

Asnjëra nga dy zgjidhjet nuk është e saktë. Përderisa tek nxënësi 1. renditja e fjalëve është gabim nxënësi 2. ka zgjedhur ndajfoljen e gabuar. A nuk merr asnjëri nxënës pikë? Apo, a mund të thuhet se njëra nga të dy zgjidhjet është “më e saktë” kurse tjetra “ më pak e pasaktë”?

Nëse mësuesi dëshiron te testojë renditjen e drejtë të fjalëve në fjali: A mundet atëherë nxënësi 2 ta marrë njerën nga dy pikët e mundshme?

1.3. Përgjigjet e lira

Përgjigja e lirë karakterizohet përmes asaj, qe nxënësi duhet të reagojë në detyrën e dhënë të mësuesit, pa pasur mundësi zgjedhjeje.

- **Përgjigjet plotësuese**

Përgjigjet plotësuese, të ashtuquajtura gjithashtu përgjigje ë shkurtëra, praktikohen shpesh në shkollë.

Shembuj:

Viele Dinge sind schneller, schöner usw. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schöer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...

Elona ist groß. Sie ist nicht ...

Latra ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.

Morgen ... (spielen) ich Tennis.

Gestern ... (sein) ich im Kino.

- **Përgjigjet e shkurtëra hartuese**

Ky nocion mund të sjellë keqkuptime. Më këtë janë menduar përgjigjet e nxënësve sipas udhëzimit të mësuesit, të cilat paraprakisht nuk mund të vlerësohen qartë si të sakta apo të pasakta.

Shemull:

Formo një fjali prej këtyre dy fjalive.

Elira weint. Eine Wespe hat sie gestochen.

Te ky shembull nuk shfaqen probleme të mëdha gjatë vlerësimit. Më vështirë është te tregimet me fotografi, të cilat gjithashtu numërohen si përgjigje të shkurtëra hartuese. Për të gjithë nxënësit detyra është e njëjtë, sepse të gjithë i kanë në dispozicion fotografitë e njëjta. Megjithatë nuk mund të vlerësohet vetëm numri i informacioneve, sepse kriteret tjera luajnë një rol të rëndësishëm, psh. radhitja, zgjedhja e fjalëve, lidhjet, etj. Këto e vështirësojnë një vlerësim objektiv.

Qasjet ndërprogramore dhe ndërlëndore

Para se t'i hyjmë punës për planin e detajizuar për klasë, ne kemi punuar një llojplani të përafërt "global" për katër vite, në mënyrë që të kemi sado pak të qartë se ku duam të arrijmë pas përfundimit të katër klasëve (një nivel) d.m.th. klasët gjashtë - nëntë ose dhjetë – dymbëdhjetë (trembëdhjetë).

Arsyeja tjetër është që planet e punuara për klasë të kenë një ndërlidhje programore dhe të vazhdojnë përafërsisht aty ku janë ndërprerë vitin paraprak, të mos ketë përsëritje të objektivave të përgjithshëm ose kthim drastik prapa.

Ky plan është punuar sipas taksonomisë së Blumit dhe është i konceptuar ashtu që të mund të lexohet vertikalisht (përparimi sipas taksonomisë për një vit shkollor) dhe horizontalisht që dmth. përcjellja e një objekti prej vitit në vit në një shkallë më të lartë.

Për të pasur më të qartë ja tabela në vijim:

	1. Lernjahr	2. Lernjahr	3. Lernjahr	4. Lernjahr
Lernziel 1	Einfache sprachliche Kontakte herstellen	Miteinander sprechen	In mündlichen und schriftlichen Kontakten persönliche Mitteilungen machen	Über Ereignisse berichten
Lernziel 2	Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen	Über Gegenstände und Tätigkeiten Aussagen machen	Sachinformationen einholen und weitergeben	Gegenstände und Vorgänge beschreiben
Lernziel 3	Anweisungen verstehen und Fragen beantworten	Anweisungen verstehen und erteilen	Anweisungen geben und Aufforderungen äußern	Tätigkeiten und Vorgänge beschreiben
Lernziel 4	Sich orientieren und verständigen	Angaben zur örtlichen Umgebung machen	Angaben zu Zeit, Lage und Raum machen	Mitteilungen sachlichen Inhalts machen

Lernziel 5	Sprachliche Kontakte knüpfen	Wünsche und Gefühle äußern	Erlebtes und Gehörtes wiedergeben	Vorgegebene Geschichten und Erlebnisse mündlich und schriftlich darstellen
Lernziel 6	Einfache Auskünfte einholen und erteilen	Persönliche Daten erfragen und Angaben machen	Die eigene Meinung darstellen	Über Zukünftiges und Erdachtes berichten

Në anën tjetër gjuha që pikësëpari shërben si mjet komunikimi nuk mësohet ekskluzivisht në orët e gjuhës por në një formë a në një tjetër tek të gjitha lëndet mësimore përdorin në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për atë që sa gjuha ndihmon tek lëndet e tjera, atë mund të ndihmojnë lëndet tjera për arritjen e objektivave brenda mësimin të gjuhës gjermane. Para së gjithash edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht se gjuha para së gjithash është e nderlidhur me artet sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjtë (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e shtatë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në fazën e parë të orës (EVOKIMI), ku varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët tjera (nxënësit i parapërgadisim për temën).

Të ndërlidhura më shkencat shoqërore e që vetëdijësojnë nxënësit për qështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathhtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e shtatë (e sidomos me edukatën qytetare)

Ndërlidhja ekziston edhe me shkencat natyrore sidomos të potencuara janë ato njohuri që kanë të bëjnë me ambijentin, ruajtjen e tij, shëndetin (ruajtjen e shëndetit të vet e të të tjerëve), ushqimin, etj.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për shkak të specifikave të arsimit profesional, grupi i ekspertëve mendon se zgjedhja e teksteve mësimore duhet t'i lihet mësimdhënësve sipas profilit në të cilin punojnë.

Mirëpo, si alternativë propozohen këto tekste mësimore:

MENSCHEN, A1/1, Kursbuch/Arbeitsbuch, HUEBER Verlag, Ismaning, 2016

SCHRITTE International, A1/1, Kursbuch/Arbeitsbuch, HUEBER Verlag, Ismaning

Kurrikula lëndore/programi mësimor
Gjuhë frënge (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Gjuha frënge, si gjuhë zyrtare e OKB-së, e diplomacisë, e kulturës, e artit, e modës, e mirësjelljes, etj., është njëra ndër gjuhët më të rëndësishme botërore dhe paraqet interes për t'u mësuar edhe më tutje kudo në botë, prandaj edhe në Kosovë. Pas ndryshimeve të mëdha në vendin tonë (politiko-shoqërore, arsimore, etj.), ajo mbetet gjuhë me interes për gjeneratat tona të tashme dhe të ardhme, jo vetëm si mundësi komunikimi në këtë gjuhë në botë, por edhe si mundësi ndërtimi e karrierës, e punësimit, e studimeve, etj.

Sipas Kurrikulës Bërthamë (KB) për Shkollën e Mesme të Lartë (ShML), gjuha frënge, si gjuhëe dytë e huaj, me mundësi zgjedhjeje, do të mësohet me 2 orë mësimi në javënë klasën e 10. Nëpërmjet mësimit të gjuhës frënge nxënësitet kësaj klase do të përvetësojnë një fjalor fillestar të kësaj gjuhe të huaj, të domosdoshëm për komunikim; do të avancojnë më tutjeshkathtësitë kryesore gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe do të zhvillojnë kapacitetet intelektuale të tyre në këtë fushë. Ky fjalor fillestar i nxënësve në këtë gjuhë të huaj, me kohë, do të pasurohet gradualisht edhe me një qasje ndërdisiplinare të mësimdhënies së kësaj lënde me lëndët e tjera mësimore. Kysynim mbështetet në krijimin e një atmosferë pozitive dhe garuese gjatë orës së mësimit dhe në identifikimin e mënyrave dhe strategjive të të mësuarit.

Qëllimet

Mësimi i gjuhës frënge në klasën e 10 kërkon arritjen e njohurive gjuhësore sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (A1.1 - 1/2 e nivelit A1), të përcaktuara në bazë të numrit të orëve mësimore në javë, të cilat janë të matshme nga institucione përkatëse të kësaj fushe, që përfshijnë përvetësimin e një fjalori fillestar të gjuhës frënge nga nxënësit dhe përdorimin elementar të tij për nevoja personale; njohjen dhe dallimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë); përforcimin e mëtejshëm të shkathtësive gjuhësore receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe shkathtësive produktive (të folurit dhe të shkruarit); rritjen e kapaciteteve intelektuale të tyre; konsolidimin dhe integrimin e njohurive; formimin e të menduarit kritik dhe krijues; zbulimin e një kulture të re për ta dhe formimin e gjyqimit të drejtë për botën; formimin e një personaliteti tolerues, respektues, bashkëpunues dhe human dhe formimin e një qytetari të dobishëm dhe të përgjegjshëm për shoqërinë.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

2 orë në javë, 68 orë në vit

Koncepti	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Tekste letrare dhe joletrare	Informata personale dhe familjare	<p>TË DËGJUARIT</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kupton përshëndetjet dhe dallon ato të formës formale dhe joformale. Kupton format e falenderimit dhe kërkimfaljet • Kupton fjali të thjeshta dhe shprehje të izoluara rreth vetes dhe ambientit që e rrethon • Kupton biseda rreth familjes, shkollës, banimit, aktiviteteve të lira dhe gjërave konkrete nëse njerëzit flasin ngadalë dhe përdorin gjuhën e përditshme. • Kupton informata të thjeshta rreth motit.
Pjesët skenike, teatri, dramatizimi, etj	Aktivitetet e lira, preferencat	<p>TË FOLURIT</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor shprehje ose fjali të thjeshta për t'u prezantuar ose për të prezantuar të tjerët. • Përkrauan vendin ose njerëzit që njeh.
Sistemi i gjuhës	Banimi	

Të mësosh frëngjishten si gjuhë e huaj do të thotë të përvetësosh njohuri të caktuara dhe të jesh në gjendje t'i përdorësh në situata të jetës reale. Për këtë qëllim duhet ndjekur dy parime kryesore: 1) përqendrimi në komunikim dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë; 2) përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij. Përvetësimi i shkathtësive gjuhësore zë vend parësor në mësimin e gjuhëve të huaja.

Forma komunikative e mësimdhënies

Mësimdhënia më e mirë e kësaj gjuhe të huaj të gjallë bëhet në formë komunikuese, prandaj komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo formë e mësimdhënies ua mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që u nevojiten për t'u shprehur në klasë, kurse më vonë edhe në situata të caktuara të jetës së përditshme. Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

Metodat e mësimdhënies

Për mësimin e gjuhës frënge mësimdhënësi duhet të përdorë metoda bashkëkohore sepse vetëm ato nxisin komunikimin e drejtpërdrejtë në këtë gjuhë dhe jo metodën tradicionale (megjithëse ajo mund të mbetet si një metodë ndihmëse në një fazë të parë të mëimit të saj). Natyrisht, ato stimulojnë përdorimin e gjuhës frënge gjatë orës së mëimit, aq sa njohuritë paraprake të nxënësve e mundësojnë të kuptuarit e tyre. Puna në grupe ose në qifte, dialogjet e shkurtra, lojërat në role, tekstet e shkurtra, materialet pamore dhe format e punës që nxisin punën e pavarur, kreativitetin dhe frymën garuese të nxënësve në klasë, poashtu, janë shumë të rëndësishme. Duhet përdorur metodologji të punës që nxitin aktivitetet prodhuese të nxënësve.

Renditja e veprimeve

Për një mësim të efektshëm të frëngjishtes si gjuhë e huaje dytëeshtë e nevojshme të respektohet kjo renditje e shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit dhe të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit. Puna aktive dhe konkrete: mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat e punës (si një mes jofrankofon) që dallohen shumë nga ato të Francës ose të një vendi tjetër frankofon. Ushtrimet duhet të zënë vend meritore, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

Korrigjimi i gabimeve të nxënësve

Mënyrat e korrigjimit të gabimeve të nxënësve diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë që ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përseriten, të tjerët mendojnë që ato nuk duhet të korrigjohen me çdo kusht. Sido që të jetë, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

Mësimdhënia / nxënia e diferencuar

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake nga gjuha frënge dhe aftësitë psikofizike dhe intelektuale të tyre, prandaj mësimdhënësit duhet të organizojnë orën mësimore mbi këtë bazë. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie

më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

Teknikat e punës

Një ndër detyrat e mësimdhënies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të përgatiten dhe të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies së gjuhës frënge dhe të organizojnë procesin e të mësuarit të saj në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore dhe të vazhdojnë proceset e mësimi të gjuhës.

Përdorimi i mediave

Kompjuteri dhe internetipërbëjnë një mjet shumë të dobishëm dhe të përhershëm që duhet shfrytëzuar si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato të dramës dhe emisionet e ndryshme televizive të jashtme në gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm që do të ndihmojë dhe përshpejtojë përvetësimin e saj nga nxënësit tanë.

Filmi, teatri, muzika, poashtu, përbëjnë mjete të rëndësishme motivuese për arritjen e rezultateve më të mira në përvetësimin e gjuhës frënge. Fotografitë ndihmojnë sajimin e teksteve kreative dhe përshkruese. Ato tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia. Videoprojektori rrit interesimin e nxënësve për mësimin e saj. Kjo arrihet me: prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit. Materiali auditiv mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit e nxënësve përmes dëgjimit. Videomateriali u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë. Shfaqja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose përralle nxit krahasimin me tregimin ose me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërlëndore / ndërkurrikulare

Mësimi i një gjuhe të huaj ofron mundësi të shumta për lidhje ndërlëndore dhe ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë dhe gjuhës së huaj të dytë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, në një rën anë, përmes njohurive nga lëndët e tjera, nxënësit do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët e tjera. Përmbajtjet e çështjeve ndërkurrikulare dalin nga temat lidhur me paqen, të drejtat e njeriut, zhvillimin e mediave, barazinë gjinore, shkathësitë për jetë, kujdesin ndaj mjedisit, shëndetin dhe mirëqenien etj. Çështjet ndërkurrikulare mund të realizohen nëpërmjet projekteve të natyrave të ndryshme, debateve për tema të caktuara, diskutimeve, hulumtimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, vizitave të institucioneve shëndetësore, etj. Kjo do të arrihet përmes një

časjeje të integruar të mësimdhënies së gjuhës frënge me çështje, aspekte dhe fusha të ndryshme të lëndëve të ndryshme. Kjo çasje e bën më të lehtë dhe më të shpejtë përvetësimin e njohurive nga kjo gjuhë dhe njëkohësisht ato integrohen mes vete dhe bëhen shumë më të qëndrueshme. Prandaj, gjatë përgatitjes së planit vjetor caktohen temat mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore. Për të ndihmuar këtë kërkohet që planet vjetore të kenë formatin e njëjtë në të cilin shënohet korrelacioni i cili do të ndihmojë funksionimin e lidhjes ndërmjet fushave dhe lëndëve.

Udhëzime për vlerësim

Për fushën Gjuhët dhe Komunikimi vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi i rezultateve të arritura të nxënësve në mësimin e gjuhës frënge u siguron nxënësve informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së kompetencave. Vlerësimi duhet të përqëndrohet në njohjen e fjalorit të gjuhës frënge, në të kuptuarit e tij në një kontekst të caktuar dhe në përdorimin e tij në komunikimin e përditshëm, duke zbatuar njohuritë e tyre nga fonetika, gramatika dhe përvojën e tyre paraprake në komunikimin në gjuhën angleze. Gjatë të shprehurit gojor dhe shkrimor vlerësohet përvetësimi i drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit. Natyrisht, për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive gjuhësore të nxënësve duhet të mbështetemi në qëllimin e vlerësimit, në informatat cilësore për vlerësim, në vlerësim të balancuar, në shkallën e saktë të arritshmërisë së nxënësve dhe në përdorimin e instrumente adekuate për vlerësim (vrojtimi, pyetësi, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, testi i bazuar në kriteredhe objektiva dhe testi i arritshmërisë sipas kërkesave).

Llojet e vlerësimeve: ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit të njohurive të nxënësve si: vlerësimi diagnostik (identifikimi i aftësive dhe vështirësive të nxënësve në mësim); vlerësimi i jashtëm (vlerësim nëse njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi të kalojë në klasën e radhës); vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë); vlerësimi parashikues (parashikim i dështimeve dhe sukseseve potenciale të nxënësve); vlerësimi përfundimtar (përparimi i nxënësve dhe rezultatet e arritura në mësim); vlerësimi selektiv (vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim); vlerësimi somativ (mundëson vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara nga nxënësi në fund të një viti shkollor, klasifikimin e nxënësve dhe konstatimin nëse nxënësi i ka arritur kompetencat për të kaluar në klasën vijuese); vlerësimi formativ (konsiston në vlerësime interaktive që tregojnë të arriturat dhe progresin ose mangësitë e nxënësve gjatë të nxënësve).

Çfarë duhet të vlerësohet? Të kontrollohen njohuritë e fituara; përparimi i nxënësve; shkalla e zhvillimit të nxënies; shkalla e zotërimit të gjuhës frënge; shkalla e integritit të njohurive të fituara; aktivitetet jashtëshkollore.

Mënyrat e vlerësimit: kontrolli i vazhdueshëm; vlerësimi i drejtpërdrejtë (me tabelë); vlerësimi i tërthortë (me test); vlerësimi objektiv (me tabelë); vlerësimi subjektiv (pa tabelë); vlerësimi nga

nxënësit (vlerësimi i njëri-tjetrit); vlerësimi në grupe nxënësish brenda klase (me tabelë); vetëvlerësimi i nxënësve (secili nxënës vlerëson vetveten).

Kriteret e vlerësimit: aktivitetet e të shprehurit; të shprehurit gojor; të shprehurit me shkrim; aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim); aktivitetet e riprodhimit (të shprehur me gojë dhe me shkrim. Notat numerike jepen sipas shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit; të shkruarit (5, 4, 3, 2, 1).

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për arritjen e rezultateve të nxënësve të klasës së 10 në gjuhën frënge, në rend të parë është i rëndësishëm përdorimi i literaturës didaktiko-metodike të kësaj gjuhe të huaj (në gjuhën shqipe dhe frënge), i materialeve të pasura didaktike nga burime (linqe) të ndryshme përmes internetit për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për lëndë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve. Metoda franceze për mësimin bashkëkohor të gjuhës frënge, "Interactions" (pjesa e parë nga 2 pjesët e saj të barabarta), e lejuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë për përdorim në ShML të Republikës së Kosovës, bashkë me pjesët përbërëse të saj, përbënmjetin kryesor të punës dhe burimin kryesor të informatave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo edhe të vetmin mjet dhe burim që mësimdhënësi i gjuhës frënge dhe nxënësit e tij mund dhe duhet të përdorin. Ata kanë në dispozicion mundësi shumta për sigurimin e mjeteve mësimore të pasura, nga burime të ndryshme për marrjen e informacionit, me kusht që ato të përzgjedhen me kujdes, varësisht nga mosha e nxënësve, njësia mësimore, qëllimi i saj dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme për nxënës.

FUSHA KURRIKULARE: ARTET

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Art figurativ (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Art muzikor (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor
*Art figurativ (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)*

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Art figurativ për klasën e dhjetë është një nga lëndët e rëndësishme brenda fushës kurrikulare Artet, e cila së bashku me lëndët e tjera të kësaj fushe ka një ndikim dhe rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve dhe kultivon kulturën artistike, intelektuale, shpirtërore dhe emocionale tek nxënësit.

Përmes artit zhvillohen vlerat shoqërore dhe formimi i personalitetit dhe identitetit personal e kulturor, duke kontribuar në arritjen e kompetencave e të nxënit të Kurrikulës Bërthamë.

Lënda Art pamor në klasën e dhjetë fokusohet në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive dhe shkathtësive të artit pamor dhe përdorimin e tyre në krijimtari artistike duke zhvilluar kreativitetin, imagjinatën, mendimin kritik dhe shijen estetike.

Arti pamor përmes gjuhës artistike iu jep mundësi shprehëse dhe komunikuese nxënësve për të pasqyruar idetë dhe qëndrimet e tyre përmes veprave artistike.

Lënda e artit synon të vë në pah rolin dhe rëndësinë e artit për shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe zhvillimin e shkathtësive krijuese dhe talentit artistik të nxënësve me prirje artistikesi një mundësi për studime të mëtutjeshme në krijimin e individualitetit të tyre artistik e profesional.

Qëllimi

Lënda e artit pamor për klasën e dhjetë, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim:

- Zgjerimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve në art pamor;
- Zhvillimin dhe formimin estetik, artistik, personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- Njohjen e rolit dhe rëndësisë së artit për individin dhe shoqërinë;
- Zhvillimin e shkathtësive kreative e artistike për të komunikuar ndjenjat, idetë dhe mendimet përmes punimeve artistike;
- Shkathtësinë e përdorimit të elementeve dhe parimeve të artit në punime artistike;
- Njohjen dhe përzgjedhjen e materialeve, teknikave dhe mjete të ndryshme artistike dhe përdorimi i tyre në vepra arti;
- Kultivimin e shijes dhe përjetimit estetik të veprave të artit;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për të vlerësuar dhe analizuar vepra arti;
- Zhvillimin e aftësisë për të identifikuar veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE	Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike <i>(Vizatimi, Piktura, Grafika, Skulptura, Artet aplikative, Dizajni, Fotografia, Arkitektura, Arti publik etj.)</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon llojet e vizatimit, të cilat i praktikon në realizimin e veprave artistike vizatimore • Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të vizatimit • Dallon dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike • Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin, etj); • Njeh karakteristikat dhe veqoritë shprehëse të grafikës • Aplikon dhe përvetëson teknikat e grafikës gjatë punës së të shprehurit artistik • Njeh rëndësinë e formës si elementi bazë për realizimin e skulpturës • Vërenë dallimin midis relievit dhe skulpturës

		<p>tridimensionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme • Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale. • Përpunon imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike. • Dallon dhe përdor llojet e artit public për të realizuar punime artistike • Realizon punime në teknikën e grafitit përmes të cilave prezantonë pikëpamjet e tij • Dallon artin aplikativ nga arti figurativ • Realizojnë punime të ndryshme të artit aplikativ në teknikën e qeramikës • Dallojnë karakteristikat e veçanta të pikturës aplikative • Realizonë piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe afreskut • Njeh rolin dhe rëndësinë e dizajnit në industri duke krijuar dizajne të produkteve të ndryshme. • Realizon punime të ndryshme në dizajn të modës dhe enterierit etj. • Dallon elementet dhe funksionin bazë të arkitekturës për shoqërinë • Përzgjedhë dhe përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë
<p>GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK</p>	<p><u>Elementet figurative</u></p> <p><i>(Vija, forma, ngjyra, tonaliteti, vëllimi, tekstura, hapësira, madhësia etj)</i></p> <p><u>Parimet e artit</u></p> <p><i>(Baraspesha, harmonia, kompozimi, gradacioni,</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe përshkruanë rëndësinë e vijës si element figurativ • Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike • Dallonë formën dydimensionale nga forma tridimensionale • Realizon punimi duke përdorur elementin e formës • Përshkruan dhe shpjegonë rolin dhe rëndësinë e ngjyrave në art pamor • Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike

	<p><i>bashkësia, proporcionet, sipërfaqja, ritmi, kontrasti)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan procesin e realizimit të toneve të ndryshme në vepra artistike • Identifikon llojet e ndryshme të toneve dhe përdor ato në punimet e tij • Dallon dhe përdor vlerat e dritë hijes në forma të ndryshme figurative në një vepër arti • Dallon dhe aplikojnë vëllimin në vepra dy dhe tri dimensionale • Dallon lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë • Shpjegon procesin e realizimit të tekstarave të ndryshme • Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës (dallimin midis hapësirës reale dhe artistike) • Përdor perspektivën me një pikë dhe dy pika për të krijuar iluzionin e hapësirës në punimet dydimensionale • Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike • Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike • Identifikon llojet e ndryshme të barazpeshave dhe rëndësinë e tyre në vepra artistike • Realizon një punim duke përdorur parimin e Baraspeshës • Përshkruan dhe identifikonë harmoninë tek vepra të ndryshme artistike • Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë • Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e sakt të raportit në mes të formave të ndryshme • Përdor me efektivitet masën si matës të sakt në proporcionet e trupit të njeriut dhe portretit • Përshkruajnë rolin dhe rëndësinë sipërfaqes në art • Dallojnë sipërfaqen natyrore nga ajo artistike dhe aplikojnë në punime artistike • Identifikon procesin dhe elementet kryesore për
--	--	--

		<p>realizimin e sipërfaqeve në vepr arti</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizojnë ritmin në punime të ndryshme artistike të artistëve të njohur dhe në punimet e tyre apo të shokëve • Dallojnë dhe aplikojnë lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre. • Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të berë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti • Përdorin lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike
<p>RELACIONI ART – SHOQËRI</p>	<p>Ekspozita dhe aktivitete kulturore Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet. Ekspozita me punimet e nxënëve për projekte të ndryshme dhe në fund të vitit Takime me artistë, dizajnë e artizanë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet; • Merr pjesë në ligjërata dhe takime me artistë, kurator, estet, filozof të artit, seminare dhe ngjarje tjera të artit.
	<p>Vizita dhe ngjarje artistike Vizita në Galeri arti dhe ekspozita të ndryshme Vizita në muzeume, (arkeologjik, etnografik) Vizita në objekte të trashëgimisë kulturore, etj. Vizita në atele (studio) të artistëve, Vizita në punishte të artizanëve Vizita në qendra</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Viziton atele dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist • Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në fqaë të ndryshme etj

	kulturore	
	<p>Histori arti Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore</p> <p>Arti në lashtësi Arti në parahistori Arti i Mesopotamisë Arti Egjiptian</p> <p>Antika Arti Ilir Arti antik Grek Arti Romak</p> <p>Arti Islam Arti mesjetar Koha e re Arti i Rilindjes Arti barok Realizmi Impresionizmi</p> <p>Drejtimit e artit modern shek XX Fovizmi Ekspresionizmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit • përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit • Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike; • Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik; • Njeh përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike • Identifikon dhe dallon kryeveprat artistike të artistëve të njohur • Shqyrton rëndësinë e artit përgjatë zhvillimeve të ndryshme historike për shoqërinë • Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale; • Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale që ndikuan në zhvillimin e artit • Përshkruan dhe vlerëson vepra arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore të trojeve shqiptare, • Identifikon dhe analizon simbolet në vepra të artit për të lexuar kuptimin e tyre; • Identifikon dhe analizon elementet dhe parimet e gjuhës pamore dhe teknikën e përdorur në vepra të artit;

	<p>Kubizmi Futurizmi Abstraksionizmi Dadaizmi Surrealizmi Arti bashkëkohor <i>Pop-arti</i> <i>Op-arti</i> Arti Postmodern Arti Konceptual <i>Minimalizmi</i> Postmodernizmi</p>	
<p>ÇMUARJADHE VLERËSIMI ESTETIKO- ARTISTIK</p>	<p>Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit</p> <p>Vlerësimi i Veprave artistike</p> <p>Analiza e punimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanton punime të ndryshme artistike, duke përdorur forma të ndryshme prezantuese. • Reflektinë mendimin dhe gjykimin e tij mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj. • Të menduarit kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik • Analizonë dhe vlerësojë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike. • Kultivon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike dhe rafinon shijen e tij estetike në art. • Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupore brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore • Zhvillojnë aftësinë se Si të lexojmë një vepër arti? • Njihen me metodat dhe hapat që ndjekin kritikët për të vlerësuar veprat e artit • Dallon objektin e studimit të estetikës dhe cilësitë estetike në një vepër arti • <i>Krijojnë kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit</i>

Udhëzimet metodologjike

Për organizimin sa më të mirë të procesit mësimor, për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme dhe për realizimin e planprogramit mësimor në lëndën e artit pamor duhet të përdoren metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Këto metodologji janë në shërbim të rritjes së cilësisë së sukseseve dhe arritjeve të mësimnxënjes nga ana e nxënësve, duke i ofruar mundësinë që të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin krijues/artistik që zotërojnë brenda vetes.

Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësve të lëndës së artit pamor (RNL), fushës së arteve (RNF) dhe kompetencave kryesore të Kurrikulës Bërthamë (RNK).

Përzgjedhja e metodologjive është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës, dhe ato përgjithësisht në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Duke marrë për bazë natyrën e lëndës së artit pamor që më tepër është veprimtari praktike, ku nxënësit realizojnë vepra të ndryshme artistike, edhe metodologjitë përzgjidhen në atë mënyrë që nxënësi të motivohen për pejsmarrje aktive në këto aktivitete si një mundësi që ata përmes përdorimit të mjeteve të larmishme artistike të reflektojnë idetë, qëndrimet dhe mendimet e tyre. Ata janë aktiv kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Mësimdhënia në artin pamor synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet *në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.*

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor merr parasysh:

- Zhvillimin dhe forcimin e njohurive dhe shkathtësive bazë të artit pamor duke u mbështetur në ato paraprake;
- Kompetencat kryesore të të nxënësve në artin pamor;
- Nxitjen e të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- Motivimin e nxënësve, për krijimtari artistike dhe punë të pavarur
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- Veçoritë e veprimtarive individuale dhe në grup;
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në procesin mësimor

- Eksperiencat gjatë vizitave nëpër institucione të artit (galeri, muze)

Secila metodologji duhet të jetë në shërbim të interesave dhe nevojave të nxënësve dhe t'i inkurajojë ata të kenë besim në arritjen e suksesit në fushën e artit.

Për të zhvilluar sukseshëm procesin mësimor mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë, të stimuloj dhe inkurajoj nxënësit për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme duke planifikuar shumëllojshmëri aktivitetesh, materialesh, teknikash dhe informacionesh ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar sa më shumë mbi artin pamor.

Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike.

Format e punës në lëndën Art pamor

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të lëndës së artit pamor aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale
- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Në sistemin arsimor temat ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë disa aftësi dhe njohuri specifike, në mënyrë që të përgatiten për jetën dhe punën në të ardhmen dhe të përballojnë dhe tejkalojnë me lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Në temat ndërkurrikulare integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Temat ndërkurrikulare të cilat trajtohen në fushën e arteve janë:

- *Edukimi për qytetari demokratike*
- *Edukimi për paqe*
- *Globalizimi dhe ndërvarësia*
- *Edukimi për media*

- *Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm*

Këto tema mund të ndërlihen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me programin e lëndës së artit.

Edukimi për qytetari demokratike

Në temën Edukimi për qytetari demokratike përmes artit nxënësit mund të trajtojnë tema për qytetërimet dhe demokracinë dhe në këtë formë të formojnë identitetin e tyre qytetar e kulturor, si qytetar aktiv për mirqenien e tyre dhe të komunitetit.

Edukimi për paqe

Nxënësit në lëndën e artit mund të trajtojnë dhe realizojnë tema që kanë të bëjnë me paqen, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, dinjiteti njerëzor, diversitetit kulturor, toleranca, humanizmi, harmonia dhe bashkëjetesa.

Globalizimi dhe ndërvarësia

Nxënësit trajtojnë tema që kanë të bëjnë me epokën e globalizimit në sfera të ndryshme shoqërore si në art, kulturë, ekonomi, arsim etj. Dhe ndërvarësia dhe raporti i zhvillimeve të kulturave të ndryshme shoqërore, duke krijuar një këndvështrim pozitiv e pranues ndaj këtyre përvojave dhe kulturave.

Edukimi për media

Edukimi për përdorimin e medias është një imperativ i kohës për nxënësit, e cila u siguron informacione për zgjerimin e njohurive të tyre mbi zhvillimet historike të artit, autor, vepra arti, teori dhe problem artistike, duke zhvilluar dhe kultivuar shkathësinë dhe kulturën hulumtuese për trajtimin e problemeve të caktuara. Gjithashtu Median mund të përdorin edhe për krijime artistike dhe prezantimin e projekteve të ndryshme artistike.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm është një proces i cili i përgatitë nxënësit me aftësi të qëndrueshme që garanton mundësitë për një jetë më të mirë. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi shoqërinë, në aspektin kulturor-artistik, social, ekonomik dhe mjedisor.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Vlerësimi përfshinë tërë veprimtarinë dhe konsiderohet si element i mësimdhënies që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase dhe shkolle të nxënësit si dhe zotërimin e kompetencave. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në

arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi individual i nxënësve bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrinë të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit si me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësit, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit pamor.

Qëllimet e vlerësimit:

- *Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftushme.*
- *Të motivohen nxënësit për punë*
- *Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave*
- *Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit.*
- *Të përmirësohen nxënia dhe mësimdhënia*
- *Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve.*
- *Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës.*
- *Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm*

Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimdhënësit përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të

reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

Metodat e vlerësimit

- **Vlerësimi me gojë** - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, diskutime të nxënësve me njëri tjetrin etj.
- **Vlerësimi me anë të dëgjimit** - duke diskutuar me nxënës të veçantë, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri - tjetrin për një koncept, mbi njohuri të arteve pamore, vepër apo detyrë artistike etj.
- **Vlerësimi i detyrave të realizuara** - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga ideimi deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë konkrete (fjala vjen realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).
- **Vlerësimi i projekteve të ndryshme**-bashkëpunimi i nxënësve në një projekt në bazë shkolle apo krahine.
- **Vlerësimi i punëve artistike** - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj., pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.
- **Vlerësimi me shkrim ose testimi** - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe teste për një linjë të caktuar, semestrare dhe vjetore.
- **Vlerësimi përmes portofolit**- portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme dy dhe tredimensionale të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Instrumentet e procesit të vlerësimit

- Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura);
- Testi i strukturuar me gojë;
- Lista e kontrollit;
- Pyetësi;

- Fleta për intervista;
- Anketa;
- Eseja;
- Projekti;
- Dosja/Portofoli.

Udhëzime dhe burimet e mjetet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e artit pamor duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike pamore me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjerimin e njohurive mbi artin tek nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete vizuale – *pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*
- Mjete audiovizuale – *pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- Mjedisi mësimor (*klasa, ateleja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.*).

Kurrikula lëndore/programi mësimor
Art muzikor (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Muzika është art i organizimit të tingujve që shpreh në mënyrë karakteristike me nje gjuhë universale aspektet e ndryshme intelektuale, emocionale dhe shpirtërore të përvojës njerëzore përgjatë gjithë zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore. Arti muzikor në praktikë gjithmonë është kombinuar me format tjera të shprehjes artistike si letërsia, poezia, vallëzimi etj. Me qenë se muzika është e pranishme kudo në jetën tonë të përditshme (në shkollë, shtëpi, TV, film, koncert, teatër, ngjarje familjare, ngjarje brenda dhe jashtë shkollës) ajo ka ndikim në formimin e personalitetit të njeriut, e sidomos të personalitetit të adoleshencës, kështu që gjithnjë duhet pasur kujdes të veçantë se çfarë muzike po u ofrojmë për dëgjim këtyre moshave duke i respektuar edhe interesin e formimit të nje shije të kultivuar estetike muzikore por edhe duke i respektuar interesat e tyre muzikore.

Për të qenë një personalitet i kompletuar dhe i kulturuar e me informacione e shije të kultivuar estetiko-muzikore, nxënësit që nga klasa e X e deri në klasën e XI apo XII, varësisht nga tipi i gjimnazit, do të njihen me zhvillimin historik kronologjik të artit muzikor nëpër periudha të ndryshme historike përmes vetë përmbajtjeve muzikore dhe muzikimit praktik, krahas informacioneve, fakteve, pamjeve, e burimeve të tjera të trajtojnë krijimtarinë muzikore në kontaktin historik. Pra në këtë nivel (X-XII) kryesisht dominon tërësia tematike 3 (Muzika dhe Shoqeria) por ajo plotësohet edhe me tri tërësitë tjerë tematike sic janë 1. krijimtaria dhe performanca artistike, 2. gjuha dhe komunikimi artistik si dhe 4. çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik.

Qëllimi

Qëllimi i Artit muzikor është që nxënësit përmes dëgjimit të veprave muzikore të përjetojnë dhe vlerësojnë vlerat e muzikës botërore dhe kombëtare, të japë kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë, dhe të marrin pjesë aktive në organizimet kulturore në klasë, shkollë dhe komunitet.

Programi i muzikës në klasën e X, përmes 4 tërësive kryesore tematike të saj, vihet në shërbim të realizimit të këtij qëllimi dhe synon zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve për formimin muzikor, estetik dhe kulturor; zhvillimin e aftësive interpretuese muzikore dhe aftësinë për të dëgjuar, përjetuar dhe vlerësuar vepra të muzikës botërore nga periudha të ndryshme kulturore si edhe veprat muzikore ku përfaqësohet trashëgimia jonë kombëtare muzikore.

Arti muzikorë në nivelin e trete të arsimit, pranadaj edhe në klasën e X, veçanërisht, synon të përmbushë këto aspekte themelore:

- Aftësimin e nxënësve për identifikimin dhe të kuptuarit e rrethanave shoqërore dhe historike të zhvillimit të arteve në periudha të ndryshme historike e në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- Inkurajimin e nxënësve që edhe në këtë nivel të marrin pjesë aktivisht në veprimtaritë muzikore (këndim, luajtje në instrumente muzikore dhe krijim) sipas prirjeve dhe interesimit
- Përdorimin më të avancuar dhe të integruar apo atë sintetizuar të elementeve të gjuhës artistike dhe rregullave të komunikimit artistik duke përdorur medime të ndryshme, përfshirë edhe teknologjinë bashkëkohore dhe teknologjinë muzikore
- Përforcimin e aftësisë për të vërejtur, përjetuar, cmuar dhe për të vlerësuar të bukurën në art dhe në ambientin e përditshëm që i rrethon nxënësit.) duke zhvilluar edhe aftësinë për çmuarje dhe vlerësim kritik estetik dhe kultivimin e një kulture të kritikës konstruktive.
- Zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj artit dhe kulturës materiale e shpirtërore popullore si pjesë e shumësisë së identiteve (si identiteti personal, lokal, kombëtar, global etj)

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Krijimtaria dhe performanca artistike	1. Këngët	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit këndojnë individualisht dhe ne grup këngë në tema dhe zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë, etj.) me tematikë që i përshtatet interesit dhe moshës së nxënësve të klasës së X (dashurisë, këngë patriotike, këngë popullore, këngë të lehta argëtuese për çaste festive etj) • Nxënësit këndojnë motive e tema të njohura të veprave muzikore vokale dhe instrumentale nga periudha të ndryshme stilistike
	2. Interpretim në Instrumente muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit interpretojnë shoqërime këngësh dhe pjesë të vogla instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal në zhanre të ndryshme që ata i preferojnë. • Formojnë bendet muzikore, grupet e vallëzimit etj sipas interesimit të tyre
Gjuha dhe komunikimi artistik	<p>1. Gjuha artistike muzikore dhe shkrim leximi muzikor</p> <p>2. Format muzikore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit njohin elementet themelore të zhvillimit historik të elementeve të muzikës dhe të shkrimit dhe leximit muzikor në periudha të ndryshme • Nxënësit dallojnë dhe emërojnë saktë elementet e muzikës (ritmin, metrin, melodinë, intervalet, harmoninë, tempin, dinamikën) përmes këngëve dhe dëgjimit muzikor. • Nxënësit dallojnë karakteristikat e formave muzikore si sonata, simfonia, koncerti, suita ne periudha te ndryshme historike e në zhanre e stile të ndryshme muzikore
Muzika dhe shoqëria	<p>1. Zhvillimi historik i zhanreve dhe stileve muzikore</p> <p>2. Instrumentet dhe formacionet muzikore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dallojnë dhe njohin karakteristikat e zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok) përmes dëgjimit muzikor • Nxënësit dallojnë karakteristikat

		<p>stilistike dhe fitojnë njohuri për artin muzikor në epoka të ndryshme, njohin veprat dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të atyre epokave.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dallojnë instrumentet muzikore dhe formacionet karakteristike të periudhave të ndryshme historike
	3. Institucionet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit njohin dhe emërojnë institucionet muzikore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme historike-stilistike muzikore • Nxënësit emërojnë dhe prshkruajnë e mundësisht vizitojnë institucionet muzikore në komunitet dhe vend
	3. Krijuesit dhe performuesit	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dallonjnë krijuesit, performuesit dhe veprat artistike nga krijimtaria artistike, popullore kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme (se paku nga 3 për cdo periudhe stilistike-muzikore)
Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vepra muzikore 2. Ngjarje muzikore 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dallojnë karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen) • Nxënësit emërojnë përmes dëgjimit muzikor disa nga veprat e dëgjuara muzikore gjatë vitit (se paku 10) • Nxënësit përjetojnë dhe vlerësojnë muzikën e epokave të ndryshme duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik • Nxënësit komentojnë ngjarje të ndryshme nga jeta artistike kombëtare dhe botërore • Nxënësit marrin pjesë në koncerte, ngjarje muzikore, dokumentarë për krijues dhe interpretues muzikor. • Nxënësit krijojnë CD me pjesët më të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore klasike apo moderne.

Për realizimin mësimi aktivë nevojitet përdorimi i metodologjive efikase dhe organizimi i mirë i procesit të mësimi të muzikës që është kusht për rritjen e cilësisë në procesin e të nxëniti të muzikës si përzgjedhja e incizimeve muzikore, kombinimi metodave të mësimdhënies, organizimi i punës në grup, përgatitja e pyetjeve si duhet, etj. Në programin e lëndës së muzikës përmbajtjet janë paraqitur në bazë të katër tërësive tematike:

Krijimtaria artistike dhe performanca

Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor

Muzika dhe shoqëria

Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik

Për një muaj sa janë 4 orë mësimi të Artit muzikor, mësimdhënësi mundet që për këto katër orë të caktoj për secilën tërësi tematike nga një njësi mësimore.

- **Krijimtaria dhe performanca artistike**- kjo tërësi tematike përmban të gjitha këngët që do të mësohen gjatë vitit dhe interpretimi në instrument, duke planifikuar nga një orë në muaj për një këngë të re ose melodi të interpretuara (përfshirë edhe improvizimet dhe krijime origjinale) në instrumente muzikore, andaj në parim 10 orë në vit rezervohen për punë praktike si këndim dhe lojë në instrumente muzikore. Nxënësit që kanë të zhvilluar aftësitë e shkrim leximit muzikor mund të realizojnë këtë veprimtari me partitura muzikore, tekst notal kurse të tjerët mund të angazhohen edhe përmes metodës së imitimit(apo me vesh).
- **Gjuha dhe komunikimi artistik** – kjo tërësi tematike përmban elementet dhe parimet muzikore (tingujt, ritmi, melodia, harmonia, masat) me të cilat nxënësit mësojnë ti njohin, ti kuptojnë dhe t'i zbatojnë ato për qëllim të komunikimit artistik. Meqë në këtë klasë ato do të trajtohen nga aspekti historik, mësimdhënësit inkurajohen që të trajtojnë evoluimin kronologjik të elementeve të gjuhës muzikore dhe të shkrim-leximit muzikor në periudha të ndryshme muzikore duke i ofruar ato me pamje vizuele përmes prezantimit me PPT, atlase të ndryshme materiale ose videodokumentare e të tjerë. Mësimdhënësit inkurajohen që për çdo periudhë historike gjatë trajtimit të zhvillimit historik të këtyre elementeve të gjuhës muzikore të identifikojnë edhe kontributin e krijuesve apo muziktarëve në kontekstin kombëtar, krahas atyre ndërkombëtare, p.sh Jan Kukuzelin, Niketë Dardanin në periudhat e mëhershme e deri te pedagogët muzikore në kohët aktuale.
- **Muzika dhe shoqëria**- në këtë tërësi tematike do të shtjellohen temat që kanë të bëjnë me kulturën muzikore dhe zhvillimin e saj në kontekstin historik e kronologjik, ku nxënësit përmes dëgjimit të vperave muzikore nga gjini, zhanre, stile të ndryshme në periudha të ndryshme historike njohin dhe përjetojnë vepra, ngjarje, e njohin institucione artistike në secilën periudhë historike që trajtohet dhe i analizojnë ato nga një perspektivë më e gjerë shoqërore. Përmes këtyre vperave e zhvillimeve muzikore, nxënësit njohin edhe disa nga krijuesit dhe interpretuesit më të shquar të periudhave stilistike muzikore të ndryshme dhe kontributin e tyre në zhvillimet artistike që kanë lënë gjurmë në shoqëri, gjithmonë në përputhje me mundësitë përjetuese dhe moshës së nxënësve. P.sh kur trajtohet Baroku si periudhë stilistike, analizohen rrethanat shoqërore politike ekonomike e historike të asaj kohe (duke u ndërlidhur këtu edhe me lëndët

tjera si Letërsia, Historia, Gjeografie etj) dhe fokusi vendoset në zhvillimet muzikore që kanë ndodhur në atë periudhë (si ka ndryshuar gjuha muzikore, instrumentet, format muzikore, institucionet dhe jeta muzikore e asaj kohe etj) duke i spikatur përfaqësuesit kryesorë të kësaj periudhe (Bach dhe Handel) që nxënësit do ti mbajnë në mend përmes veprave muzikore të tyre që i dëgjojnë në klasë me mjetet audio-vizuele të ndryshme. Mund të përdoren edhe filma dokumentarë për këta krijues të spikatur me anë të të cilit hapet rruga për të organizuar punën në grupe me nxënësit të cilët nxiten të hulumtojnë më tepër për këtë periudhë dhe për këta krijues. P.sh nje grup nxënësish analizon rrethanat e pergjithshme të periudhës, një grup tjetër analizon zhvillimet e institucioneve muzikore (shtëpitë operistike, sallat koncertale etj), një grup tjetër analizon krijuesit dhe kontributet e tyre, një tjetër analizon çfarë instrumente dhe formacione interpretuese kanë ekzistuar në atë periudhë dhe një tjetër grup përzgjedh përmes analizës veprat më përfaqësuese të kësaj periudhe. Në këtë mënyrë të gjithë nxënësit përfshihen në realizimin e temës mësimore “Baroku”, e cila mund të ketë varësisht si e planifikon mësimdhënësi 2, 3 apo 4 njësi të vecanta mësimore. Mënyra e planifikimit dhe e metodologjise së mësimdhënies dhe thellimi në epokat e ndryshme varet nga orët në dispozicion për muzikën në tipet e ndryshme të gjimnazeve. Në ato tipe ku muzika mësohet vetëm një vit ose dy, temat mund të zgjerohen dhe thellohen përmes mësimi zgjedhor. Në tipet e gjimnazeve ku muzika është e pranishme nga klasa 10-12, shkohet në mënyrë më graduale ashtu si e sheh të udhës mësimdhënësi në mënyrë që të arrihet të kalohen të gjitha periudhat historike-stilistike përfshirë edhe krijimtarinë muzikore shqiptare si temë të vecantë mësimore.

- **Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik** – në kuadër të kësaj tërësie tematike nxënësit do të dëgjojnë veprat muzikore të periudhave të ndryshme dhe do të vlerësojnë veprat e dëgjua duke përdorur terminologjinë përkatëse gjatë atij vlerësimi. Ata poashtu nxiten të vlerësojnë ngjarjet muzikore të cilat i vizitojnë në mënyrë individuale ose të organizuar dhe inkurajohen të shprehin përshtypjet e tyre të përgjithshme dhe ato muzikore.

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi në fushën kurrikulare të artit kërkon kujdes të veçantë dhe mbështetet në parimin e individualizimit, ngase çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e ndryshme të shprehjes artistike. Andaj, në vlerësim duhet të përfshihet interesimi dhe prirja e nxënësit për forma të caktuar të shprehjes, kuraja, imagjinata, shprehja origjinale dhe kreative, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi etj. Arritjet në fushën e artit janë individuale, andaj edhe duhet të vlerësohen si të tilla, duke shfrytëzuar vlerësimin për motivim dhe inkurajim të zhvillimit të aftësive të tyre krijuese.

Në art duhet të vlerësohet interesimi dhe pjesëmarrja aktive (individuale dhe në grup) në aktivitete të ndryshme artistike që organizohen në klasë, në shkollë dhe në komunitet. Grupet e ndryshme muzikore, teatrore etj., që marrin pjesë në shfaqjet e shkollës, në ekspozitat individuale dhe grupore duhet të përfshihen në vlerësimin e nxënësve më të talentuar. Për nxënësit më pak të talentuar duhet vlerësuar interesimi dhe guximi për të provuar angazhimin e tyre në një nga format e ndryshme të shprehurit artistik. Vlerësohet edhe njohja dhe zbatimi i

elementet te gjuhës artistike, njohja e fakteve për krijuesit, veprat, portfolio me punë muzikore, prezantimi me gojë ose PPT i kompozitorëve të ndryshëm etj.

P.sh me rastin e dëgjimit dhe vlerësimit të veprave muzikore mësimdhënësi mundet që nxënësit t'i vlerësojë në në katër aspekte p.sh. :

Kompozitori (Moxart, Bach, Bethoven, Gluk) shkruhen kompozitorë të epokave të ndryshme

Forma muzikore (suitë, sonatë, koncert, opera, oratorio)

Instrumentet (çembal, flaut, obo, orkestër me harqe, orkestër simfonike)

Stilet (barok, klasicizëm, romantizëm, impresionizëm)

Pyetjet (muzikore) me mjete audiovizuale jepen në fletat përkatëse të vlersimit duke ju kërkuar që të rrethojnë apo shënojnë emërtimin e pjesës së dëgjuar për grupin e caktuar, kompozitorin e veprës, formacionin i cili e performon, zhanrit apo stilit të cilit i takon vepra, etj.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Artet kanë mjetet e tyre shprehëse, teknikat dhe procedurat specifike që kushtëzojnë përdorimin e materialeve të ndryshme për realizimin e përmbajtjeve nga kjo fushë kurrikulare. P.sh. Në artin muzikor material kryesor është vetë tingulli muzikor që prodhohet nga zëri i njeriut ose nga instrumentet muzikore. Burimet mësimore në artin muzikor përfshijnë edhe tekstin shkollor, instrumentet muzikore dhe burimet tingëllore (cd përkatëse, cd muzikore, dvd, incizime nga interneti, programet televizive, videoprezantimet muzikore, koncertet publike etj.) andaj për të realizuar këto burime, shkolla duhet të sigurojë kushtet e duhura (lap-top, projektorë, lidhje interneti, vizitat në galeri, muze, klasa dhe kabineti i muzikës etj) në mënyrë që mësimdhënësit nga kjo fushë të përdorin sa më shumë burime për konkretizimin e mësimin. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësin të gjejë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës. Për klasën e 10 përpos teksteve mësimore në gjuhën shqipe (si ndihmesë) mund të përdoren video incizimet e veprave të ndryshme muzikore duke u performuar në kanalën youtube, videodokumentaret për krijuesit e ndryshëm, fotoset e krijuesve, materiale online që ofrohen për periudha, krijues, instrumente muzikore, institucionet muzikore etj.

Disa më të përshtatshme për këtë nivel janë:

<https://www.pinterest.com/kimmd123/music-class-resources/>

<http://musiced.about.com/od/historyofmusic/>

<https://www.youtube.com/watch?v=rgRmnmyNKaU> (dokumentar për muzikën antike romake)

<https://www.youtube.com/watch?v=a1z0zaGDzIQ&list=PLBDmEXWn6beQx70ahADc9AuWWYovccYEI>

(dokumentar për muzikën antike deri në mesjetë)

<https://www.youtube.com/watch?v=I0Y6NPahlDE> (dokumentar për muzikën në pergjithësi në aspektin historik)

<http://musiced.about.com/od/classicaltraditions/a/Music-Forms-Of-The-Classical-Period.htm>

<http://www.baroquemusic.org/>

<http://baroque-music.com/>

<https://www.youtube.com/watch?v=MkKd1fjgqKI> (Dokumentar për Bach-un)

<https://www.youtube.com/watch?v=byCGtCTwLwQ> (Dokumentar për Beethovenin)

<http://www.classical.net/music/composer/>

<http://www.classicfm.com/discover/periods/romantic/romantic-music-beginners-guide/>

<https://www.youtube.com/watch?v=28Jc8qVYU-0> (Beethoven)

FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Matematikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Matematikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Matematika si lëndë mësimore luan një rol të rëndësishëm në studimin e fenomeneve natyrore dhe atyre teknike, ndërsa të mësuarit e saj është vlerë e domosdoshme për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur dhe në mënyrë të vazhdueshme. Matematika e klasës së dhjetë siguron elementet bazike për zotërimin e shprehive dhe shkathtësive matematikore, dhe i përgatitë nxënësit në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e jetës.

Një nga aspektet më të rëndësishme të matematikës është integrimi i saj me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare, me qëllim zotërimin e kompetencave kryesore. Me anë të matematikës nxënësi mund të interpretojë sasi të duke përdorur numrat dhe algjebren, të interpretojë format, hapësirën dhe njësitë matëse duke përdorur gjeometrinë dhe matjet, dhe të interpretojë fenomene të rastit duke përdorur statistikën e probabilitetin.

Programi i matematikës së klasës së dhjetë u shërben:

- Nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë i suksesshëm;
- Mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore, si dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj;
- Prindërve për njohjen e rezultateve të të nxënës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore për fëmijun e tyre;
- Hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësit dhe nxënës.
- Rezultatet e të nxënës të lëndës për tema mësimore, përmbajtja e të cilave krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- Udhëzimeve metodologjike të mësimdhënies për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes;
- Udhëzimeve për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare mbi kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
- Udhëzimeve për vlerësimin e arritjes së nxënësit të klasës së dhjetë;
- Udhëzimeve për materiale didaktike, burime dhe mjete mësimore.

Qëllimi

Të mësuarit e matematikës në klasën e dhjetë ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo nxënësi, ushtrimin e rregullave, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për të siguruar një bazë solide për vazhdimin e shkollimit të lartë. Programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik me idetë bazë për strukturat matematikore dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe për zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme. Po ashtu programi i matematikës së klasës së dhjetë, gjatë zbatimit:

- Përzgjedhë dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve;
- Bën vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;
- Shpalosë të menduarit e tij matematik përmes simboleve dhe gjuhës matematike;
- Paraqet koncepte të matematikës, i ndërlihdë ato dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i programit të lëndës së matematikës në klasën dhjetë është promovimi i zhvillimit të përgjithshëm dhe konsolidimii cili promovohet përmes:

- Të nxënit të integruar në kontekstin e jetës së përditshme;
- Përvetësimin të koncepteve elementare dhe koncepteve të ndërtuara.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përvetësimi i përmbajtjes programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante, që atij i parashtrahet në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive për arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara për klasë.

Përmes lëndës së matematikës, për klasën e dhjetë, synohet të zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- Numrat, algjebra dhe funksioni;
- Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- Përpunimi i të dhënave dhe probabiliteti;

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema, për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënit të cilat bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë, që prezantojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me ato tema. Programi lëndor i matematikës për nxënësit e klasës së dhjetë është i theksuar në drejtim të rezultateve të përgjithshme të të nxënit për lëndë dhe rezultateve specifike të të nxënit për tema dhe njësi tematike.

Rezultatet e të nxënit për: Gjimazin e shkencave shoqërore – gjuhësore

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL-të)
Numri, algoritmet dhe algjebra		<p>RNF : Demonstron të kuptuarit e koncepteve kryesore dhe parimeve për matematikën logjike, numrin, sistemin numerik, fuqizimin, rrënjëzimin, polinomet dhe kombinatorikën duke përdorur të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, arsyetimin dhe komunikimin, lidhjen, përfaqësime dhe përdorimin e teknologjisë për marrjen e vendimeve nga jeta reale.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillon arsyetimin algjebrik për zgjerimin e konceptit për numrat real dhe kompleks - forma algjebrike. 2. Arsyeton dhe reflekton në zgjidhjen e problemeve të matematikës dhe problemeve nga jeta reale duke përdorur matematikën logjike. 3. Interpretton rregullat algjebrike dhe përdorë kuptimin për funksionin për të modeluar e paraqitur marrëdhënie funksionale në disa mënyra. 4. Demonstron shkathtësi për veprimet me numra, zbaton parimet dhe procedurat e veprimeve me ta në situata numerike dhe algjebrike. 5. Demonstron kuptimin e fuqive me eksponent numër i plotë, numër racional dhe i zbaton në situata konkrete. 6. Paraqet kuptimin e polinomit si shprehje algjebrike, përdorë simbolet për të modeluar forma të ndryshme dhe kryen veprimet me to. 7. Shndërron formulat kryesore algebrike, kryen shndërrime të shprehjeve duke përdorur formulat themelore algjebrike dhe përdorë burime të ndryshme informacioni në funksion të zgjidhjes së shtatëve probleme. 8. Përdorë terminologjinë matematikore dhe komunikon të menduarit për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta duke lidhur konceptet (fuqi, rrënjë, polinom) në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme. 9. Zhvillon arsyetimin logjik për konceptet e kombinatorikës - permutacioni, variacioni dhe kombinacioni (pa përsëritje) të klasave të dhëna për bashkësinë me n-elemente. 10. Përzgjedhë strategji të përshtatshme dhe përdorë formulat e kombinatorikës për zgjidhjen e problemave nga matematika dhe nga jeta reale. 11. Zbaton kombinatorikën në arsimim të qëndrueshëm dhe në fusha të tjera kurrikulare dhe ndërkurrikulare. 12. Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe grafik për funksionet kuadratike përmes

	<p>studimit të marrëdhënieve të dy ndryshoreve.</p> <p>13. Zbaton procedura algjebrike në transformimet e shprehjeve dhe zgjidhjen e ekuacioneve e inekuacioneve kuadratike.</p> <p>14. Analizon format e funksionit kuadratik dhe përcakton: domenin, kulmin, drejtimin e hapjes, zerot, pozitën dhe boshtet e simetrisë x, y.</p> <p>15. Zgjidhë në formë algjebrike dhe grafike probleme që përfshijnë sistemet e ekuacioneve lineare dhe kuadratike me dy ndryshore.</p> <p>16. Zgjidhë probleme që përfshijnë inekuacionet lineare dhe kuadratike me dy ndryshore.</p> <p>17. Paraqet grafikun dhe analizon funksionet inverze (për funksione lineare dhe funksione kuadratike).</p>
<p>Matematika logjike Bashkësia</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon gjykimet dhe kryen veprimet me gjykime; • Cakton saktësinë e formulave logjike; • Përdor veprimet logjike në zgjidhje të problemeve në situata reale; • Zbaton simbolet logjike për arsyetime matematike; • Interpretin kuptimet themelore me bashkësi; • Kryen veprimet me bashkësi ; • Përkufizon bashkësinë e fundme dhe të pafundme; • Përkufizon bashkësinë partitive me shembuj konkret; • Zbaton bashkësitë në situata të problemeve nga jeta reale; • Interpretin mardhenien ndërmjet bashkësive; • Përkufizon konceptin e relacionit; • Identifikon relacionin e ekuivalencës dhe të renditjes; • Përkufizon kompozimin e relacioneve; • Përkufizon konceptin e pasqyrit dhe të disa llojeve të pasqyrimeve; • Përkufizon kompozimin e pasqyrimeve; • Përkufizon pasqyrimin invers dhe zbaton në situata konkrete; • Zbaton pasqyrimet në matematikë dhe situata nga jeta reale; • Përdor teknologjinë për zgjidhjen e problemeve nga logjika matematike.

	<p>Fuqizimi dhe rrënjëzimi</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton elementet e fuqisë me eksponent numër të plotë dhe numër racional; • Paraqet rrënjën si fuqi me eksponent numër racional; • Përdorë strategji për të kryer veprimet me fuqi dhe rrënjë; • Shndërron fuqitë nga fuqia me eksponent negativ në fuqi me eksponent pozitiv dhe anasjelltas; • Racionalizon thyesat me emërues me shprehje që përmbajnë rrënjë; • Zbaton vetitë e fuqizimit dhe rrënjëzimit në zgjidhjen e problemeve; • Zgjidhë probleme duke përdorur fuqizimin dhe rrënjëzimin ;
	<p>Polinomet</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Paraqet shprehjet shkronjore përmes pllakëzave algjebrike në forma gjeometrike; • Kryen veprime themelore të shprehjeve shkronjore; • Dizajnon shprehjet shkronjore përmes pllakëzave algjebrike; • Krijon modele me pllakëza algjebrike; • Paraqet katrorin e binomit; • Përkufizon polinomin si shprehje e plotë racionale; • Dallon shkallën e polinomit; • Kryen veprime me polinome (redukton, mbledh, zbrit, shumëzon dhe pjesëton), duke i përdorur edhe pllakëzat algjebrike; • Përdorë gjatë pjestimit të polinomeve Metoden e Hornerit dhe pjestimin me mbetje <ul style="list-style-type: none"> - Kryen pjestimin me $x - c$ • Zbërthen polinomet në faktorë përmes grupimeve (Kuatrori i Binomit) <ul style="list-style-type: none"> - Faktorizon shprehjen $x^2 + bx + c$ • Njehson PMP dhe ShVP të polinomeve; • Kryen veprimet me shprehje racionale; • Përdorë teknologjinë për zgjidhjen e problemeve me polinome.

	<p style="text-align: center;">Sistemet numerike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryen veprimet me numra natyral; • Përcakton pjestueshmërinë e numrave natyral (2, 3, ...,11); • Zbaton pjestueshmërinë (zbërthimin në faktorë, PMP , ShVP); • Kryen veprimet me numraplotë; • Kryen veprimet me numraracionalë; • Kryen veprimet me numra realë; • Përkufizon njësinë imagjinare si zgjidhje të ekuacionit $x^2 + 1 = 0$ dhe kryen fuqizimin e numrit i; • Dallon pjesën reale dhe imagjinare të numrit kompleks në trajtë algjebrike; • Paraqet numrin kompleks si dyshe e renditur numrash realë; • Përcakton dhe llogaritë modulën e numrit kompleks; • Identifikon numrin e konjuguar të numrit kompleks; • Kryen veprime me numra kompleks (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim); • Paraqet pozitën e numrit kompleks në rrafshin koordinativ kënddrejtë; • Zbaton barazinë e numrave kompleks në zgjidhjen e ekuacioneve; • Përdor gjuhën matematike dhe teknologjinë për të zgjidhur probleme me numra.
	<p style="text-align: center;">Kombinatorika</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon kuptimin e faktorielit (n!); • Klasifikon bashkësitë apo nënbashkësitë si permutacione, variacione apo kombinacione; • Njehson permutacione, variacione dhe kombinacione pa përsëritje; • Zgjidh probleme të ndryshme nga përditshmëria me ndihmën e kombinatorikës; • Përdor formulën e binomit për ngritje në fuqi të binomeve; • Shfrytëzon trekëndëshin e Paskalit për caktimin e koeficientëve të formulës së binomit; • Përdor gjuhën matematike dhe teknologjinë për të

		zgjidhur probleme nga kombinatorika.
Modelet, Algjebra dhe funksioni	Ekuacionet dhe funksionet kuadratike	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon formën standarde të ekuacionit kuadratike; • Përdorë strategji për të zgjidhur ekuacionet e mangëta kuadratike; • Përdorë strategji për të zgjidhur ekuacionin kuadratik me anë të formulës; • Analizon zgjidhjet e ekuacionit kuadratik në varshmëri nga diskriminanta; • Zbaton rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike; • Zbaton strategji për të zbërthye në faktorë të thjesht ekuacionet kuadratike; • Zbaton ekuacionet kuadratike në zgjidhjen e problemeve praktike dhe nga jeta reale; • Zbërthen trinomin kuadratik në prodhim; • Përshkruan hapat për të zgjidhur ekuacionet kuadratike me njëvlerë absolute; • Identifikon ekuacionin iracional dhe përdorë strategji për zgjidhje; • Përkufizon domenën e funksionit kuadratik; • Përshkruan formën kanonike të funksionit kuadratik; • Paraqet grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku i dhënë cakton monotoninë, zerot dhe vlerat ekstreme; • Përcakton formën e funksionit kuadratik në varësi të koeficientit edhe dallorit; • Zgjidh sistemet e ekuacioneve kuadratike në formë analitike dhe grafike; • Zbaton sistemet e ekuacioneve kuadratike në zgjidhje të problemeve; • Zgjidh inekuacionin kuadratik;

		<ul style="list-style-type: none"> • Lidhë kuptimin e shenjës së funksionit me bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacionit kuadratik; • Paraqet në formë grafike zgjidhjet e inekuacioneve kuadratike; • Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për zgjidhje të problemeve që ka të bëjë me ekuacione dhe inekuacione kuadratike.
Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria	RNF: Demonstron të kuptuarit e formës dhe hapësirës duke përdorur të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, arsyetimin dhe komunikimin, lidhjen, përfaqësime dhe përdorimin e teknologjisë.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillon kuptimin për forma 2-D me anë të matjes së drejtpërdrejtë apo në një formë tjetër për njehsimin e perimetrit dhe syprinës së tyre. 2. Demonstron kuptimin e sistemit të matjeve, përshkruan marrëdhëniet e njësive për gjatësi, syprinë, vëllim, masë, krahason njësitë dhe zbaton strategji për t'i kthyer ato në njësi standarde. 3. Dallon, përshkruan dhe klasifikon figurat dhe trupat gjeometrik bazuar në vetitë e tyre. 4. Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë të figurave gjeometrike për matjen e perimetrit dhe syprinës së sipërfaqes së figurave me forma 2-D duke përdorur teknologjinë; 5. Ndërtojnë shëmbëllimin sipas një transformimi gjeometrik dhe shpjegojnë e përdorin zbatime praktike të transformimeve gjeometrike.
Matja	Syprina e sipërfaqeve të figurave të rrafshta	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton vendndodhjen e pikës me anë të koordinatave; • Përkufizon konceptin e syprinës së sipërfaqes së figurave të rrafshta(2D); • Përcakton zonën e shumëkëndëshave; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së trekëndshit; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së katërkëndëshave; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së figurave të rregullta duke përfshirë sipërfaqen rrethore dhe pjesët e rrethit; • Përdorë teknologjinë për të zgjidhur probleme në situata reale dhe nga jeta.
	RNF : Demonstron të kuptuarit e koncepteve kryesore dhe parimeve	

<p>Të dhënat dhe probabiliteti</p>	<p>për elementet bazë të statistikës duke përdor të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, arsyetimin dhe komunikimin, lidhjen, përfaqësime dhe përdorimin e teknologjisë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kupton rolin dhe interpretimin e të dhënave statistikore; 2. Demonstron njohuri për grumbullimin dhe interpretimin e të dhënave statistikore. 3. Formon tabelat e shpërndarjes së frekuencave për të dhënat cilësore dhe sasiore. 4. Konstruktore lloje të ndryshme të tabelave dhe diagrameve; 5. Interpretore treguesit e variacionit; 6. Përdorë teknologjinë për të komunikuar dhe prezentuar të dhënat e grumbulluara. 	
	<p>Statistika</p>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon konceptet kryesore në analizën statistikore <ul style="list-style-type: none"> - popullimi – dukuria masive, - mostra - zgjedhja, - njësia statistikore – eksperimentale, - variabla - tipari statistikor; • Identifikon instrumentet për grumbullimin e të dhënave (vrojtimi, evidenca, eksperimenti, pyetësori, ...) • Prezanton të dhënët përmes (bar graf, vijor, histogram, rrethor, tabelor, pikor, diagram); • Përkufizon popullacionin, karakteristikat dhe vargun statistikor; • Cakton numrin e klasave, gjerësinë e intervaleve dhe kufirin e grupit të intervaleve • Vendos të dhënat në çdo grup; • Numron njësitet për çdo klasë; • Bën shpërndarjen e frekuencave relative dhe fekuencave në përqindje; • Vizaton poligonin e frekuencave; • Shpërndanë frekuencat komulative;

		<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet grafiket e frekuencave komulative; • Përgatitë planin e vrojtimit; • Përkufizon masat e tendencës qendrore (mesataren aritmetike, gjeometrike , medianen dhe modën); • Njehson mesatarën aritmetike, medianën dhe modën për të dhëna të grupuara dhe pa grupuara; • Gjenë lidhjen në mës të madhësive mesatare;
--	--	---

Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën e dhjetë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë III e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënësve. Temat që paraqiten në programin e klasës së dhjetë zhvillohen përmes rezultateve të hartuara për temë dhe të lidhura me fusha të tjera kurrikulare të ilustruara në kontekste nga jeta. Rezultatet e të nxënësve për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që ndihmojnë përvetësimin e temave të tjera brenda dhe jashtë fushës.

Mësimdhënësi duhet të përqendrohet në këto aspekte:

- Lidhjen e rezultateve të të nxënësve të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënësve për kompetencat e fushës dhe rezultateve të temave;
- Mësimdhënien dhe të nxënësve ta bazon në kompetenca;
- Mësimdhënien me nxënësinnë qendër;
- Mësimdhënien dhe të nxënësve e integruar;
- Zhvillimin e temave ndërkurrikulare;
- Zhvillimin i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi: përcaktimin e temës për të zhvilluar përmes metodave, teknikave dhe strategjive, të cilat bazohen në ndërveprim; mundësimin në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen e përhershëm të nxënësve; informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre.

Nxënësit duhet të ushtrohen për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, sepse kjo u jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e së panjohurës, të respektojnë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punës ekipore. Përmes qasjes së të nxënësve me kompetenca, mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre, duke marrë parasysh dallimet ndërmjet nxënësve në klasë. Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e rezultateve të të nxënësve për kompetenca nga

ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngushtë me shumë komponentë të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit, etj., nxënësi duhet të zgjidhë probleme të natyrave të ndryshme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elementet e gjuhës matematikore. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësit e klasës së dhjetë mësojnë të realizojnë zgjidhjen e një problemi apo situatë problemore dhe të bëhen të aftë të kontribuojnë në rritjen e tyre personale, duke ndihmuar që ata të gjejnë vendin e tyre në shoqëri. Kështu, ata mësojnë të marrin pjesë në jetën shoqërore, në klasë dhe në shkollë, zhvillojnë një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësit përdorin aparatit matematik, në mënyrë që të arsyetojnë dhe argumentojnë vendimet e marra, të zhvillojnë marrëdhënie aktive në mjedisin e tyre, duke ushtruar një qëndrim kritik ndaj arsimimit të qëndrueshëm dhe çështjeve ndërkurrikulare.

Programi dhe interpretimi i tij në vete përmban një lidhje të matematikës me fushat e tjera përmes shembujve dhe problemeve, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si tërësi për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi si proces është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve, andaj përmes vlerësimit konstatohet shkalla e arritshmerisë së të nxënësve, vlerëshmëria e programit dhe metodologjia e mësimdhënies. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimit të aftësive matematikore, nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit, mësimdhënësi duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënësve për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e shkallës. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së dhjetë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm, vëzhgimit në klasë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike, ndërsa raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive të vendosura në librin e mësimdhënësit dhe vendosjen e notave numerike (1-5) në librin e klasës.

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me dokumentet zyrtare për vlerësim. Llojet e vlerësimit duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe rezultatet e të nxënësve të lëndës, strategjive të të nxënësve, moshës dhe kërkesave të nxënësve. Për lëndën e matematikës, vlerësimi bazohet në: vlerësim të përgjigjeve me gojë; punën në grup; aktivitetin gjatë debateve në klasë; kryerjen e detyrave të shtëpisë; rezultateve të testit për një grup temash të caktuara; rezultateve të testit në fund të vitit mësimor, etj.

Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore

Gjatë mësimin të matematikës, mësuesi jep informacione dhe shfaqë shkathtësi, duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësve jep informacione, formon shprehje, zhvillon shkathtësi dhe zotëron cilësi për fushën duke u qasur në të mësuarit përmes formave të ndryshme.

Për realizimin e kompetencave të arsimit të mesëm të lartë nga fusha e matematikës për klasën e dhjetë, mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën, nivelin dhe thellësinë e të mësuarit. Mësuesi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, krijon modele matematike, jep ndihma të veçanta, përshtatë shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedise dhe hapësira për aktivitete alternative. Ai, poashtu ofron mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e nxënësve në mësimin e matematikës. Mësuesi, duhet t'u mundësojë nxënësve zhvillimin e shkathtësive që të demonstrojnë apo prezantojnë projektet e ndryshme, dhe të formojnë qëndrime ndaj të mësuarit të matematikës.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Matematika si lëndë mësimore luan një rol të rëndësishëm në studimin e fenomeneve natyrore dhe atyre teknike, ndërsa të mësuarit e saj është vlerë e domosdoshme për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur dhe në mënyrë të vazhdueshme. Matematika e klasës së dhjetë siguron elementet bazike për zotërimin e shprehive dhe shkathtësive matematikore, dhe i përgatitë nxënësit në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e jetës.

Një nga aspektet më të rëndësishme të matematikës është integrimi i saj me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare, me qëllim zotërimin e kompetencave kryesore. Me anë të matematikës nxënësi mund të interpretojë sasi të duke përdorur numrat dhe algjebren, të interpretojë format, hapësirën dhe njësitë matëse duke përdorur gjeometrinë dhe matjet, dhe të interpretojë fenomene të rastit duke përdorur statistikën e probabilitetin.

Programi i matematikës së klasës së dhjetë u shërben:

- Nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë i suksesshëm;
- Mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore, si dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj;
- Prindërve për njohjen e rezultateve të të nxënës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore për fëmijun e tyre;
- Hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësin dhe nxënësin.
- Rezultatet e të nxënës të lëndës për tema mësimore, përmbajtja e të cilave krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- Udhëzimeve metodologjike të mësimdhënies për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes;
- Udhëzimeve për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare mbi kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
- Udhëzimeve për vlerësimin e arritjes së nxënës të klasës së dhjetë;
- Udhëzimeve për materiale didaktike, burime dhe mjete mësimore.

Qëllimi

Të mësuarit e matematikës në klasën e dhjetë ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo nxënësi, ushtrimin e rregullave, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për të siguruar një bazë solide për vazhdimin e shkollimit të lartë. Programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik me idetë bazë për strukturat matematikore dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe për zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme. Po ashtu programi i matematikës së klasës së dhjetë, gjatë zbatimit:

- Përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
- Bën vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;
- Shpalosë të menduarit e tij matematik përmes simboleve dhe gjuhës matematike;
- Paraqet koncepte të matematikës, i ndërlihd ato dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i programit të lëndës së matematikës në klasën dhjetë është promovimi i *zhvillimit të përgjithshëm dhe konsolidimit* cili promovohet përmes:

- Të nxënit të integruar në kontekstin e jetës së përditshme;
- Përvetësimin të koncepteve elementare dhe koncepteve të ndërtuara.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përvetësimi i përmbajtjes programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante, që atij i parashtrahet në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive për arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara për klasë.

Përmes lëndës së matematikës, për klasën e dhjetë, synohet të zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- Numrat, algjebra dhe funksioni;
- Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- Përpunimi i të dhënave dhe probabiliteti;

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema, për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënit të cilat bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë, që prezantojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me ato tema. Programi lëndor i matematikës për nxënësit e klasës së dhjetë është i theksuar në drejtim të rezultateve të përgjithshme të të nxënit për lëndë dhe rezultateve specifike të të nxënit për tema dhe njësi tematike.

Rezultatet e të nxënit për: Gjimazin e shkencave natyrore

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLN-të)
<p style="text-align: center;">Numri, algoritmet dhe algjebra</p>		<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillon arsyetimin algjebrik për zgjerimin e konceptit për numrat real dhe kompleks. 2. Modelon marrëdhënie dhe situata matematike përmes simboleve algjebrike. 3. Arsyeton dhe reflekton në zgjidhjen e problemeve të matematikës dhe problemeve nga jeta reale duke përdor matematikën logjike. 4. Manifeston kuptimin e numrave në formë aksiomatike dhe zbaton ata në zgjidhje të problemeve. 5. Interpretton rregullat algjebrike dhe përdorë kuptimin për funksionin për të modeluar e paraqitur marrëdhënie funksionale në disa mënyra. 6. Demonstron shkathtësi për veprimet me numra, zbaton parimet dhe procedurat e veprimeve me ta në situata numerike dhe algjebrike. 7. Demonstron kuptimin e fuqive me eksponent numër i plotë, numër racional dhe i zbaton në situata konkrete. 8. Paraqet kuptimin e polinomit si shprehje algjebrike, përdorë simbolet për të modeluar forma të ndryshme dhe kryen veprimet me to. 9. Shndërron formulat kryesore algebrike, kryen shndërrime të shprehjeve duke përdorur formulat themelore algjebrike dhe përdor burime të ndryshme informacioni në funksion të zgjidhjes së situatave problemore. 10. Përdorë terminologjinë matematikore dhe komunikon të menduarit për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta duke lidhur konceptet (fuqi, rrënjë, polinom) në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme. 11. Zhvillon arsyetimin logjik për konceptet e kombinatorikës - permutacioni, variacioni dhe kombinacioni (pa përsëritje) të klasave të dhëna për bashkësinë me n-elemente. 12. Përzgjedh strategji të përshtatshme dhe përdor formulat e kombinatorikës për zgjidhjen e problemave nga matematika dhe nga jeta reale. 13. Zbaton kombinatorikën në arsimim të qëndrueshëm dhe në fusha të tjera kurrikulare dhe ndërkurrikulare. 14. Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe grafik për funksionet kuadratike përmes studimit të marrëdhënieve të dy ndryshoreve. 15. Zbaton procedurë algjebrike në transformimet e shprehjeve dhe

	<p>zgjdhjen e ekuacioneve e inekuacioneve kuadratike.</p> <p>16. Analizon format e funksionit kuadratik dhe përcakton: domenin, kulmin, drejtimin e hapjes, zerot, pozitën dhe boshtet e simetrisë x, y.</p> <p>17. Zgjdh në formë algjebrike dhe grafike probleme që përfshijnë sistemet e ekuacioneve lineare dhe kuadratike me dy ndryshore.</p> <p>18. Zgjdh probleme që përfshijnë inekuacionet lineare dhe kuadratike me dy ndryshore.</p> <p>19. Paraqet grafikun dhe analizon funksionet inverze (për funksione lineare dhe funksione kuadratike).</p>
<p>Matematika logjike Bashkësia</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon gjykimet dhe kryen veprimet me gjykime; • Cakton saktësinë e formulave logjike; • Zbaton formulat logjike (Ligjet e algjebres së gjykimeve) në vërtetime matematike dhe situata reale; • Përdorë veprimet logjike në zgjidhje të problemeve në situata reale; • Zbaton simbolet logjike për arsyetime matematike; • Interpretion kuptimet themelore me bashkësi; • Kryen veprimet me bashkësi ; • Përkufizon bashkësinë e fundme dhe të pafundme; • Përkufizon bashkësinë partitive me shembuj konkret; • Zbaton ligjet e algjebres së bashkësive; • Zbaton bashkësitë në situata të problemeve nga jeta reale; • Interpretion mardhenien ndërmjet bashkësive; • Përkufizon konceptin e relacionit; • Dallon relacionin e ekuivalencës dhe të renditjes; • Zbaton relacionet në matematikë dhe situata nga jeta reale; • Përkufizon konceptin e pasqyrimin; • Përkufizon disa llojet të pasqyrimeve; • Përkufizon kompozimin e pasqyrimeve; • Përkufizon pasqyrimin invers dhe zbaton në situatë konkrete; • Zbaton pasqyrimet në matematikë dhe situata nga jeta reale; • Përdor teknologjinë për zgjidhjen e problemeve nga matematika matematike.

	<p>Fuqizimi dhe rrënjëzimi</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton elementet e fuqisë me eksponent numër të plotë dhe numër racional; • Paraqet rrënjën si fuqi me eksponent numër racional; • Përdorë strategji për të kryer veprimet me fuqi dhe rrënjë; • Shndërron fuqitë nga fuqia me eksponent negativ në fuqi me eksponent pozitiv dhe anasjelltas; • Racionalizon thyesat me emërues me shprehje që përmbajnë rrënjë; • Zbaton vetitë e fuqizimit dhe rrënjëzimit në zgjidhjen e problemeve; • Zgjidhë probleme duke përdorur fuqizimin dhe rrënjëzimin ;
	<p>Polinomet</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Paraqet shprehjet shkronjore përmes pllakëzave algjebrike në forma gjeometrike; • Kryen veprime themelore të shprehjeve shkronjore; • Dizajnon shprehjet shkronjore përmes pllakëzave algjebrike; • Krijon modele me pllakëza algjebrike; • Paraqet katrorin e binomit; • Krijon modele dhe zgjidhë probleme përmes shprehjeve algjebrike; • Përkufizon polinomin si shprehje e plotë racionale; • Dallon shkallën e polinomit; • Kryen veprime me polinome (reduktion, mbledhë, zbrit, shumëzon dhe pjesëton), duke i përdorur edhe pllakëzat algjebrike; • Përdorë gjatë pjestimit të polinomeve Metoden e Hornerit dhe pjestimin me mbetje <ul style="list-style-type: none"> - Kryen pjestimin me $x - c$ - Kryen pjestimin me $ax + b$; • Zbërthen polinomet në faktorë përmes grupimeve (Kuatrori i Binomit) <ul style="list-style-type: none"> - Faktorizon shprehjen $x^2 + bx + c$ - Faktorizon shprehjen $ax^2 + bx + c$; $a \neq 1$ • Njeson PMP dhe ShVP të polinomeve;

		<ul style="list-style-type: none"> • Kryen veprimet me shprehje racionale; • Përdorë teknologjinë për zgjidhjen e problemeve me polinome.
	<p>Sistemet numerike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon numrat natyral në mënyrë aksiomatike dhe kryen veprimet me ta; • Përcakton pjestueshmërinë e numrave natyral (2, 3, ...,11); • Zbaton pjestueshmërinë (zbërthimin në faktor, PMP , ShVP); • Përkufizon numrat plotë në mënyra aksiomatike dhe kryen veprimet me ta; • Zbaton aritmetikën modulare; • Përkufizon numrat racionalë në mënyra aksiomatike dhe kryen veprimet me ta; • Përkufizon numrat realë në mënyra aksiomatike dhe kryen veprimet me ta; • Përkufizon njësinë imagjinare si zgjidhje të ekuacionit $x^2 + 1 = 0$ dhe kryen fuqizimin e numrit i; • Dallon pjesën reale dhe imagjinare të numrit kompleks në trajtë algjebrike; • Paraqet numrin kompleks si dyshe e renditur numrash realë; • Përcakton dhe llogarit modulën e numrit kompleks; • Identifikon numrin e konjuguar të numrit kompleks; • Lidh kuptimin e rrënjës me tregues numër çift të vlerave negative dhe numrin kompleks; • Kryen veprime me numra kompleks (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim); • Paraqet numrin kompleks në rrafshin koordinativ kënddrejtë; • Zbaton barazinë e numrave kompleks në zgjidhjen e ekuacioneve; • Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të zgjidhur probleme me numra.

	<p>Kombinato-rika</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon hapat e parimit të induksionit matematik në raste më të thjeshta; • Vërteton pohime, teorema, formula me anën e induksionit matematik; • Përkufizon kuptimin e faktorielit ($n!$); • Klasifikon bashkësitë apo nënbashkësitë si permutacione, variacione apo kombinacione; • Njehson permutacione, variacione dhe kombinacione pa përsëritje; • Zgjidhë probleme të ndryshme nga përditshmëria me ndihmën e kombinatorikës; • Përdorë formulën e binomit për ngritje në fuqi të binomeve; • Shfrytëzon trekëndëshin e Paskalit për caktimin e koeficientëve të formulës së binomit;
<p>Modelet, Algjebra dhe funksioni</p>	<p>Ekuacionet dhe funksionet kuadratike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon formën standarde të ekuacionit kuadratik; • Përdor strategji për të zgjidhur ekuacionet e mangëta kuadratike; • Përdor strategji për të zgjidhur ekuacionin kuadratik me anë të formulës; • Analizon zgjidhjet e ekuacionit kuadratik në varshmëri nga diskriminanta; • Zbaton rregullat e Viet-it për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me ekuacionet kuadratike; • Zbaton strategji për të zbërthyer në faktorë të thjeshtë ekuacionet kuadratike; • Zbaton ekuacionet kuadratike në zgjidhjen e problemeve praktike dhe nga jeta reale; • Zbërthen trinomin kuadratik në prodhim; • Përshkruan hapat për të zgjidhur ekuacionet kuadratike me vlerë absolute; • Përdorë strategji për të zgjidhur ekuacionin bikuadratik;

	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon ekuacionin iracional dhe përdorë strategji për zgjidhje; • Përkufizon domenën e funksionit kuadratik; • Përshkruan formën kanonike të funksionit kuadratik; • Paraqet grafikisht funksionin kuadratik dhe nga grafiku i dhënë cakton monotoninë, zerot dhe vlerat ekstreme; • Përcakton formën e funksionit kuadratik në varësi të koeficientit a dhe dallorit; • Zgjidhë sistemet e ekuacioneve kuadratike në formë analitike dhe grafike; • Zbaton sistemet e ekuacioneve kuadratike në zgjidhje të problemeve; • Zgjidhë inekuacionin kuadratik; • Lidhë kuptimin e shenjës së funksionit me bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacionit kuadratik; • Paraqet në formë grafike zgjidhjet e inekuacioneve kuadratike; • Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për zgjidhje të problemeve që ka të bëjë me ekuacione dhe inekuacione kuadratike.
<p>Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria</p>	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillon kuptimin për forma 2-D me anë të matjes së drejtpërdrejtë apo në një formë tjetër për njehsimin e perimetrit dhe syprinës së tyre. 2. Demonstron kuptimin e sistemit të matjeve, përshkruan marrëdhëniet e njësive për gjatësi, syprinë, vëllim, masë, krahason njësitë dhe zbaton strategji për t'i kthyer ato në njësi standarde. 3. Zbaton arsyetimin proporcional të problemeve që përfshijnë konvertimet midis SI dhe njësive tjera për matje. 4. Zbaton proceset e matjes, përzgjedhë teknika dhe formulat e duhura për njehsimin e perimetrit dhe syprinës së formave të rregullta 2-D dhe zgjidhë situata problemore të jetës së përditshme; 5. Dallon, përshkruan dhe klasifikon figurat dhe trupat gjeometrik bazuar në vetitë e tyre.

	<ol style="list-style-type: none"> 6. Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë të figurave gjeometrike për matjen e perimetrit dhe syprinës së sipërfaqes së figurave me forma 2-D duke përdorur teknologjinë; 7. Përdorë arsyetimin, vërtetimin për të zbuluar e provuar marrëdhënie gjeometrike; 8. Analizon modele dhe lojra që përfshijnë arsyetimin hapësinor, duke përdorur strategjitë e zgjidhjes së problemeve. 9. Ndërtojnë shëmbëllimin sipas një transformimi gjeometrik 10. Përdorë zbatime praktike të transformimeve gjeometrike 	
Matja	Syprina e sipërfaqeve të figurave të rrafshta	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton vendndodhjen e pikës me anë të koordinatave; • Përkufizon konceptin e syprinës së sipërfaqes së figurave të rrafshta (2D); • Përcakton zonën e shumëkëndëshave; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së trekëndshit; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së katërkëndëshave; • Përdorë formulat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes së figurave të rregullta duke përfshirë sipërfaqen rrethore dhe pjesët e rrethit; • Përdorë teknologjinë për të zgjidhur probleme në situatë reale dhe nga jeta.
Të dhënat (Statistika) dhe probabiliteti	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kupton rolin dhe interpretimin e të dhënave statistikore; 2. Demonstron njohuri për grumbullimin dhe interpretimin e të dhënave statistikore. 3. Formon tabelat e shpërndarjes së frekuencave për të dhënat cilësore dhe sasiore. 4. Konstruktin lloje të ndryshme të tabelave dhe diagrameve; 5. Interpretin treguesit e variacionit; 6. Përdor teknologjinë për të komunikuar dhe prezantuar të dhënat e grumbulluara. 	
	Statistika	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon konceptet kryesore në analizën statistikore - popullimi – dukuria masive,

		<ul style="list-style-type: none"> - mostra - zgjedhja, - njësia statistikore – eksperimentale, - variabla - tipari statistikor; • Grumbullon të dhëna statistikore, i ndan në klasë, rregullon dhe i analizon ato; • Identifikon instrumentet për grumbullimin e të dhënave (vrojtimi, evidenca, eksperimenti, pyetësi,...); • Organizon të dhënat dhe i prezanton (bar graf, vijor, histogram, rrethor, tabelor, pikor, diagram); • Përkufizon popullacionin, karakteristikat dhe vargun statistikor; • Cakton numrin e klasave ose grup intervaleve; • Cakton gjerësinë e intervaleve; • Cakton kufirin e grup intervaleve; • Vendosë të dhënat në çdo grup; • Numron njësitë për çdo klasë; • Bën shpërndarjen e frekuencave relative dhe fekuencave në përqindje; • Identifikon mesin e intervalit; • Vizaton poligonin e frekuencave; • Shpërndanë frekuencat komulative; • Përdorë diagrame të ndryshëm për shpërndarjen; • Paraqet grafikët e frekuencave komulative; • Identifikon shpërndarjen e karakteristikave • Përgatitë planin e vrojtimit; • Përkufizon matësit e tendences qendrore mesataren aritmetike, gjeometrike dhe harmonike, medianen dhe modën (vlerat pozicionale); • Njehson mesataren aritmetike për të dhënat e pa grupuara dhe të grupuara;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Njehson medianën (vlerën mesatare); • Njehson modën (vlerën dominuese); • Gjenë lidhjen në mes të madhësive mesatare; • Njehson mesataren gjeometrike; • Zbaton metodat dhe ecuritë e hulumtimeve statistikore; • Paraqet grafikisht të dhënat duke shfytëzuar teknologjinë. • Përkufizon shpërndarjen apo variacionin për të dhënat e pagrupuara dhe të grupuara; • Njehson gjerësinë e variacionit; • Njehson variancën, koficientin e variacionit dhe devijimin standard të populacionit dhe mostrave për të dhënat e grupuara dhe pa grupuara; • Zbaton Teoremën e Chbyshoev-it për përdorimin dhe interpretimin e devijimit standard; • Përdor programet kompjuterike (Excel) për zgjidhjen e problemeve nga statistika dhe nga jeta reale.
--	--	--

Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën e dhjetë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë III e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënit. Temat që paraqiten në programin e klasës së dhjetë zhvillohen përmes rezultateve të hartuara për temë dhe të lidhura me fusha të tjera kurrikulare të ilustruara në kontekste nga jeta. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që ndihmojnë përvetësimin e temave të tjera brenda dhe jashtë fushës.

Mësimdhëniesi duhet të përqendrohet në këto aspekte:

- Lidhjen e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të temave;
- Mësimdhënien dhe të nxënien ta bazon në kompetenca;
- Mësimdhënien me nxënësinnë qendër;
- Mësimdhënien dhe të nxënit e integruar;
- Zhvillimin e temave ndërkurrikulare;

- Zhvillimin i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi: përcaktimin e temës për të zhvilluar përmes metodave, teknikave dhe strategjive, të cilat bazohen në ndërveprim; mundësimin në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen e përhershëm të nxënësve; informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre.

Nxënësit duhet të ushtrohen për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, sepse kjo u jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e së panjohurës, të respektojë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punës ekipore. Përmes qasjes së të nxënësve me kompetenca, mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre, duke marrë parasysh dallimet ndërmjet nxënësve në klasë. Përdorimi i *metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës* është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e rezultateve të të nxënësve për kompetenca nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngusht me shumë komponentë të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit, etj., nxënësi duhet të zgjidhë probleme të natyrave të ndryshme, duhet të përdor arsyetimin matematik dhe elementet e gjuhës matematikore. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësit e klasës së dhjetë mësojnë të realizojnë zgjidhjen e një problemi apo situatë problemore dhe të bëhen të aftë të kontribuojnë në rritjen e tyre personale, duke ndihmuar që ata të gjejnë vendin e tyre në shoqëri. Kështu, ata mësojnë të marrin pjesë në jetën shoqërore, në klasë dhe në shkollë, zhvillojnë një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësit përdorin aparatit matematik, në mënyrë që të arsyetojnë dhe argumentojnë vendimet e marra, të zhvillojnë marrëdhënie aktive në mjedisin e tyre, duke ushtruar një qëndrim kritik ndaj arsimit të qëndrueshëm dhe çështjeve ndërkurrikulare.

Programi dhe interpretimi i tij në vete përmban një *lidhje të matematikës me fushat e tjera* përmes shembujve dhe problemeve, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si tërësi për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi si proces është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënit, andaj përmes vlerësimit konstatohet shkalla e arritshmërisë së të nxënit, vlerëshmëria e programit dhe metodologjia e mësimdhënies. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimit të aftësive matematikore, nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit, mësimdhënësi duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënit për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e shkallës. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së dhjetë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm, vëzhgimit në klasë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike, ndërsa raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive të vendosura në librin e mësimdhënësit dhe vendosjen e notave numerike (1-5) në librin e klasës.

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me dokumentet zyrtare për vlerësim. Llojet e vlerësimit duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe rezultatet e të nxënit të lëndës, strategjive të të nxënit, moshës dhe kërkesave të nxënësit. Për lëndën e matematikës, vlerësimi bazohet në: vlerësim të përgjigjeve me gojë; punën në grup; aktivitetin gjatë debateve në klasë; kryerjen e detyrave të shtëpisë; rezultateve të testit për një grup temash të caktuara; rezultateve të testit në fund të periodave mësimore dhe në fund të vitit mësimorë, etj.

Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore

Gjatë mësimin të matematikës, mësimdhënësi jep informacione dhe shfaqë shkathtësi, duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi jep informacione, formon shprehje, zhvillon shkathtësi dhe zotëron cilësi për fushën duke u qasur në të mësuarit përmes formave të ndryshme.

Për realizimin e kompetencave të arsimit të mesëm të lartë nga fusha e matematikës për klasën e dhjetë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën, nivelin dhe thellësinë e të mësuarit. Mësimdhënësi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, krijon modelime matematike, jep ndihma të veçanta, përshtatë shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedise dhe hapësira për aktivitete alternative. Ai, poashtu ofron mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e nxënësit në mësimin e matematikës. Mësimdhënësi, duhet t'u mundësojë nxënësve zhvillimin e shkathtësive që të demonstrojnë apo prezantojnë projektet e ndryshme, dhe të formojnë qëndrime ndaj të mësuarit të matematikës.

Interneti dhe materialet të matematikës në internet shërbejnë si materiale ndihmëse për arritjen e rezultatetve të të nxënit.

FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT NATYRORE

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Biologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Biologji (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Fizikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Fizikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kimi (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Kimi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Biologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Hartimi i plan - programit mësimor të lëndës së biologjisë është realizuar mbi bazën e KB –së niveli III dhe i dedikohet nxënësve të klasës X të gjimnazit të shkencave shoqërore – gjuhësore dhe gjimnazit të shkencave natyrore (ndryshimi mes tyre qëndron në shtrirjen dhe thellësinë e problematikave). Hartimi i programit respekton një procedurë të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, metodave dhe instrumentave të vlerësimit.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor jemi nisur nga synimi i arritjes së kompetencave të paraplanifikuara me Kurrikulën Bërthamë, përmes rezultateve lëndore - Biologji.

Përmbajtja e programit mësimor të biologjisë, metodologjitë, qasja, shfrytëzimi i burimeve të ndryshme mësimore, fleksibiliteti dhe kreativiteti i mësimdhënësit si dhe autonomia e shkollës (hartimi i rezultateve specifike mësimore), kontribuojnë që të nxënësi të zhvillohen kompetencat e ndryshme.

Ky program është përqëndruar në vazhdimimësinë e koncepteve nga niveli i parë i arsimit parauniversitar, por duke avancuar nivelin e kompetencave përmes zhvillimit vertikal të çështjeve shkencore, të përmbledhura në Rezultate të Fushës (RNF), prej nga burojnë temat e caktuara të cilat zërthehen përmes rezultateve të të nxënit lëndor, të cilat rezultate duhet të arrihen përmes rezultateve të njësisë mësimore të cilat i parasheh mësimdhënësi në kontekst të shkollës dhe klasës (atë se çfarë dhe cilat lloje të rezultateve duhet t'i arrijë nxënësi dhe çka duhet të punojë mësimdhënësi).

Filozofia e KK-së respektohet, ku në vend të transmetimit së informatave nga mësimdhënësi tek nxënësi, roli i mësimdhënësit kalon në rol përkrahës, ndërsa tek nxënësi kultivohen shprehitë e gjenerimit të informatave të reja, kërkimin e pavarur të burimeve të informatave, punë të pavarur etj.

Si bartës i ndryshimeve në procesin mësimor, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të vrottojnë, të masin, të klasifikojnë, të formojnë modele, të shtrojnë hipoteza, të zgjidhin probleme, të aftësohen për përdorim të drejtë dhe të sigurt të veglërisë dhe instrumenteve në laboratorët biologjikë, të dizajnojnë eksperimentin, të incizojnë dhe të paraqesin të dhënat etj., poashtu mësimdhënësi merr rolin mbështetës dhe motivues gjatë trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me pubertetin dhe ndryshimet fiziologjike, psikike dhe emocionale të moshës së nxënësve.

Me fjalë tjera, mësimi i biologjisë kontribuon në përgatitjen e nxënësit që dijet dhe shkathtësitë e fituara të mund t'i zbatojë në mjedisin ku jetojnë, kështu ai transformon vetveten dhe shoqërinë.

Qëllimi

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X është vazhdimësi e programit mësimor të shkencave natyrore – biologji nga niveli II i arsimit parauniversitar, si i tillë, konsiston në konsolidimin e kompetencave paraprake (në thellimin e diturive të nxëna dhe në zhvillimin e shkathtësive, vlerave dhe të qëndrimeve etj). Andaj, mbi këtë bazë, programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X i siguron nxënësit synimin e zhvillimit të mëtejshëm për:

- Thellim të njohurive mbi nocionet dhe ligjet biologjike.
- Aftësi dhe shprehje komunikimi duke përdorur gjuhë shkencore për interpretim të ideve, fenomeneve dhe të proceseve jetësore.
- Shprehje për punë në grupe dhe në ekipe punuese, ndjenjës së shoqërizimit dhe të vetive të tjera pozitive të personalitetit të domosdoshme për bashkëpunim konstruktiv në zgjidhjen e detyrave të parashtruara.
- Shkathtësi hulumtuese (përmes mësimit eksperimental, vrojtues, matës dhe analizues të zhvillojnë aftësitë krijuese, të menduarit analitik, vlerësimin objektiv ndaj vetvetes dhe grupit gjatë punës ekipore).
- Aftësiqë me punën e tyre kreative të zbulojnë mënyrën përdorimit të arritjeve teknologjike me punën shkencore.
- Qëndrime për faktet shkencore në aspekt të çështjes industriale, etike dhe ambientore
- Qëndrime për sjelljet emocionale në fazën e pubertetit.
- Vlera për mbrojtjen e shëndetit seksual personal dhe të tjerëve.
- Vlera të integritimit me shkencat e tjera duke mundësuar nxënësve formimin e parafytyrimeve të plota mbi natyrën, jetën dhe dukuritë e ndërlydhura duke nënkuptuar unitetin në mes të botës organike dhe asaj joorganike.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Gjinnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin konceptin e shkencave natyrore – të organizuara përmes temave dhe rezultateve me anë të të cilave përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara mes koncepteve dhe temave mësimore, si dhe balancimit të rezultateve të të nxënit me temat, ku mbetet përgjegjesi e mësimdhënësit të bëjë balancimin e rezultateve të të nxënit për temë me rezultatet e të nxënit për njësi mësimore, përmes përmbajtjeve në interes të nxënësve.

Koncepti	RNF 4.1 Analizon llojllojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, ADN dhe trashëgimia, proceset bio-kimike në qelize.
-----------------	--

	4.2 Vlerëson ndikimin e barnave dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njerëzve, ndërlidhjen e shëndetit me sëmundjet, zvogëlimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme (duke përfshirë edhe sëmundjet e transmetueshme seksualisht).	
	Temat	Rezultatet e tënxënittëlëndëspërtemë (RNL)
Bota e gjallë	Biologjia e qelizës	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet mes qelizave të ndryshme të qenieve të gjalla (prokariote dhe eukariote, bimoredheshtazore, njëqelizore dhe shumëqelizore etj.). • Emërton organelet qelizore dhe përshkruan funksionin e tyre. • Shpjegon ndërtimin e membranës qelizore dhe identifikon mënyrat e bartjes së materieve nëpër membranë.
	Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason ndërtimin, funksionin e virusëve dhe baktereve, shpjegon mënyrën e jetesës, shumimit, të ushqyerit si dhe emërton disa sëmundje që shkaktojnë virusët dhe bakteret. • Shpjegon kërpudhat simbre të rriëveqante ebotëssëgjallë dhe vlerëson rolin e tyre në jetën njeriut. • Vrojton me mikroskop hifet, micelet dhe sporangjet e mykut bukës. • Përshkruan ndërtimin e likenëve, simbiozën mes algave dhe kërpudhave. • Përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet myshqeve dhe fiernave, sa i përket ndërtimit anatomik dhe mënyrës së shumimit (ndërrimi i gjeneratave gametofit dhe sporofit) dhe bën klasifikimin e tyre. • Dallon farëzhveshurat nga farëveshurat. • Hulumton dhe identifikon disa përfaqësues të halorëve që jetojnë në viset tona. • Shpjegon ndërtimin e organeve riprodiktive të farëveshurave (lulja, faradhefryti). • Dallon bimët njëkotedone nga ato dikotedone si

		dhe emërton disa lloje bimore sipas vlerave ushqyese dhe mjekësore.
	Metabolizimi	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon shndërrimin e përhershëm të materies – metabolizmin. • Përshkruan dhe dallon proceset anabolike nga ato katabolike, aerobenga anaerobe endoenergjetike nga ato ekzoenergjetike, fotosintezën nga kemosinteza. • Analizon procesine frymëmarrjes dhe vlerëson roline ATP-së gjatë proceseve energjetike në qelizë.
	Trashegimia dhe gjenetika	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon dhe vlerëson rolin e trashëgimisë në zhvillimin e botës së gjallë. • Krahason dhe dallon ADN-në nga ARN-ja sipas ndërtimit dhe funksionit. • Definojnë termin gjen (gjen strukturor dhe rregullator), gjenotip, fenotip, mutacion, monohibrid, dihibrid, kod, kodon, antikodon etj. • Përshkruan hapat bazike të sintezës së proteinave, identifikon roline ADN-së dhe ARN –së dhe ribosomeve në procesin e transkriptimit dhe translatimit. • Përshkruan rregullat themelore të trashëgimisë sipas Mendelit. • Emërton dhe shpjegon tipat e trashëgimisë së veçorive të bimëve dhe shtazëve (dominant-recesiv, kodominant, intermediar, dhe korelativ ose të lidhur). • Dallon dhe klasifikon ndërrimet në strukturën dhe nënumrin e kromozomeve si dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e këtyre mutacioneve. • Vlerëson dhe arsyeton roline poliploidisë në përfitimin e varieteteve të reja të bimëve, përrritjen e sasisë dhe cilësisë për qëllime ekonomike të njeriut. • Shpjegon heteroploidinë (aneuploidinë), numëron

		<p>dhe përshkruan sindromet e njeriut (Daunit, Eduardit, Pataut dhe Turnerit e Klinefelterit).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hulumton mënyrat e trashëgimisë së veçorive dhe sëmundjeve të njeriut si autosomale dominante, autosomalrecesive, si dhe të lidhura për kromozomin X sidominant edhe recesive dhe trashëgimi të lidhur për kromozomin Y (holandrik). • Arsyeton dhe vlerëson rolin e këshillimit gjenetik, amniocentezës si dhe pasojat e kryqëzimit në farefisni. • Klasifikon faktorët mutagjen sipas natyrës dhe efektit veprues të tyre dhe pasojat që paraqiten në materialin gjenetik.
	Evolucion	<ul style="list-style-type: none"> • Definon termin evolucion. • Përshkruan shfaqjen dhe mbizotërimin e grupeve të ndryshme të gjallesave gjatë historisë në periudhat e ndryshme gjeologjike. • Vlerëson rolin e provave anatomiko-krahasuese, embriologjike, fiziologjike, biokimike, dhe fosileve për teorinë e evolucionit. • Arsyeton rolin e përzgjedhjes natyrore, tregon shembujt e përzgjedhjes natyrore dhe artificiale si dhe përshkruan mënyrat e formimit të llojit. • Përshkruan pemën gjenealogjike të primatëve – diskuton racat njerëzore.
	Rreziqet për shëndetin seksual dhe riprodhues	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson për efektet negative të përdorimit të drogave. • Identifikon sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe pasojat e tyre. • Vlerëson masat parandaluese për sëmundjet seksualisht të transmetueshme. • Përzgjedh fushata senzibilizuese për mbrojtjen nga sëmundjet seksuale.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- biologji, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen këto qasje metodologjike të mëposhtme

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhëniamë anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësi të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para

nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - biologji, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- biologji është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Biologji (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Hartimi i plan - programit mësimor të lëndës së biologjisë është realizuar mbi bazën e KB –së niveli III dhe i dedikohet nxënësve të klasës X të Gjinnazit të shkencave natyrore dhe Gjinnazit të shkencave shoqërore – gjuhësore (ndryshimi mes tyre qëndron në shtrirjen dhe thellësin e problematikave) Hartimi i programit respekton një procedurë të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodave dhe instrumentave të vlerësimit.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor jemi nisur nga synimi i arritjes së kompetencave të paraplanifikuara me Kurrikulen Bërthamë, përmes rezultateve lëndore - Biologji.

Përmbajtja e programit mësimor të biologjisë, metodologjitë, qasja, shfrytëzimi i burimeve të ndryshme mësimore, fleksibiliteti dhe kreativiteti i mësimit si dhe autonomia e shkollës (hartimi i rezultateve specifike mësimore), kontribuojnë që të nxënësi të zhvillohen kompetencat e ndryshme.

Ky program është përqëndruar në vazhdimësinë e koncepteve nga niveli i parë i arsimit parauniversitar, por duke avancuar nivelin e kompetencave përmes zhvillimit vertikal të çështjeve shkencore, të përmbledhura në Rezultate të Fushës (RNF), prej nga burojnë temat e caktuara të cilat zërthehen përmes rezultateve të të nxënësve lëndor, të cilat rezultate duhet të arrihen përmes rezultateve të njësive mësimore të cilat i parashoh mësimit në kontekst të shkollës dhe klasës (atë se çfarë dhe cilat lloje të rezultateve duhet t'i arrijë nxënësi dhe çka duhet të punojë mësimit).

Filozofia e KK-së respektohet, ku në vend të transmetimit të informatave nga mësimit tek nxënësi, roli i mësimit kalon në rol përkrahës, ndërsa tek nxënësi kultivohen shprehitë e gjenerimit të informatave të reja, kërkimin e pavarur të burimeve të informatave, punë të pavarur etj.

Si bartës i ndryshimeve në procesin mësimor, mësimit i udhëzon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të vërtetojnë, të masin, të klasifikojnë, të formojnë modele, të shtrojnë hipoteza, të zgjidhin probleme, të aftësohen për përdorim të drejtë dhe të sigurt të vegjërisë dhe instrumenteve në laboratorët biologjike, të dizajnojnë eksperimentin, të incizojnë dhe të paraqesin të dhënat etj., poashtu mësimit merr rolin mbështetës dhe motivues gjatë trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me pubertetin dhe ndryshimet fiziologjike, psikike dhe emocionale të moshës së nxënësve.

Me fjalë tjera, mësimi i biologjisë kontribuon në përgatitjen e nxënësit që dijet dhe shkathësitë e fituara të mund t'i zbatojnë në mjedisin ku jetojnë, kështu ai transformon vetveten dhe shoqërinë.

Qëllimi

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X është vazhdimësi e programit mësimor të shkencave natyrore – biologji nga niveli II i arsimit parauniversitar, si i tillë, konsiston në konsolidimin e kompetencave paraprake (në thellimin e diturive të nxëna dhe në zhvillimin e shkathtësive, vlerave dhe të qëndrimeve etj). Andaj, mbi këtë bazë, programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën X i siguron nxënësit synimin e zhvillimit të mëtejshëm për:

- Thellim të njohurive mbi nocionet dhe ligjet biologjike.
- Aftësi dhe shprehje komunikimi duke përdorur gjuhë shkencore për interpretim të ideve, fenomeneve dhe të proceseve jetësore.
- Shprehje për punë në grupe dhe në ekipe punuese, ndjenjës së shoqërizimit dhe të vetive të tjera pozitive të personalitetit të domosdoshme për bashkëpunim konstruktiv në zgjidhjen e detyrave të parashtruara.
- Shkathtësi hulumtuese (përmes mësimit eksperimental, vrojtues, matës dhe analizues të zhvillojnë aftësitë krijuese, të menduarit analitik, vlerësimin objektiv ndaj vetvetes dhe grupit gjatë punës ekipore).
- Aftësiqë me punën e tyre kreative të zbulojnë mënyrën përdorimit të arritjeve teknologjike me punën shkencore.
- Qëndrime për faktet shkencore në aspekt të çështjes industriale, etike dhe ambientore
- Qëndrime për sjelljet emocionale në fazën e pubertetit.
- Vlera për mbrojtjen e shëndetit seksual personal dhe të tjerëve.
- Vlera të integritimit me shkencat e tjera duke mundësuar nxënësve formimin e parafytyrimeve të plota mbi natyrën, jetën dhe dukuritë e ndërlydhura duke nënkuptuar unitetin në mes të botës organike dhe asaj joorganike.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Gjinnazi i shkencave natyrore

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin konceptine shkencave natyrore –të organizuara përmes temave dhe rezultateve me anë të të cilave përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara mes koncepteve dhe temave mësimore, si dhe balancimit të rezultateve të të nxënit me temat, ku mbetet përgjegjesi e mësimdhënësit të bëjë balancimin e rezultateve të të nxënit për temë me rezultatet e të nxënit për njësi mësimore, përmes përmbajtjeve në interes të nxënësve.

Koncepti	<p>RNF 4.1 Analizon dhe hulumton llojlojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, rolin e ADN-së në trashëgimi ndërtimin dhe proceset biokimike në qelizë, dhe zbatimin e ligjshmërisë së ndërtimit dhe funksionit të sistemeve të gjalla në bioteknologji dhe teknikë.</p> <p>4.3 Vlerëson ndikimin e barnave dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njerëzve, ndërlihdjen e shëndetit me sëmundjet, zvogëlimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme (duke përfshirë edhe sëmundjet e transmetueshme seksualisht).</p>	
	Temat	Rezultatet e tënxënittëlëndës për tema (RNL)
Bota e gjallë	Biologjia e qelizës	<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton ndërtimin e qelizës. • Arsyeton unitetin e botës së gjallë me botënjo të gjallë. • Krahason ngjashmëritë dhe dallimet mes qelizave të ndryshme të qenieve të gjalla të ndryshme, (prokariote dhe eukariote ,bimore, shtazore, njëqelizore, shumëqelizore). • Shpjegon ndërtimin e membranës qelizore si dhe proceset të cilat kryhen në të,(osmozë,difuzion,transport aktiv,endo dhe ekzocitozë). • Analizonndërtimin dhe funksionin e strukturave(organeleve) qelizore.
	Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan principet dhe metodat e klasifikimit të qenieve të gjalla • Vlerëson rolin e Karl Line-ut në krijimin e sistemit modern të klasifikimit dhe emërtimit të qenieve të gjalla. • Bënë dallimin në mes metodave të klasifikimit që përdorin taksonomistët. • Arsyetonpohiminsivijon: Virusët nukjanëqenietë gjalla. • Përshkruan ndërtimin e virusit, mënyrën e riprodhimit dhe disa sëmundje të shkaktuara nga virusët.

		<p>Mbretëria Monera</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndërtimin e qelizës bakteriale dhe dallon atë nga qeliza eukariote. • Përshkruan mënyrat e të ushqyerit dhe riprodhimit të baktereve. • Përshkruan dobëtë, dëmet-sëmundjet e shkaktuara nga bakteret si dhe mënyrat e parandalimit të sëmundjeve bakteriale. • Vlerëson rëndësinë e antibiotikëve në luftimin e sëmundjeve bakteriale. <p>Mbretëria Protista</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon karakteristikat e përbashkëta për të gjithë anëtarët e Mbretërisë Protista. • Krahason ndryshimet sipas formës, madhësisë dhe mënyrës sesi e sigurojnë energjinë grupet e ndryshme të protistëve. • Vlerëson rolin e protistëve autotrofë në ekosistem. • Identifikon llojet e ndryshme të protistëve heterotrofë. • Emërton dhe shpjegon shfaqjen e sëmundjeve • Karakteristike të shkaktuara nga protistët. <p>Mbretëria Fungi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon karakteristikat e përbashkëta për shumicën e kërpudhave të mbretërisë Fungi. • Përshkruan mënyrat se si sigurojnë ushqimin kërpudhat. • Krahasojnë dhe dallojnë mënyrat e riprodhimit të grupet e ndryshme të kërpudhave. • Bën dallimin në mes grupeve të kërpudhave: Fikomycetes, Ascomycetes, Basidiomycetes. • Lidhin karakteristikat e kërpudhave me rëndësinë e tyre ekologjike dhe ekonomike. <p>Mbretëria Plantae- Bimëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan përshtatshmëritë që u mundësuan bimëve të mbijetojnë-ekzistojnë në mjedisin tokësor-terrestrik. • Definon konceptin e alternimit të gjeneratave tek grupet e caktuara të bimëve.
--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Bën dallimin mes bimëve joenësore-jovaskulare nga bimët enësore-vaskulare. • Lidhë karakteristikat e bimëve jovaskulare dhe vaskulare me habitatet e tyre. • Shpjegon se si zhvillimi i farave u mundësoi bimëve të kenë sukses në shumicën e habitateve. • Përmbledhë procesin e riprodhimit të bimët farëzhveshura. • Përshkruan rolin e luleve në ciklin jetësor të farëfsheturave. • Identifikon disa familje të rëndësishme të farëfsheturave. • Përshkruan strukturat dhe funksionet e rrënjëve dhe sythave. • Krahason dhe dallon indet përquese, indet mekanike, indet mbuluese dhe krijuese. • Bën dallimin mes bimëve monokotiledone dhe dikotiledone. • Përshkruan se si uji dhe lendët tjera ushqyese lëvizin nëpër ksilemë dhe floemë. • Lidhë mënyrat e rritjes së bimëve me veprimin e hormoneve bimore. • Përshkruan mënyrat sipas të cilave bimët reagojnë në ndryshimet stinore gjatë vitit. • Lidhë ndërtimin e lules me procesin e riprodhimit seksual tek bimët me lule. • Bën dallimin mes procesit të pjallimit dhe fertilizmit-fekondimit tek bimët me lule. • Lidhë ndërtimin e farave dhe fryteve me përhapjen e bimëve. • Përshkruan rendësinë e farave të drithërave dhe bishtajorëve në të ushqyerit e shëndetshëm të njeriut. • Identifikon ushqimet që kanë origjinë nga frytet, farat, rrënjët, kërcejtë, gjethet dhe lulet. • Identifikon bimët si resurs për prodhimin e barnave-ilaqeve. <p>Mbretëria e Shtazëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërton dhe përshkruan tri karakteristikat themelore të shtazëve. • Njeh përparësinë e multicelularitetit dhe bënë dallimin mes indeve dhe qelizave të specializuara. • Liston tri karakteristika të hasura te knidariet por jo te sfungjerët.
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason planet e ndërtimit të shtazëve me simetri bilaterale dhe radiale. • Krahason dhe dallon tri tipet e zgavrave trupore të shtazët. • Dallon mënyrën e jetës së sfungjerëve nga mënyra e jetës së knidarieve. • Përshkruan dhe krahason ciklet jetësore të knidarieve dhe krimbave të shtypur dhe boshtor parazitare. • Identifikon tri klasët themelore të mollusqeve-butakëve. • Përmbledhë përparësitë evolutive të dukurisë së segmentimit trupor në shembullin e krimbave unazorë Annelida dhe këmbënyjtuarëve. • Përshkruan mënyrat se si krimbat unazor ndikojnë në jetën e njeriut. <p style="text-align: center;">Arthropoda</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërton pesë përfaqësues të artropodeve. • Përshkruan karakteristikat themelore të Arachnidave dhe funksionin e helicerateve dhe pedipalpeve të merimangat. • Përshkruan tri mënyra se si merimangat shfrytëzojnë fijet e mëndafshit. • Liston dy lloje të arahnidave të cilat drejtpërdrejtë prekin ose dëmtojnë njerëzit. • Krahason ndërtimin trupor të merimangave me ndërtimin trupor të insekteve. • Bënë dallimin mes zhvillimit me metamorfozë jo të plotë dhe me metamorfozë të plotë të insektet. • Përshkruan karakteristikat themelore të rendeve kryesore të insekteve duke ilustruar secilin me dy ose tre lloje përfaqësuese. • Përshkruan karakteristikat themelore të gaforreve Crustacea. • Identifikon nga një lloj të gaforreve nga rendet Dekapoda, Amphipoda, Isopoda, Cladocera dhe Copepoda • Shpjegon karakteristikat kryesoretë echinodermatave dhe përshkruan disa përfaqësues më të njohur. <p style="text-align: center;">Kurrizorët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan karakteristikat e përgjithshme të
--	---

		<p>kurrizorëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan karakteristikat themelore të peshqve pa nofulla Agnatha dhe mënyrën si ushqehen. • Përshkruan karakteristikat themelore të peshqve kërcor Chondrichthyes dhe dallimin e tyre me peshqit pa nofulla Agnatha. • Identifikon dallimet mes peshqve eshtrorë dhe peshqve kërcorë dhe përshkruan rëndësinë e fshikëzës notuese të peshqve eshtror. • Përmbledhë karakteristikat e grupeve kryesore të peshqve duke ilustruar secilin me së paku një përfaqësues në veçanti i përshkruan peshqit Crossopterygii me llojin <i>Latimeria chalumnae</i>. • Identifikon karakteristikat që u mundësuan ujëtokësorëve për të pushtuar tokën. • Përshkruan ciklin jetësor të bretkocës. • Përshkruan karakteristikat e tri rendeve të ujëtokësorëve: Apoda, Anura dhe Urodela. • Përshkruan përshtatshmëritë përmes të cilave zvarranikët u adaptuan për të jetuar në tokë. • Bën dallimin mes ektotermisë dhe endotermisë. • Përshkruan një hipotezë e cila shpjegon zhdukjen e dinosaurëve. • Liston katër rendet e zvarranikëve të cilët aktualisht jetojnë në natyrë dhe përshkruan shkurtimisht karakteristikat themelore të tyre duke i ilustruar me së paku një përfaqësues. • Përshkruan ngjashmëritë mes shpendëve dhe zvarranikëve. • Përshkruan dallimet mes shpendëve dhe zvarranikëve. • Përshkruan rolin e skeletit dhe puplave të shpendët. • Përmbledhë karakteristikat themelore të rendeve kryesore të shpendëve duke i ilustruar me së paku një përfaqësues. • Përshkruan karakteristikat themelore dhe unike të gjitarëve. • Identifikon dy karakteristika themelore të gjitarëve primitive që bëjnë vezë Monotremata. • Bën dallimin mes mënyrës së zhvillimit të gjitarët marsupial me atë të gjitarëve placentalë. • Përmbledhë karakteristikat themelore të rendeve kryesore të gjitarëve duke ilustruar secilin me së paku
--	--	--

		një përfaqësues.
	Rreziqet për shëndetin seksual dhe riprodhues	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson për efektet negative të përdorimit të drogave. • Identifikojnë sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe pasojat e tyre. • Vlerëson masat parandaluese për sëmundjet seksualisht të transmetueshme. • Përzgjedh fushata senzibilizuese për mbrojtjen nga sëmundjet seksuale.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- biologji, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen këto qasje metodologjike të mëposhtme

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhëniamë anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe

motivimit të tyre për të nxënë;

- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënit;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënit;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - biologji, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndalet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- biologji është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;

- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Fizikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Programi i lëndës së fizikës për klasën e dhjetë, gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Fusha kurrikulare „Shkencat e natyrës” në nivelin III-të të shkallës V-të kurrikulare arsimit parauniversitar, paraqet vazhdimësin e asaj që është arritur në nivelin e II-të në kuadër të fushës së shkencave të natyrës si të integruara përmes lëndës së fizikës.

Integrimi i lëndëve mësimore realizohet përmes Koncepteve – të fushës së shkencave. Konceptet paraqesin referencën për përcaktimin e temave mësimore.

Nga kjo kuptojmë së një concept i caktuar i fushës së shkencave natyrore nuk përkufizohet vetëm për një lëndë mësimore.

Në shkallën e III kurrikulare, përsëri ruhet integrimi ani pse mësimdhënia organizohet në lëndë mësimore (Biologji, Kimi dhe Fizikë) Lënda mësimore, Fizika 10, më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare - „ **proceset fizike**” por edhe në konceptet tjera.

Koncepti i fushës „ proceset fizike” është i zbërthyer në: **Domenet : I.Lëvizja; II.Struktura e lëndës; III.Bashkëveprimi; IV.Energjia.**

Lënda e fizikës, që do të mësohet në klasën VI përfshinë njësitë mësimore më të kondenzuara, por gjithnjë duke pasur parasysh aftësitë psiko-fizike të nxënësve.

Nëpërmjet lëndës së fizikës nxënësit njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e dukurive të natyrës.

Detyrë e mësimin të fizikës është: zhvillimi i aftësive vrojtuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht proces njohës, veprues dhe ndërveprues, përdorimit të mjeteve teknologjike gjatë hulumtit shkencor

Rezultatet lëndore, pika referente kanë temat: hulumtimin kërkimin në fizikë për kinematiken e lëvizjeve, bashkëveprimet gravitacionale elektromagnetike ligjet e ruajtjes, punën, energjinë dhe zbatimin e saj .

Qëllimi

Fizika e kl.10 e integruar në shkencat e natyrës ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësit, duke gërrshetur të nxënësve teorik me metodat e hulumtimit (vrojtimit të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në terren, burimeve të ndryshme mësimore, përpunimit të informatave dhe prezentimit të gjeturave etj.).

Kjo iu mundëson nxënësve që aktivisht të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe në saje të kërkimeve të gjenerojnë informacionet, kuptojnë, shpjegojnë dhe ndërhyjnë në ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Nxënësit, duke gjeneruar informatat e shumta, hulumtojnë thelbin e problemit, zhvillojnë dhe zbatojnë të menduarit kritik, përpunojnë dhe prezantojnë të dhëna dhe informata shkencore.

Aftësohen të analizojnë, argumentojnë dhe përgjithësojnë të dhënat.

Të mësuarit e lëndës së fizikës ka për qëllim të zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e fizikës:

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Përmes lëndës së fizikës, klasa e dhjetë nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e fizikës
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- përshkruajnë burimet energjitike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Organizimi i përmbajtjes së lëndës

Përmbajtja e lëndës së fizikës është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënësve lëndore (RNL). Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshinë gjashtë koncepte, të zërthyer në koncepte specifike (domeni) në tema dhe rezultateve të të nxënësve lëndore me anë të të cilave përfshihet fondamenti i fushës së shkencës në lëndën përkatëse.

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Domenet: I. Levizja; II. Struktura e lëndës; III. Bashkëveprimi; IV. Energjia.

Koncepti	Tema	Rezultatet e të nxënësve të lëndës
Proceset fizike	Lënda e	I. II. III. IV. Nxënësi: -përkufizon fizikën si shkencë që studion vetitë e materies, strukturën e saj dhe shndërrimet në natyrë duke arësytuar me shembuj.

	studimit të fizikës	<p>-shpjegon se fizika i zbulon mështetësitë e natyrës, matematika i artikulon në formë të ligjeve kurse inxhinieria i dizajnon në formë të prodhimeve për ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut.</p> <p>-dallon me shembuj, saktësinë e ligjeve të fizikës ndaj saktësisë së procesit të zbatimit të tyre nga inxhinierët, sepse produktet e dizajnuara nuk gjykohen për nga vërtetësia tyre.</p> <p>-vlerëson se nga të gjitha shkencat me të cilat ka lidhmëri fizika, matematika ka rol determinues në ndërtimin e ligjeve, modeleve dhe teorive.</p> <p>-dallon teorinë nga eksperimenti në fizikë dhe ligjet e fizikës nga parimet e saj duke arësytuar me shembuj.</p>
	Lëvizjet e thjeshta	<p>I.</p> <p>-renditë në tabelë madhësitë themelore fizike dhe njësitë përkatëse.</p> <p>-përkufizon në mënyrë analitike lëvizjen e njëtrajtshme drejtvizore dhe të nxituar të pikës lëndore.</p> <p>-shpjegon lëvizjen rrethore me shpjetësi konstante dhe lëvizjen me drejtim të ndryshuar të shpejtësisë.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht matjen e gjatësive dhe të trashësive shume të vogla me ndihmën e veglërive përkatëse.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht përcaktimin e kohës së zgjajtes së një ndodhie dhe kohën e reaksionit të njeriut.</p> <p>-vizaton diagramet $x-t$, $v-t$ dhe $a-t$ dhe interpreton kuptimin e sipërfaqeve nën grafet $v-t$ dhe $a-t$.</p> <p>-shpreh shembuj të shndërrimit të njësive matëse të mëdha në njësi matëse më të vogla dhe anasjelltas.</p> <p>-zgjidhë detyra problemore për lëvizje të thjeshta.</p>
	Bashkëveprimet dhe llojet e forcave	<p>I dhe III.</p> <p>-përshkruan shembuj të bashkëveprimit gravitacional elektrik dhe magnetik për trupa që takohen dhe në distancë.</p> <p>-vlerëson masën, vëllimin dhe densitetin e trupit si veti karakteristike të përcaktimit të tij.</p> <p>-analizon eksperimentet e menduara të Galileit për zbulimin e ligjit të inercisë.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht shembuj për verifikimin e ligjit të parë të Njutonit.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht shembuj për verifikimin e ligjit të dytë të Njutonit.</p>

		<p>-prezanton forcën me ndihmën e nxitimit apo sasisë së lëvizjes dhe analizon grafet $a(F)$ dhe $a(1/m)$.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht shembuj për verifikimin e ligjit të aksionit dhe reaksionit.</p> <p>-dallon forcat aktive nga forcat pasive dhe trajton qetësinë e trupit me ndihmën e tyre.</p> <p>-trajton analitikisht dhe grafikisht forcat elastike, tensionin normal dhe llojet e deformimit.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht ligjin e Hukut për elasticitet.</p> <p>-analizon fërkimin statik dhe dinamik, ekuacionin e lëvizjes së trupit dhe rezistencën e mjedisit.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht përcaktimin e koeficientit të fërkimit dinamik me ndihmën e rrafshit të pjerrët.</p> <p>-zgjidh detyra të ndërlidhura me zbatimin e ligjeve të Njutonit.</p>
	Energjia dhe ligji i gravitetit.	<p>IV.</p> <p>-shqyrton analitikisht dhe grafikisht punën mekanike dhe forcat përkatëse.</p> <p>-dallon trajta të ndryshme të energjise: mekanike, elektrike, magnetike, të brendshme, kimike dhe biologjike etj.</p> <p>-shpjegon energjinë si madhësi konstante të një trupi a sistemi dhe lidhjen e punës me energji dhe fuqi.</p> <p>-shpjegon modelin e sistemit të mbyllur fizik duke u bazuar në shembuj të ndryshëm.</p> <p>-analizon shndërrimin e energjisë dhe zbaton ligjin e ruajtjes së saj në rastin kur nuk përfillen humbjet.</p> <p>-vlerëson përparsitë e heliocentrizmit ndaj gjeocentrizmit dhe kontributin e Kopernikut për shpjegimin e lëvizjes së dukshme të planeteve nëpër nyje.</p> <p>-shpreh ligjet e Keplerit dhe ligjin e Njutonit për gravitet, për shpjegimin e lëvizjes së planeteve rreth Diellit në orbita eliptike.</p> <p>-zgjidh detyra të ndërlidhura me energjinë, punën, fuqinë dhe ligjin e Njutonit për gravitet.</p>
	Modeli i gazeve ideale dhe ligjet e tyre	<p>II dhe IV</p> <p>-demonstron eksperimentalisht izoproceset dhe analizon çdo njerin prej tyre bazuar në modelin e gazit ideal.</p> <p>-përkufizon zeron absolute të temperaturës dhe e zbaton në shprehjet e izoproceseve.</p> <p>-shkruan ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit ideal dhe i analizon madhësitë që figurojnë në të.</p>

		<p>-tregon mënyra të përkufizimit të temperaturës dhe duke u bazuar në ligjin zero të termodinamikës.</p> <p>-përkufizon ligjin e parë të termodinamikës në formë analitike.</p> <p>-paraqet me fjalë dhe me vizatim formulime të ndryshme të ligjit të dytë të termodinamikës.</p> <p>-përkufizon entropinë dhe ligjin e tretë të termodinamikës.</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për ndërrimet e gjendjes së gazeve.</p>
	Lëkundjet dhe valët	<p>I dhe IV.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht lëvizjen lëkundëse të sustës elastike dhe përcakton konstantën elastike të saj.</p> <p>-dallon lëkundjet e lira, lëkundjet e shuara dhe lëkundjet e detyruara.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht lëkundjen e shuar, duke u ndihmuar nga zvogëlimi i amplitudës së lavjerrësit matematik dhe vizaton grafën e saj.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht vartësinë e periodës së lëkundjes së lavjerrësit nga gjatësia e perit dhe masa e trupit.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht përcaktimin e nxitimit g të rëndimit me ndihmën e lavjerrësit matematik.</p> <p>-dallon lloje të valëve sipas mënyrës së krijimit dhe paraqet grafën e tyre.</p>

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- fizike, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- * Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- * Mësimdhënie jo drejtëdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- * Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- * Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- * Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- * Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- * Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- * Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- * Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- * Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënësve në lenden e fizikes janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Në lëndën e fizikës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave.

Metodat që mund të përdoren në lëndën e fizikës janë:

- vëzhgimin,
- modelimin,
- metodat eksperimentale dhe empirike,
- formimin e një ideje (hipotzes)
- përdorimin e TIK-ut.
- Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Metoda e vëzhgimit: Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi

Modelimi: nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i

ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

Metoda eksperimentale: Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike: Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Projektet: Projektet janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

TIK Teknologjia e informacionit mbështet procesin kërkues, rritë cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive. *

Format e punës

- individuale,
- në çifte,
- në grupe të vogla,
- me të gjithë nxënësit.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Lidhja me fushave të tjera kurrikulare

Gjuhët dhe komunikimi: Të dëgjuarit të folurit të lexuarit e teksteve të ndryshme

Matematika: Zgjidhja problemore arsyetimi dhe vërtetimi matematik . Të menduarit dhe komunikimi matematik

Shkencat e natyrës: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre . Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore. Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës

Shoqëria dhe mjedisi: Trajton mjedisin natyror-shoqëror si një pasuri, e cila duhet të ruhet dhe të shfrytëzohet për të mirat e shoqërisë.

Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: Mbronë shëndetin duke respektuar rregullat e lëvizjeve trupore, aktiviteteve të lojrave sportive individuale dhe kolektive dhe të organizimit të pushimit.

Jeta dhe puna: Respekton parimet e punës në grup dhe bashkëpunon në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të përcaktuara duke shfaqur shkathhtësi manovruese në përdorimin e veglave, pajisjeve dhe teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të marrë informacione gjatë hulumtimeve Mendimi kritik, problemzgjdhja dhe vendimmarrja 4. Kreativiteti dhe inovacioni

Çështjet/Temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë
- Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media:

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshinë përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm

Udhëzime për vlerësim

Zbatimi i programit mësimor, është i pamundur pa komponenten e vlerësimit të nxënësit.

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësit gjatë procesit të të nxënës dhe nxjerrja e gjykimit për ato arritje.

Vlerësimi është në funksion të:

Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësit dhe motivimit të tij për të nxënë

Vlerësimi i punës praktike dhe demonstruese.

- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënës;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësit gjatë procesit të të nxënës;
- Vetëvlerësimit të nxënësit ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi mund të klasifikohet në vlerësim:

Formues, përmbledhës, përfundimtar dhe përmbyllës.

1) Vlerësimi formues (vlerësimi për të nxënë) kryhet në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e informacioneve të arritjeve të nxënësit gjatë çdo veprimtarie mësimore, me qëllim përkrahje të nxënësit.

- Vlerësimi diagnostikues - përdoret për marrjen e informacioneve të arritjes së nxënësit për shkallën e përvetësimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave dhe i ndihmon mësimdhënësit në punën e mëtejshme.
- Vlerësimi motivues - përdoret për nxitjen e interesimit dhe dëshirën e nxënësit për të nxënë.

2) Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi i të nxënës) - përfshinë arritjen e përgjithshme të të nxënës të nxënësit. Vlerësimi përmbledhës bëhet në fund të periudhave të caktuara, periudhë të cilën e përcakton mësimdhënësi (një mujore, dymujore, tremujore, etj.).

Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumenta të ndryshëm vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënës. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësit, prindërve dhe komunitetit.

3) Vlerësimi përfundimtar:

- Përfshinë vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore e përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundim tremujorit të I-rë, II-të dhe III-të). Vlerësimi përfundimtar nënkupton përmbledhjen e dy apo më shumë vlerësimeve përmbledhëse, brenda një tremujori.
- Vlerësim përfundimtar, quhet dhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.

4) Vlerësimi përmbyllës – Realizohet në fund të shkallës kurrikulare.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veqanti për arritjen e rezultateve nga

shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së

Mësimdhënësit e shkencave natyrore –Fizika e klasës dhjetë , për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard të jetë i specifikuar bazuar në kritere, i hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës brenda kornizave të planit vlerësues nivel DKA-ve dhe UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke gjykuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkoj mundësi zhvillimi profesional, hulumtim, rishiqim të kritereve vlerësuese, rizgjedhje të instrumentave vlerësues, e mbi të gjitha të këtë gadishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësit, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënsi dhe prindërit) të jetë transparent të iu shpërndahet kopja në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- **Vlerësimi me shkrim**
- **Vlerësimi me gojë**
- **Vlerësimi me anë të dëgjimit**
- **Vlerësimi praktik**
- **Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve**
- **Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren**
- **Testimi** - është ecuria e matjeve sipas një qëllimi të caktuar

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

- Testet me përgjigje alternative
- Testet me kombinime
- Testet me alternativa të shumta
- Testet me përgjigje të shkurta dhe me plotësim

Vlerësimi duhet të jetë:

- I vlefshëm
- I besueshëm
- I paanshëm

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- fizike është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale - pamore - dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma, etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Fizikë (Gjimnazi i shkencave të natyrës)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe të sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgim dhe eksperimenteve.

Mësimi i Fizike për klasën e dhjetë – gjimnazi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Fzika është shkencë dinamike dhe evolutive prandaj dituritë tona për natyrën vazhdimisht përparojnë në çilesi për këto arsye ndihet nevoja për freskimin e vazhueshëm të planit mesimor.

Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës, në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kryesore, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Fusha kurrikulare „Shkencat e natyrës” në shkallën e V paraqet vazhdimësinë e asaj që është arritur në arsimin të mesëm të ulët.

Lënda mësimore, Fizika 10, më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare – „proceset fizike” por edhe në konceptet tjera. Pikë referimi për lëndën Fizika 10, paraqesin rezultatet e të nxënësve të kompetencave dhe rezultatet e të nxënësve të fushës – Shkencat e natyrës (RNF) shkalla V kurrikulare.

Përmes mëimit të Fizikes, kontribuojmë që nxënësi të arrij kompetencat e synuara sipas Kurrikulës Bërthamë për shkallën e V- arritjen e rezultateve të fushës të parapara për klasën e 10.

Rezultatet lëndore, në fizike për klasën e dhjetë si pika referente kanë temat: hulumtimin dhe kerkimin në fizike për kinematikën e lëvizjet, forcën bashkëveprimet, energjinë, ligjet e ruajtjes, strukturën e lëndës të cilat kanë lidhshmëri horizontale me konceptet dhe lidhshmëri vertikale me RNF-të përgjatë gjithë arsimin parauniversitar.

Qëllimi

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Përmes lëndës së fizikes kl 10 nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e fizikes
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- përshkruajnë burimet energjitike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);

- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalta nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së pestë të kurrikulës (Shk 5) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Programi mësimor për lëndën e fizikës të klasës 10 gjimnazi i shkencave të natyrës.

- **Koncepti:** **I.**Lëvizja; **II.**Struktura e lëndës; **III.**Bashkëveprimi; **IV.**Energjia.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit
Proceset Fizike	1.Lënda e studimit të fizikës	<p>I, II, III dhe IV. Nxënësi: -përkufizon fizikën si shkencë që studion vetitë e materies, strukturën e saj dhe shndërrimet në natyrë duke arësytuar me shembuj. -tregon se qëllimi themelorë i studimit të fizikës është zbulimi i së vërtetës për natyrën i shkruar në formë të ligjeve, rregullave dhe teorive. -shpjegon se fizika i zbulon mësheftësitë e natyrës duke u bazuar në hipoteza, matje, eksperiment, dhe modele, matematika i artikulon në formë të ligjeve, rregullave dhe teorive, kurse inxhinieria i dizajnon si prodhime për ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut. -dallon saktësinë e ligjeve të fizikës ndaj saktësisë së procesit të zbatimit të tyre nga inxhinierët, sepse produktet e dizajnuara nuk gjykohen për nga vërtetësia tyre. -vlerëson se nga të gjitha shkencat me të cilat ka lidhmëri fizika, matematika ka rol determinues në ndërtimin e ligjeve, modeleve dhe teorive. -dallon teorinë nga eksperimenti në fizikë dhe ligjet e fizikës nga parimet e saj duke arësytuar me shembuj.</p>
	2.Lëvizjet e thjeshta dhe të përbëra.	<p>I. -liston madhësitë themelore fizike dhe njësitë gjegjëse. -identifikon madhësitë skalare dhe madhësitë vektoriale në fizikë dhe interpreton veprimet me to.</p>

	<p>-demonstron eksperimentalisht matjen e gjatësisë me ndihmën e veglërive përkatëse.</p> <p>-përshkruan analitikisht, në mënyrë tabelare dhe grafike lëvizjet e thjeshta.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht përcaktimin e kohës së zgjajtes së një ndodhie dhe kohën e reaksionit të njeriut.</p> <p>-shqyrton analitikisht dhe grafikisht lëvizjet kinematike të përbëra.</p> <p>-përfiton formën analitike të shprehjeve kinematike nga kuptimi i sipërfaqeve nën grafikët, $s-t$, $v-t$ dhe $a-t$.</p> <p>-shpjegon parimin e relativitetit në mekanikë dhe ligjin klasik të mbledhjes së shpejtësive.</p> <p>-zgjidhë detyra problemore për lëvizje të thjeshta dhe lëvizje të përbëra.</p>
<p>3.Ligji i parë dhe ligji i dytë i Njutonit</p>	<p>III dhe I</p> <p>-përshkruan bashkëveprimet themelore në natyrë me theks të veçantë për bashkëveprimin gravitacional, elektrik dhe magnetik.</p> <p>-vlerëson masën, vëllimin dhe densitetin e trupit si veti karakteristike të përcaktimit të tij.</p> <p>-shqyrton eksperimentet virtuale të Galileit që shpiejnë deri te zbulimi i ligjit të parë të Njutonit.</p> <p>-demonstron ekperimentalisht shembuj për verifikimin e ligjit të parë të Njutonit.</p> <p>-demonstron eksperimentalisht shembuj për verifikimin e ligjit të dytë të Njutonit.</p> <p>-prezanton forcën me ndihmën e nxitimit apo sasisë së lëvizjes dhe analizon grafet $a(F)$ dhe $a(1/m)$.</p> <p>-dallon peshën e trupit në lëvizje të nxituar, nga pesha e trupit në qetësi relative, apo në lëvizje të njëtrajtshme drejtvizore dhe e analizon me shembuj.</p> <p>-dallon sistemet inerciale dhe joinerciale të referimit, ligjin e dytë të Njutonit në këto sisteme dhe trajton shembuj për forca reale dhe inerciale në probleme konkrete.</p> <p>-shqyrton forcën centripetale si forcë jo të re dhe jo të veçantë dhe paraqet shembuj në lëmenj të fizikës ku rolin e saj e kryejnë forcat tjera.</p> <p>-analizon baraspeshimin e forcave në lavjerrës konik të vrojtuar nga dy sisteme të referimit, përcakton karakterisitikat tjera dhe njehson periodën e rrotullimit të</p>

	<p>Tokës që trupi në ekuator të qëndroj pezull.</p> <ul style="list-style-type: none"> -trajton analitikisht dhe grafikisht forcat elastike, tensionet normale dhe deformimet e trupave elastik. -demonstron eksperimentalisht matjen e konstantës së elasticitetit të sustës. -demonstron eksperimentalisht ligjin e Hukut për elasticitet. -analizon analitikisht dhe grafikisht forcën e fërkimit, ligjin e lëvizjes dhe përshkruan rezistencën e mjedisit. -zgjidhë detyra të ndërlidhura me zbatimin e ligjeve të Njutonit, forcat elastike dhe forcën e fërkimit.
<p>4.Ligji i tretë i Njutonit</p>	<p>III dhe I</p> <ul style="list-style-type: none"> -demonstron eksperimentalisht shembuj të baraspeshimit të forcave dhe analizon ligjin e tretë të Njutonit. -dallon forcat aktive nga forcat pasive dhe trajton baraspeshimion e tyre. -zbaton tri ligjet e Njutonit për analizën e lëvizjeve të thjeshta të trupit në rrafsh të pjerrët. -demonstron eksperimentalisht përcaktimin e koeficientit të fërkimit me ndihmën e rrafshit të pjerrët. -demonstron eksperimentalisht matjen e forcës së fërkimit në rrafsh horizontal, vartësinë e kësaj force nga vetitë e sipërfaqes takuese dhe pavarsinë nga madhësia e sipërfaqes së trupit. -demonstron eksperimentalisht mbledhjen e forcave dhe analizon shembuj të zbërthimit të tyre në komponente. -shpjegon modelin e sistemit të mbyllur fizik duke u bazuar në shembuj. -përfiton ligjin e ruajtjes së sasisë së lëvizjes nga ligjet e Njutonit dhe zbatimin në shembuj të ndryshëm. -shqyrton analitikisht goditjet ideale elastike dhe jo elastike të dy trupave. -përkufizon momentet në fizikë së bashku me formulat gjegjëse. -zbaton ligjin e ruajtjes së momentit të sasisë së lëvizjes në shembuj të ndryshëm. -vlerëson kontributin e Galileo Galileit dhe Isak Njutonit për zhvillimin e shkencës. -zgjidhë detyra problemore për zbatimin e ligjit të dytë të Njutonit për lëvizje në një dhe dy përmasa.

	<p>5.Energjia dhe ligji i ruajtjes së saj.</p>	<p>IV</p> <ul style="list-style-type: none"> -shqyrton analitikisht dhe grafikisht lloje të punëve mekanike dhe tregon forcat përkatse që i krijojnë ato punë. -dallon trajta të ndryshme të energjise: mekanike, elektrike, të brendshme, kimike dhe biologjike. -shpjegon energjinë si madhësi konstante të një trupi a sistemi dhe lidhjen e punës me energji dhe fuqi. -analizon shndërrimin e energjisë dhe zbaton ligjin e ruajtjes në rastin kur nuk përfillen humbjet. -vlerëson rolin e energjisë në zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore. -demonstron eksperimentalisht ligjin për ruajtjen e energjisë me ndihmën e hudhjes horizontale. -zgjidhë detyra të ndërlidhura me zbatimin e punës, energjisë dhe fuqisë në jetën e përditshme.
	<p>6.Ligji i Njutonit për gravitet</p>	<p>III dhe I</p> <ul style="list-style-type: none"> -vlerëson përparësitë e heliocentrizmit ndaj gjeocentrizmit dhe kontributin e Kopernikut për shpjegimin e lëvizjes së dukshme të planeteve nëpër nyje dhe heliocentrizmin në përgjëthsi. -vlerëson zbulimin e ligjit të Njutonit për gravitet si forcë të bashkëveprimit në largësi, nën veprimin e së cilës planetet rrotullohen rreth Diellit nëpër orbita eliptike. -përkufizon ligjet e Keplerit dhe përfiton formën analitike të tyre duke zbatuar ligjet e njohura. -paraqet shembuj të zbatimit të ligjit të gravitetit për probleme konkrete. -shqyrton punën në fushë të gravitetit, qendrën e masës dhe përcakton masën e Hënës me ndihmën e bariqendrës. -demonstron eksperimentalisht përcaktimin e qendrës së masës së trupave dhe sipërfaqeve të formës së rregulltë. -zgjidhë detyra problemore për zbatimin e ligjit të gravitetit.
	<p>7.Struktura e lëndës dhe</p>	<p>II dhe IV</p> <ul style="list-style-type: none"> -përshkruan strukturën grimcore të lëndës dhe shpjegon bashkëveprimin ndërmolekularë. -interpretion difuzionin dhe lëvizjen e Braunit nga aspekti i ndërtimit grimcorë të lëndës. -trajton kuptimin e temperaturës me modelin molekularo-kinetik, matjen e saj, shkallët dhe lidhjet mes tyre.

	<p>gazet ideale.</p> <ul style="list-style-type: none"> -shqyrton zgjerimin termik linear, sipërfaqësorë dhe vëllimor të lëndës dhe lidhjet mes koeficientëve të zgjerimit. -shpjegon ndërrimin e dendësisë së lëndës në funksion të temperaturës. -përfiton ekuacionin themelor të teorisë molekulare kinetike (TMK) të gazeve ideale. -zbaton ekuacionin e TMK për përkufizimin analitik të temperaturës dhe për përfitimin e ekuacionit themelor të gazit ideal. -demonstron eksperimentalisht dhe analizon veçmas grafikisht çdo njerin prej izoproçeseve dhe përfiton formën analitike të tyre nga ekuacioni i gjendjes së gazit, përkatsisht nga ekuacioni i TMK. -trajton ligjin e Avogadros dhe ligjin e Daltonit për gaze ideale dhe korigjimet e Van der Vallsit për gaze reale. -zgjidhë detyra problemore për ndërtimin grimcorë të lëndës dhe ndërrimet e gjendjes së gazeve.
<p>8. Nxehtësia dhe format tjera të energjisë.</p>	<p>IV</p> <ul style="list-style-type: none"> -përkufizon konceptet, parametrat dhe madhësitë themelore fizike që përshkruajnë vetitë termike të lëndës. -zbaton modelin molekularo-kinetik të lëndës për shpjegimin e energjisë së brendshme, ndërrimet e saj dhe nxehtënë. -shpjegon sasinë e nxehtësisë dhe termokapacitetin e lëndës. -demonstron eksperimentalisht rregullën e Richmanit për dy apo më shumë sisteme termodinamike. -demostron eksperimentalisht rregullën e Richmanit për përcaktimin e termokapacitetit specifik. -tregon mënyrën e përkufizimit të temperaturës duke u bazuar në ligjin zero të termodinamikës. -shqyrton zbatimin e ligjit të parë të termodinamikës në gazet ideale dhe procese adiabatike. -analizon kryerjen e punës në funksion të mënyrës së ndërrimit të gjendjeve të gazit ideal. -analizon punën e gazit ideal në precesin rrethorë. -ilustron formulime të ndryshme të ligjit të dytë të termodinamikës. -interpretton ligjin e dytë të termodinamikës me ndihmën e entropisë dhe përkufizon ligjin e tretë të termodinamikës. -përshkruan ciklet termodinamike, makinat termike dhe

		rendimentin e tyre. -zgjidhë detyra problemore nga termodinamika dhe makinat termike.
	9. Ndërrimet e gjendjes agregate	II dhe IV -paraqet nocionin e kalimeve fazore të rendit të parë dhe rendit të dytë. -shpjegon vetitë e lëndës gjatë kalimeve nga një gjendje agregate në gjendje tjetër dhe sublimimin. -përshkruan dhe ilustron nxehtësinë latente gjatë ngurtësimit dhe lëngëzimit të lëndës. -shqyrton vetitë e metaleve të Woodit. -përshkruan vetitë e plazmës si gjendje e katërt agregate. -përshkruan dhe ilustron kuptimin e temperaturës kritike gjatë lëngëzimit. -shpjegon lagështinë e ajrit dhe mënyrën e përcaktimit të tij. -zgjidhë detyra problemore për ndërrimin e gjendjeve agregate.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- fizike, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa qasje metodologjike si më poshtë

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo drejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënit në lenden e fizikes janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.

Në lëndën e fizikës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave.

Metodat që mund të përdorin në lëndën e fizikës janë:

- vëzhgimin,
- modelimin,
- metodat eksperimentale dhe empirike,
- formimin e një ideje (hipotzes)
- përdorimin e TIK-ut.
- Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Metoda e vëzhgimit - Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi

Modelimi - nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

Metoda eksperimentale - Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të

ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike - Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Projektet - Projektet janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

TIK Teknologjia e informacionit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

Mesimdhënesi udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Udhëzime për ndërlidhjen me fusha tjera kurrikulare në funksion të mësimit të integruar

Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti meqë e studiojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera studimore, veçanërisht me gjuhët në funksion të ndërtimit të terminologjisë dhe komunikimit. Nxënësit nuk mund ta perceptojnë realitetin dhe të njohin botën që i rrethon vetëm nëpërmjet studimit të lëndëve që i përkasin fushës së shkencave natyrore.

Fusha e shkencave natyrore është e lidhur ngushtë me fushën e matematikës. Matematika u siguron nxënësve njohuritë e domosdoshme për studimin e lëndëve të kësaj fushe. Për shembull, kur nxënësi kryen një kërkim shkencor, i duhet shpesh të bëjë matje, llogaritje, të gjejë mesataren aritmetike, të zotërojë koncepte të gjeometrisë së zbatuar, si dhe të vizualizojë hapësirën. Nxënësi përdor aparatën matematik për të shpjeguar ligjet e fizikës dhe për të vendosur lidhjen ndërmjet ndryshoreve, si p.sh., në fizikë, lidhja ndërmjet forcës, masës dhe nxitimit. Interpretimi i ligjeve dhe i dukurive nëpërmjet përdorimit të grafikëve, të simboleve e të formulave matematikore vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës. Gjithashtu, duke studiuar shkencat e natyrës nxënësit zhvillojnë kompetencat matematikore të problemzgjdhjes, hetimit, arsytimit logjik, lidhjes konceptuale ndërmjet madhësive dhe modelimeve

Për të analizuar dhe për të vlerësuar rezultatet gjatë studimit të dukurive dhe të ligjeve në shkencat natyrore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt

gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i ndihmon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.

Nxënësi, duke lexuar, shkruar apo shprehur rrjedhshëm mendimet e tij rreth informacioneve shkencore mbi gjithësinë, lëndët, ndotësit e ajrit, ujit, zhvillon saktë kompetencën e komunikimit, që ndjeshëm zhvillohet në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Por edhe lëndët e shkencave të natyrës kontribuojnë në pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe i aftësojnë ata të paraqesin qartë dhe saktë idetë e tyre, me gojë ose me shkrim. Punët praktike dhe eksperimentale, të cilat janë bazë për zhvillimin e kompetencave të kësaj fushe, u japin nxënësve mundësitë që të zhvillojnë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojnë fjalorin terminologjik, përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe laboratorike dhe shpjegimeve të rezultateve të tyre. Termat e ndryshme që përdoren në fushën e shkencave të natyrës janë specifike për fushën dhe ndihmojnë nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit.

Studimi i shkencave lidhet me fushën e shkencave shoqërore, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historinë e zhvillimit të shkencës në periudha të caktuara historike të shoqërive të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike, ata mund të marrin përgjigje se si ka evoluar natyra dhe gjithësia. Nga ana tjetër, nxënësit vendosin dhe vlerësojnë lidhjen mes shkencave natyrore, teknologjisë dhe shoqërisë dhe përmirësojnë sjelljen për harmonizimin e marrëdhënieve të tyre me mjedisin dhe për ruajtjen e tij.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media - i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm

Për më shumë shih Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë- gjimnaze

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- vlerësimin të punës praktike dhe demonstruese.
- identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- vetëvlerësimin të nxënësve ;
- përmirësimin të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësve bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore -Fizike, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një qështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gadishmëri të llogaridhenies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësve dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju hspërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- fizike është e nevojshme të shfrytëzohen jet edhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtoria, natyra, etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Kimi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e kimisë për klasën e 10-të vazhdon me procesin e ndërtimit më të thellë të njohurive shkencore dhe zhvillimin e kompetencave (të kuptuarit, shprehitë, shkathtësitë, qëndrimet dhe

vlerat) në shkenca.

Shkenca çdo ditë është duke ndryshuar mënyrën tonë të jetës dhe rëndësia e saj është vitale për të ardhmen e botës.

Kimia nuk i studion vetëm komponimet të cilat gjenden në natyrë. Ajo krijon lëndë apo materiale të reja të cilat nuk ekzistojnë në natyrë. Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë të mësuarit duke vlerësuar idetë dhe teoritë që kanë ndikuar në arritjet shkencore deri më sot si: ndërtimi grimcor i materies dhe vetitë e saj, roli dhe pasojat e substancave të ndryshme në organizëm, burimet energjetike sot dhe në të ardhmen, mënyrën dhe koston e përfitimit të substancave, si dhe ndikimin e substancave të ndryshme në mjedis.

Ky është viti i fundit i mësimit formal të lëndës së kimit, prandaj krahas mësimit duhet të zhvillohen edhe aftësitë hulumtuese të nxënësve përmes punës praktike apo duke shfrytëzuar mjetet teknologjike.

Programi dhe metodologjia janë në funksion të arritjes së rezultateve të fushës shkencat e natyrës, si dhe arritjen/kontributin në rezultatet e të nxënësve për shkallë/kompetencë.

Qëllimi

- Zhvillimi dhe thellimi i mëtejshëm i njohurive në lëminë e kimit të përgjithshme, inorganike, organike dhe teknologjisë kimike.
- Të kuptuarit e kimit si shkencë natyrore dhe eksperimentale dhe rëndësia e saj për njeriun.
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit të informatave.
- Aktivizimi i sa më shumë shqisave (të pamurit, të prekurit, ndëgjimit, shijimit, nuhaturit) për nxënie të qëndrueshme të njohurive.
- Zhvillimi i të menduarit autonom dhe kritik për të kuptuar, shprehur dhe zbatuar fenomenet dhe dukuritë kimike që ndodhin në natyrë dhe në laboratorin kimik.
- Edukimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe komunitetit më të gjerë shkollor për ambientin.
- Vetëdijësimin për ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies në mjedisin ku jeton
- Zotërimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve shkencore;
- Zhvillimin e shkathtësive për të nxënë gjatë gjithë jetës;

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Nxënësit në klasën e dhjetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së pestë të kurrikulës (Shk 5) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti		
Materia, vetitë dhe shëndrrimet	RNF: <i>Analizon përbërjen, ndërtimin dhe vetitë e substancave, ndikimin e elementeve, komponimeve inorganike e organike në botën e gjallë dhe jo të gjallë në përmisimin e cilësisë së jetës</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Struktura e atomit dhe tabela periodike	<ul style="list-style-type: none"> • Përcakton numrin e protoneve, elektroneve dhe neutroneve në një atom, duke u bazuar në numrin atomik dhe numrin e masës. • Analizon konfiguracionin elektronik për 20 elementet e para të tabelës periodike. • Diskuton ngjashmëritë, dallimet dhe përdorimin e izotopeve të hidrogjenit. • Shpjegon efektet e kalimit të elektronit nga një nivel energjetik në tjetrin. • Analizon pozitën e elementeve në tabelën periodike bashkëkohore duke u bazuar në strukturën atomike të tyre.
Lidhjet kimike dhe vetitë e substancave	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon formimin e komponimeve jonike dhe atyre kovalente me shembuj të thjeshtë. • Krahason vetitë e elementeve me komponimet e fituara nga to. • Krahason vetitë e komponimeve kovalente me ato jonike. • Analizon vetitë dhe mënyrën e lidhjes tek jometalet të cilat gjenden në formë dyatomike në natyrë. • Shpjegon si formohen lidhjet shumfishe tek molekulat. • Shpjegon rolin e lidhjeve ndërmolekulare në vetitë e substancave (lidhja hidrogjenore). • Tregon rolin dhe përparësitë e aliazheve të formuara nga karboni, hekuri, alumini, bakri dhe kallaji nga metalet në gjendje elementare. • Krahason vetitë e metaleve nga jometalet. 	

	Uji dhe tretësirat ujore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan procesin e tretjes së substancave në ujë. ▪ Diskuton efektin e prezencës së substancave tjera në ujë për ndryshimin e pikës së vlimit dhe ngrirjes. ▪ Përgatitë tretësira me përqëndrim të caktuar (përqindje në masë). ▪ Analizon tretshmërinë e ndryshme të gazeve, lëngjeve dhe substancave të ngurta në ujë sipas vetive të tyre. ▪ Shpjegon çka është uji i fortë, shkaktarët dhe llojet e fortësisë. ▪ Përshkruan procesin e pastrimit të ujit për pije dhe ujërave hedhurinë. ▪ Klasifikon substancat në acide dhe baza sipas vetive të tyre. ▪ Tregon rolin dhe përdorimin e acideve dhe bazave në prodhimtari dhe organizëm. ▪ Përcakton aciditetin dhe bazitetin e një tretësire duke përdorë shkallën pH dhe indikatorët.
	Komponimet me bazë karbonin	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të lëndëve të djegshme fosile. • Krahason vetitë e polimerëve me ato të metaleve. • Vlerëson aspektin ekonomik dhe mjedisor të zëvendësimit të qelqit, letres dhe metaleve me polimerë.
Bota e gjallë	<i>RNF: Vlerëson ndikimin e barnave dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njerëzve, ndërlihdjen e shëndetit me sëmundjet, zvogëlimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme (duke përfshirë edhe sëmundjet e transmetueshme seksualisht).</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)
	Ushqimi, barërat dhe drogat	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson përdorimin e karbohidrateve, proteinave dhe lipideve në ushqyerje të shëndetshme. • Tregon rolin e vitaminës A, B, C, D dhe K në organizëm dhe pasojat e tyre në shëndet si mungesë e tyre.

		<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan metodat për mbrojtje të ushqimit nga bakteriet dhe oksigjeni. • Shpjegon qëllimin e përdorimit të: antibiotikëve, antipiretikëve, analgjetikëve dhe anestetikëve. • Diskuton përdorimin e etanolit dhe efektet e tij në organizëm. • Analizon veprimin e alkaloidëve në organizmin e njeriut.
Toka, mjedisi dhe gjithësia	RNF: <i>Analizon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, veçoritë e popullësisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndëkombëar</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Materialet e përdorshme nga shkëmbinjtë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon shkëmbinjtë nga mineralet. ▪ Numëron elementet kryesore të cilat e përbëjnë planetin Tokë. ▪ Emërton mineralet të cilat përmbajnë hekur, alumin, zink, plumb dhe bakër. ▪ Përshkruan metodat e ekstraktimit të metaleve nga xehet e tyre e në veçanti përfitimin e hekurit. ▪ Vlerëson ndikimin ekonomik dhe mjedisor të ndryshkjes së hekurit dhe çelikut. ▪ Shpjegon përparësitë e riciklimit të metaleve (hekurit dhe aluminit), plastikës dhe letrës. ▪ Përshkruan përbërjen e ajrit dhe strukturën e atmosferës. ▪ Shpjegon ciklin e dioksidit të karbonit dhe si është ndryshuar nga aktivitetet njerëzore ▪ Tregon si ndikon rritja e CO₂ në ngrohjen globale, cilat mund të jenë pasojat e gazeve serrë në të ardhmen. ▪ Analizon burimet dhe ndikimin e oksideve të sulfurit dhe azotit në mjedis.
Shkathësitë hulumtuese në shkenca	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorë teoritë shkencore për të zhvilluar hipoteza. • Planifikon dhe realizon eksperimente për të kryer observime, testuar hipoteza apo shpjeguar fenomene. 	

	<ul style="list-style-type: none"> • Zbaton ciklin e grumbullimit dhe analizimit të dhënave gjatë hulumtimit. • Vlerëson të dhënat e grumbulluara gjatë hulumtimit si nga saktësia ashtu edhe besueshmëria. • Prezanton të dhënat nga hulumtimi duke zgjedhur metodat dhe gjuhën adekuate shkencore. • Vlerëson rrezikun gjatë punës praktike me gaze, lëngje dhe substanca të ngurta. • Përdorë pajisjet mbrojtëse adekuate gjatë eksperimenteve të caktuara. • Përshkruan procedurat standarde gjatë rasteve emergjente në laborator. • Demonstron kujdes, shkathtësi dhe precizitet gjatë punës me mjete laboratorike. • Analizon rolin dhe mënyrën e funksionimit të aparaturave të fundit që përdoren për identifikim të substancave.
--	--

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e kimisë, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndën e kimisë varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur çasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, demonstrime, punë me projekte, punë praktike e të tjera. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe ti përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare.

Kimia është shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar

Integrimi i disa temave është i domosdoshën në shkencat e natyrë në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira. Fenomenet që ndodhin në natyrë nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve tëlëndëve të shkencave të natyrës por edhe fushave tjera, në mënyrë që tek nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Temat dhe konceptet nga lënda e kimisë që mund të integrohen me lëndë tjera: struktura e atomit, izotopet, forcat/lidhjet mes atomeve dhe molekulave, vetitë e materjes (me lëndën e fizikës), vetitë dhe rëndësia e ujit për Tokën dhe botën e gjallë (biologjia, gjeografia, fizika), ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (biologjia, gjeografia), ndikimi i ushqimit, barnave dhe drogave në shëndet (biologjia dhe fusha shoqëria dhe mjedisi), përdorimi i llojeve të ndryshme të materialeve sipas vetive të tyre (fizika, fusha jeta dhe puna) si dhe tema apo koncepte të tjera të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve për fushë apo për kompetenca. Paraqitja dhe analiza e rezultateve për këtë klasë kryesisht mund të realizohet përmes TIK-ut dhe llogaritjeve matematike ku integrimi me këto lëndë/fusha është i domosdoshëm.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlihet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media;**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

Edukimi për media -i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm- i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para

nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore -kimi, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkoj mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndalet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atllase etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Kimi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e kimisë për klasën e 10-të vazhdon me procesin e ndërtimit më të thellë të njohurive shkencore dhe zhvillimin e kompetencave (të kuptuarit, shprehitë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat) në shkenca.

Shkenca çdo ditë është duke ndryshuar mënyrën tonë të jetës dhe rëndësia e saj është vitale për të ardhmen e botës.

Kimia nuk i studion vetëm komponimet të cilat gjenden në natyrë. Ajo krijon lëndë apo materiale të reja të cilat nuk ekzistojnë në natyrë. Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë të mësuarit duke vlerësuar idetë dhe teoritë që kanë ndikuar në arritjet shkencore deri më sot si: ndërtimi grimcor i materies dhe vetitë e saj, roli dhe pasojat e substancave të ndryshme në organizëm, burimet energjetike sot dhe në të ardhmen, mënyrën dhe koston e përfitimit të substancave, si dhe ndikimin e substancave të ndryshme në mjedis.

Krahas mësimit duhet të zhvillohen edhe shkathtësitë hulumtuese të nxënësve përmes punës praktike apo duke shfrytëzuar mjetet teknologjike.

Programi dhe metodologjia janë në funksion të arritjes së rezultateve të fushës shkencat e natyrës, si dhe arritjen/kontributin në rezultatet e të nxënësve për shkallë/kompetencë.

Qëllimi

- Zhvillimi dhe thellimi i mëtejshëm i njohurive në lëminë e kimisë së përgjithshme, inorganike, organike dhe teknologjisë kimike.
- Të kuptuarit e kimisë si shkencë natyrore dhe eksperimentale dhe rëndësia e saj për njeriun.
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit të informatave.
- Aktivizimi i sa më shumë shqisave (të pamurit, të prekurit, ndëgjimit, shijimit, nuhaturit) për nxënie të qëndrueshme të njohurive.
- Zhvillimi i të menduarit autonom dhe kritik për të kuptuar, shprehur dhe zbatuar fenomenet dhe dukuritë kimike që ndodhin në natyrë dhe në laboratorin kimik.
- Edukimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe komunitetit më të gjerë shkollor për ambientin.
- Vetëdijësimin për ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies në mjedisin ku jeton.
- Zotërimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve shkencore;
- Zhvillimin e shkathtësive për të nxënë gjatë gjithë jetës;

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së pestë të kurrikulës (Shk 5) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Materia, vetitë dhe shëndrrimet	RNF: Analizon strukturën e atomit, të molekulës, të joneve, përbërjen, rëndësinë, vetitë fizike dhe kimike të elementeve, komponimet dhe reaksionet ndërmjet tyre si dhe demonstroi disa prej tyre	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Gjendja e materies	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e kimit dhe zbatimin e teknikave analitike si pjesë e saj. • Përshkruan strukturën e katër gjendjeve të materies. • Definon fazat dhe ndryshimet fazore bazuar në teorinë kinetike. • Përshkruan procesin e shkrirjes dhe ngrirjes bazuar në ekuilibrin dinamik. • Shpjegon procesin e avullimit dhe ndërlidhjen e saj me shtypjen. • Demonstroi procesin e difuzionit mes substancave në gjendje agregate të ndryshme. • Sugjeron metoda dhe teknika pastrimit e substancave në bazë të vetive të tyre fizike (distilim fraksional, ekstraktim, kristalizim dhe kromatografi).
Struktura e atomit dhe tabela periodike	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon teorinë e hershme dhe zhvillimin e teorisë moderne për atomin. • Përshkruan mënyrën e zbulimit të grimcave subatomike. • Përcakton numrin e protoneve, elektroneve dhe neutroneve në një atom, duke u bazuar në numrin atomik dhe numrin e masës. • Krahason vetitë e grimcave subatomike • Diskuton ngjashmëritë, dallimet dhe përdorimin e izotopeve të elementeve. 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon mënyrën e punës së spektrometrit të masës. • Definon katër numrat kuantik. • Definon orbitalet atomike dhe format e tyre. • E ndërlidh pozitën e një elementi në sistemin periodik duke u bazuar në numrin atomik dhe në konfiguracionin elektronik. • Shpjegon efektet e kalimit të elektronit nga një nivel energjetik në tjetrin. • Analizon pozitën e elementeve në tabelën periodike bashkëkohore duke u bazuar në konfiguracionin elektronik të tyre. • Analizon trendin e vetive të elementeve në grupe dhe perioda duke u bazuar në radiusin atomik, energjinë e jonizimit, afinitetin ndaj elektronit dhe elektronegativitetin.
	Stekiometria	<ul style="list-style-type: none"> • Shpreh raportin në mes të masës së substancës, sasisë dhe masës molare të saj. • Përshkruan dhe barazojnë reaksionet kimike • Zbaton praktikisht dhe përmes llogaritjeve ligjin mbi ruajtjen e masës dhe raporteve të caktuara të masës. • Gjen reaktivën në tepriçë dhe në mungesë në një reaksion kimik. • Llogaritë pjesëmarrjen në masë ose përqindje të elementeve në komponime prej formulave kimike si dhe ipërcakton ato prej pjesëmarrjes në masë duke e përdorë molinshprehë raportet molare të gazeve dhe përdorë ekuacionin e gjendjes së gazeve. • Llogaritë rendimentin e produkteve gjatë reaksioneve kimike.
	Lidhjet kimike	<ul style="list-style-type: none"> • Sqaron formimin e lidhjes jonike dhe asaj kovalente si dhe dallimet midis tyre duke u bazuar në elektronegativitet dhe energji të jonizimit. • Shpjegon teorinë valencore të lidhjeve dhe hibridizimin e orbitaleve atomike.

		<ul style="list-style-type: none"> • Dallon molekulat polare dhe ato jopolare në bazë të momentit dipolar. • Dallon strukturën e diamantit si kristal kovalent, grafitit, fulorenit, nanotubave të karbonit dhe grafenit, vetitë dhe zbatimin e tyre • Tregon për formimin e lidhjes kovalente koordinative. • Interpreton strukturën e lidhjes metalike, vetitë fizike tëmetaleve (përçueshmëria elektrike dhe e nxehtësisë, përpunimi, përdorimi). • Përshkruan llojet e forcave ndërmolekulare dhe formimin e lidhjes hidrogjenore. • Krahason vetitë fizike të komponimeve (kristaleve) jonike , kovalente, molekulare dhe metalike. • Vlerëson ndikimin e lidhjes hidrogjenore në vetitë fizike dhe kimike të komponimeve dhe rolin e saj për jetën e gjallë.
	<p>Termodinamika kimike</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan efektet energjetike gjatë ndryshimeve kimike e fizike. ▪ Shpjegon energjinë e aktivizimit, si energji të nevojshme që një reaksion të ndodhë; ▪ Vizaton skemën e një reaksioni ekzotermik dhe endotermik duke identifikuar energjinë e aktivizimit. ▪ Shpjegon konceptin e ndryshimit të entalpisë ▪ Zbaton Ligjin e Hess-it, gjatë ndryshimeve energjetike të reaksioneve kimike ▪ Shkruan dhe interpreton diagramet dhe ekuacionet termokimike. ▪ Përcakton ndryshimin e entalpisë nga të dhënat kalorimetrike. ▪ Shpjegon etapate formimit të komponimeve jonike dhe ndryshimet e entalpisë të përfshira në këtë processsipas

		<p>ciklit të Born-Haber-it(entalpia e atomizimit, jonizimit, afinitetit ndaj elektronit dhe entalpia e formimit të rrjetit kristalor).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njehson ndryshimet energjetike në një reaksionkimik duke u bazuar në energjinë e formimit dheprishjes/shkëputjes së lidhjes kimike. ▪ Llogaritë ndryshimet energjetike gjatë zbrërthimit të ushqimit dhe djegies së karburanteve.
	Kinetika e reaksioneve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan reaksionin kimik në nivel mikroskopik si goditje mes molekulave të reaktantëve. ▪ Sugjeron metoda praktike për përcaktimin e shpejtësisë së një reaksioni kimik. ▪ Interpretton dhe përcakton shpejtësinë e një reaksioni kimik,bazuar në diagrame dhe grafikë. ▪ Përshkruan faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e një reaksioni kimik: temperatura, përqendrimitdhe shtypja , si dhetë dimensioneve të grimcave të substancave. ▪ Përshkruan karakteristikat e katalizatorëve dhe inhibitorëve si dhendikimin e tyre në shpejtësinë e reaksionit kimik. ▪ Shpjegon veprimin katalitik bazuar në energjinë e aktivizimit. ▪ Shpjegon mënyrën e veprimit të enzimeve në organizëm.
	Ekulibri kimik	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason reaksionet e prapsueshme/kthyeshme dhe ato të paprapsueshme/pakthyeshme • Përshkruan arritjen e ekulibrit dinamik për një reaksion kimik • Interpretton ligjin e veprimit të masave aktive

		<ul style="list-style-type: none"> • Njehson konstantën e ekuilibrit duke u bazuar në përqendrimet e reaktantëve dhe produkteve në ekuilibër • Shpjegon zhvendosjen e ekuilibrit kimik sipas parimit të Le Chatelier-it • Tregon si ndikon përqendrimi, temperatura dhe shtypja në zhvendosje të ekuilibrit
	Tretesirat dhe koloidet	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon tretësirat sipas madhësisë së grimcave të tretura • Përshkruan nocionet:-emulsion dhe suspension • Bën gatitjen e tretësirave me përqendrime të ndryshme: pjesëmarrje mase, pjesëmarrje sasiore, pjesëmarrje vëllimore, përqendrim mase, përqendrim sasiore dhe me molalitet. • Dallon tretësirat elektrolite dhe jo elektrolite. • Interpretton vetitë koligative të tretësirave • Sqaron ngritjen e temperaturës së vlimit të tretësirave, uljen e temperaturës së ngrirjes dhe shtypjen osmotike • Përshkruan osmozën dhe efektin e saj në tretësira fiziologjike • Krahason presionin osmotik të elektrolitëve me jo elektrolit • Sqaron shprehjet micelë koloidale, dializë, koagulim dhe peptizim

Shkathtësitë hulumtuese në shkenca	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikon dhe realizon eksperimente për të kryer observime, testuar hipoteza apo shpjeguar fenomene • Përdorë pajisjet mbrojtëse adekuate gjatë eksperimenteve të caktuara • Demonstron kujdes, shkathtësi dhe precizitet gjatë punës me mjete laboratorike • Zbaton ciklin e grumbullimit dhe analizimit të dhënave gjatë hulumtimit • Vlerëson të dhënat e grumbulluara gjatë hulumtimit si nga saktësia ashtu edhe besueshmëria • Prezanton të dhënat nga hulumtimi duke zgjedhur metodat dhe gjuhën adekuate shkencore
---	--

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e kimisë, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njera me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndën e kimisë varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, demonstrime, punë me projekte, punë praktike e të tjera. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe ti përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare.

Kimia është shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar

Integrimi i disa temave është i domosdoshën në shkencat e natyrë në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira. Fenomenet që ndodhin në natyrë nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve tëlëndëve të shkencave të natyrës por edhe fushave tjera, në mënyrë që tek nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Temat dhe konceptet nga lënda e kimisë që mund të integrohen me lëndë tjera: struktura e atomit, izotopet, forcat/lidhjet mes atomeve dhe molekulave, vetitë e materjes (me lëndën e fizikës), vetitë dhe rëndësia e ujit për Tokën dhe botën e gjallë (biologjia, gjeografia, fizika), ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (biologjia, gjeografia), ndikimi i ushqimit, barnave dhe drogave në shëndet (biologjia dhe fusha shoqëria dhe mjedisi), përdorimi i llojeve të ndryshme të materialeve sipas vetive të tyre (fizika, fusha jeta dhe puna) si dhe tema apo koncepte të tjera të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve për fushë apo për kompetenca. Paraqitja dhe analiza e rezultateve për këtë klasë kryesisht mund të realizohet përmes TIK-ut dhe llogaritjeve matematike ku integrimi me këto lëndë/fusha është i domosdoshëm.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media;
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media- i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm- i referohet temave me rëndësi të përgjithshme, të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësi të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para

nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - kimi, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkoj mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndalet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atllase etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasen e 10-të është ndërtuar mbi bazën e nivelit të I-rë, shkalla 1 dhe 2, e integruar në kuadër të fushës: Njeriu dhe natyra (biologji, fizikë, kimi, gjeografi) dhe nivelit të II-të shkalla 3 dhe 4 si lëndë e veçantë në kuadër të fushës: Shoqëria dhe mjedisi (histori, gjeografi dhe edukatë qytetare), duke ruajtur lidhjet përmbajtësore me to.

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën 10-të rrjedh nga KK dhe KB e arsimit parauniversitar, rezultatet e të nxënit të kompetencave, rezultatet e të nxënit të fushës së Shkencave natyrore (RNF), shkalla V-të kurrikulare dhe planit mësimor të arsimit të mesëm të lartë-gjimnazit.

Lënda e Gjeografisë në klasën 10-të, ka në fokusin e saj të studimit mjedisin gjeografik me karakteristikat e tij fizike dhe humane, marrëdhëniet e ndërsjella midis shoqërisë dhe komponentëve fizik të Tokës, në kontekstin e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe terminologjinë gjeografike dhe njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillim të qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësitë midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Programi i gjeografisë në klasën 10-të u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes, diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si: ndryshimet klimatike, tërmetet, katastrofat natyrore, përmytjet, rrëshqitjet e dherave, erozioni i lumenjve, i plazheve etj.; konfliktet gjeopolitike të sotme, multikulturalizmi dhe globalizmi etj..

Lënda e gjeografisë për klasën e 10-të të gjimnazit trajton përmbajtjet lëndore, në përputhje me moshën e nxënësve. Zhvillimi i planit dhe programit mësimor të gjeografisë për kl.e 10-të ndërtohet mbi bazën e procedurës shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës si dhe parashtrimi i rezultateve të të nxënit për kompetenca, rezultateve të të nxënit të fushës së shkencave natyrore si dhe instrumentet e vlerësimi. Ai synon

që nxënësit të nxiten të eksplorojnë dhe të zhvillojnë dije, shkathtësi, shprehi, qëndrime dhe vlera.

Qëllimi

Programi gjeografisë për shkallën e 5, klasa 10 ka për qëllim që nxënësi:

- të përdorë konceptet bazë që lidhen me Tokën, mjedisin dhe hapësirën, dhe t'i zbatojë ato në situatat sociale, ekonomike, teknologjike dhe mjedisore;
- të zhvillojë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me kompleksitetin dhe dinamikën e proceseve dhe dukurive fiziko-gjeografike që ndodhin në Tokë, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë të kuptuarit për ligjet e përgjithshme të gjeosferave dhe të veprjës në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të aftësohet të zbulojë dhe argumentojë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore dhe humane të planetit tonë;
- të zhvillojë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të sistemeve të Tokës, si dhe të bëjë gjykime e zhvillojë qëndrime në lidhje me perspektivat mjedisore;
- të aftësohet përmes detyrave, punëve praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, në kërkimin gjeografik dhe të menduarit kritik e krijues;
- të aftësohet për përpunimin e të dhënave statistikore, ndërtimin dhe interpretimin e diagrameve, grafikëve, hartave etj., për të nxit zhvillimin e shkathtësive të përdorimit të matematikës;
- të aftësohet përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, globi, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj, të zbulon dhe përvetëson informacione dhe koncepte gjeografike për atmosferën, hidrosferën litosferën, biosferën dhe sociosferën;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik dhe të punës në grup;
- të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme;
- të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përmbajtja e lëndës së Gjeografisë është hartuar mbi bazën e koncepteve kryesore të fushës të shkencave natyrore në veçanti koncepti toka, mjedisi dhe gjithësia, temave, rezultateve në RNL duke i balansuar ato përmes RNF-ve në përputhje me qëllimet e përgjithshme të lëndës.

Rezultatet e njëjësive mësimore mbeten si mundësi e përzgjedhjes së mësimdhënsit duke respektuar autonominë e shkollës dhe të mësimdhënsit. Kjo u jep liri mësimdhënësve, të cilët duke u nisur nga kushtet konkrete (nxënësit, pajisjet etj.), mund të zgjedhin rezultatet specifike, por duke u bazuar në RNL dhe RNF për t'u përvetësuar sa mirë nga nxënësit këto rezultate. Programi lëndorë i Gjeografisë për gjimnazin, shkalla e 5, klasa 10 është strukturuar në 4 tema.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Toka, mjedisi dhe gjithësia	RNF: <i>Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, planeteve dhe trupave tjerë të këtij sistemi, formen, përmasat e Tokës dhe paraqitjen e sipërfaqes së Tokës në hartë dhe glob</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	1. Vendi dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon lëndën e studimit të gjeografisë, lidhjet e saja me shkencat tjera, konceptet bazë të kërkimit gjeografik bazuar në temat e saj: vendi/vendndodhja dhe hapësira, mjedisi, regjioni, bashkëveprimi/lidhja njeri-naturë dhe metodat shkencore që përdoren në kërkimet gjeografike; • Shpjegon formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; • Analizon veçoritë kryesore të Tokës e Sistemit diellor, të planeteve, asteroidëve, kometave, satelitve dhe Hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës; • Shpjegon provat dhe rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vetë; • Analizon provat dhe rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit; • Krahason mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan (elementet matematike të hartës në veçanti shkallën e hartës); • Diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografikë; • Analizon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike);

		<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartësinë absolute dhe relative; • Demonstron orientimin dhe lëvizjet në hartë dhe hapësirë, përmes anëve të horizontit, objekteve, pikës së vëqendrimit, vijave karakteristike, busollës, GPS.
<p>RNF: Analizon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikën e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, veçoritë e popullësisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar.</p>		
<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>	
<p>2. Sistemet fizike - Gjeosferat</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e brendshme të Tokës dhe marrëdhëniet shkak-pasojë të proceseve dhe dukurive në litosferë; • Përshkruan përbërjen kimike të korës së tokës dhe formimin e kontinenteve dhe oqeanëve si pasojë e lëvizjes së pllakave tektonike; • Shpjegon veçoritë shkëmbinjve (magmatik, sedimentar dhe metamorfik), kushtet e formimit të tyre dhe identifikon vetitë fizike të mineraleve dhe përdorimet e tyre; • Përshkruan ndarjen e kohës gjeologjike në era periudha dhe epoka, duke dhënë veçoritë kryesore të secilës prej tyre; • Diferencon moshën absolute dhe relative të shkëmbinjëve dhe mënyrat e përcaktimit të tyre; • Identifikon fuqitë e brendshme (endogjene), krimit e lëvizjet tektonike dhe format e relievit të krijuara me to; • Shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre; • Diferencon fuqitë e jashtme (ekzogjene), format e relievit të krijuara me to, shkaqet e tjetërsimit (alterimit) dhe kushtet në të cilat krijohet erozioni dhe format e denuacionit; • Shpjegon kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe 	

		<p>format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rëndësin e formave erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor); • Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit glacial, eolik dhe abraziv; <p>Shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon përbërjen e atmosferës dhe ndërtimin strukturor, duke dhënë karakteristikat më kryesore të shtresave të saj; • Shpjegon rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë dhe për jetën në të, ndryshimin e temperaturës në kohë (ditore e vjetore) dhe në hapësirë (vertikal e horizontal) dhe faktorët që ndikojnë në të; • Analizon ndryshimet e shtypjes atmosferike në kohë e në hapësirë dhe qarkullimin e përgjithshëm të erërave dhe formimin e tyre; • Shpjegon konceptet lagështi e ajrit, lagështi absolute e relative dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; • Shpjegon konceptet mot e klimë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; • Klasifikon zonat klimatike dhe tipat klimatik nga ekuatori në pole; • Shpjegon veçoritë kryesore të hidrosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, biosferën), qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetitë fizike e kimike të Detit botëror etj; • Analizon veçoritë e formave të levizjeve të ujrave të oqeanit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën); • Identifikon format kryesore të zhillushmërisë horizontale të bregdetit duke veçuar veçoritë kryesore të tyre; • Identifikon llojet e ujërave nëntokësore dhe mënyrën e formimit të tyre; • Përshkruan karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • Analizon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre; • Analizon kushtet e formimit të borës së përhershme dhe akullnajave;
--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën); • Analizon kushtet e krijimit të zonave bimore dhe llojet kryesore të këtyr bimëve;
<p>RNF: Analizon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, veçoritë e popullësisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar.</p>	
Tema	Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)
3. Sistemet humane	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon ndikimin e faktorëve fizik, mjedisorë, ekonomik dhe politik në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik); • Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë; • Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimëve; • Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksioniet dhe kriterit kryesor të tyre; • Analizon faktorët që ndikojnë në procesin e urbanizimit; • Përshkruan elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare; • Shpjegon veçoritë themelore ekonomike-gjeografike në botë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe veprimtarit ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor); • Përshkruan degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj; • Shpjegon procesin e industrizimit, rëndësinë e resurseve natyrore, faktorët që ndikojnë në zhvillimin industrisë dhe degët kryesore të saj; • Shpjegon veçoritë e komunikacionit (automobilistik, hekurudhor, ujqor, ajror), tregtisë dhe turizmi për zhvillimin e veprimtarive ekonomike;
<p>RNF: Analizon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, veçoritë e popullësisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel</p>	

<i>lokal, regional dhe ndëkombëtar.</i>	
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
4.Bashkëveprimi njeri/natyrë	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; • Analizon marrëdhënjen ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; • Propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore; • Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre;

Udhëzimet metodologjike

Për zbatimin praktik të programit mësimor të lëndës së Gjeografisë, nevojitet përzgjedhja e metodologjive adekuata duke i harmonizuar ato me rezultatet e kompetencave (RNK), rezultatet e fushës (RNF), rezultatet e të nxënit të lëndës për temat (RNL), të cilat janë pika referente për realizimin e përmbajtjeve të lëndës e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë një ndër pikat kyqe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është një e drejtë profesionale e mësimdhënësve.

Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, teorik edhe aplikativ të tregohet kujdesi i veçantë. Metodologjia duhet të përzgjidhet paraprakisht në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia është mirë të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, në radhë të parë të atyre që duhen për t'u zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

Metodat didaktike është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësim, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndorë si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësimdhënësit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shkencat natyrore”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënit;

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarime, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë në mësimin e gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të gjeografisë i udhëheq nxënësit në mënyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, duke unisur prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja

Udhëzime për ndërlidhjen e fushave dhe lëndëve mësimore në funksion të mësimdhënies së integruar

Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti meqë e studjojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera sudimore.

Në Shkencën e Gjeografisë si për njohuritë teorike, ashtu dhe për njohuritë empirike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sistemesh njohurish, sikundër janë njohuritë gjeomorfologjike, klimatologjike, hidrografike, biogjeografike etj.

Mësimdhënësit e kësaj lënde duhet të kenë në qendër të vëmendjes lidhjet integrale brenda fushës së shkencave natyrore. Shkenca e Gjeografisë, fizika, kimia dhe biologjia, si lëndë të së njëjtës fushë studimi, kanë mundësi të shumta integrimi midis tyre.

Zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësishtme për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planetëve në orbitën rreth Diellit, apo njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare etj., janë objekte integrimi ndërmjet Shkencës së Gjeografisë dhe fizikës. Po ashtu, zbatimi i periodës së gjysmë-zbërthimit dhe metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., është objekt integrimi ndërmjet shkencës së gjeografisë dhe kimisë. Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, biodiversiteti etj është objekt integrimi ndërmjet shkencës së gjeografisë me biologjisë.

Integrimi me fushat e tjera kurrikulare

• Komunikimi dhe të shprehurit

Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimit të fjalorit terminologjik. Përdor njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e esëve, gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve mediatike, të shkruarin, të lexuarin dhe komunikimin e informacioneve. Aftësitë e analizave kritike dhe logjike dhe të menduarit pasqyruar (reflektues) rreth ideve shkencore mbështeten në përdorimin e gjuhës teknike të Gjeografisë. *Shembull: Nxënësit përgatisin një ese argumentuese mbi pasojat globale të shkrirjes së akullnajav.*

• Matematika

Nxënësi zhvillon kompetencën matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogaritë mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogaritë kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj. *Shembull: Nxënësit llogarisin kohën vendore e zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike.*

• Shoqëria dhe mjedisi

Lidhja e gjeografisë me shoqërinë e mjedisin i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

• Jeta dhe puna

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështetë të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësit mund të përdorin word-processor (përpunuesin e fjalës) në shkrimin e materialeve dhe punëve praktike, zbatojnë hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikut (p.sh., ecuria vjetore e temperaturës së ajrit), përdorin powerpoint për prezantimin e një raporti, materiali informues, projekti kërkimor përmes paraqitjes në sllajde (p.sh., raport mbi ndotjen e ujit në rrethin tuaj) apo kërkojnë në internet (*të dhëna p.sh., për ndotjen e ajrit në një vend*), *informacion (p.sh., tornadot dhe pasojat)*, *harta (topografike, sinoptike, të shpërndarjes së tërmeteve, vullkaneve), imazhe satelitore.*

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media;**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

Edukimi për media

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshinë përmbajtjet lidhur me publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Për më shumë për çështjet ndërkurrikulare shih Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-gjimnaze.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve, etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - gjeografi, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktiviteti profesional, aktiviteti i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në fushën “Shkencat natyrore” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj; Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;

Ndërsa mësimdhënsi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënësve. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, etj.. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për gjeografinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- Përdorimi i simulimeve software.
- Përdorimi i grafikëve software.
- Paraqitja grafike e të dhënave

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën e 10-të është ndërtuar mbi bazën e nivelit të I-rë,

shkalla 1 dhe 2, e integruar në kuadër të fushës: Njeriu dhe natyra (biologji, fizikë, kimi, gjeografi) dhe nivelit të II-të shkalla 3 dhe 4 si lëndë e veçantë në kuadër të fushës: Shoqëria dhe mjedisi (histori, gjeografi dhe edukatë qytetare), duke ruajtur lidhjet përmbajtësore me to.

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën 10-të rrjedh nga KK dhe KB-të e arsimit parauniversitar, rezultatet e të nxënit të kompetencave, rezultatet e të nxënit të fushës së Shkencave natyrore (RNF), shkalla V-të kurrikulare dhe planit mësimor të arsimit të mesëm të lartë-gjimnazit.

Lënda e Gjeografisë në klasën 10-të, ka në fokusin e saj të studimit mjedisin gjeografik me karakteristikat e tij fizike dhe humane, marrëdhëniet e ndërsjella midis shoqërisë dhe komponentëve fizikë të Tokës, në kontekstin e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe terminologjinë gjeografike dhe njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna në teren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësitë midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Programi i gjeografisë në klasën 10-të u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes, diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si: ndryshimet klimatike, tërmetet, katastrofat natyrore, përmytjet, rrëshqitjet e dherave, erozioni i lumenjve, i plazheve etj., konfliktet gjeopolitike të sotme, multikulturalizmi dhe globalizmi etj.

Lënda e gjeografisë për klasën e 10-të të gjimnazit trajton përmbajtjet lëndore, në përputhje me moshën e nxënësve. Zhvillimi i planit dhe programit mësimor të gjeografisë për kl.e 10-të ndërtohet mbi bazën e procedurës shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës si dhe parashtrimi i rezultateve të të nxënit për kompetenca, rezultateve të të nxënit të fushës së shkencave natyrore si dhe instrumentet e vlerësimit. Ai synon që nxënësit të nxiten të eksplorojnë dhe të zhvillojnë dije, shkathtësi, shprehi, qëndrime dhe vlera.

Qëllimi

Programi gjeografisë për shkallën e 5, klasa 10 ka për qëllim që nxënësi:

- të përdorë konceptet bazë që lidhen me Tokën, mjedisin dhe hapësirën, dhe t'i zbatojë ato në situatat sociale, ekonomike, teknologjike dhe mjedisore;
- të zhvillojë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me kompleksitetin dhe dinamikën e proceseve dhe dukurive fiziko-gjeografike që ndodhin në Tokë, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë të kuptuarit për ligjet e përgjithshme të gjeosferave dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të aftësohet të zbulojë dhe argumentoj lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore dhe humane të planetit tonë;
- të zhvillojë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të sistemeve të Tokës, si dhe të bëjë gjykime e zhvillojë qëndrime në lidhje me perspektivat mjedisore;
- të aftësohet përmes detyrave, punëve praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, në kërkimin gjeografik dhe të menduarit kritik e krijues;
- të aftësohet për përpunimin e të dhënave statistikore, ndërtimin dhe interpretimin e diagrameve, grafikëve, hartave etj., për të nxit zhvillimin e shkathtësive të përdorimit të matematikës;
- të aftësohet përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, globi, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj, të zbulon dhe përvetëson informacione dhe koncepte gjeografike për atmosferën, hidrosferën litosferën, biosferën dhe sociosferën;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik dhe të punës në grup;
- të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme;
- të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit

Temat dhe rezultatet e të nxënës

Përmbajtja e lëndës së Gjeografisë është hartuar mbi bazën e koncepteve kryesore të fushës të shkencave natyrore në veçanti koncepti Toka, mjedisi dhe gjithësia, temave, rezultateve në RNL duke i balansuar ato përmes RNF-ve në përputhje me qëllimet e përgjithshme të lëndës.

Rezultatet e njësive mësimore mbeten si mundësi e përzgjedhjes së mësimdhënësit duke respektuar autonominë e shkollës dhe të mësimdhësit. Kjo u jep liri mësimdhënësve, të cilët duke u nisur nga kushtet konkrete (nxënësit, pajisjet etj.), mund të zgjedhin rezultatet specifike, por duke u bazuar në RNL dhe RNF për t'u përvetësuar sa mirë nga nxënësit këto rezultate. Programi lëndorë i Gjeografisë për gjimnazin, shkalla e 5, klasa 10 është strukturuar në 4 tema.

Koncepti	RNF: 6.1. <i>Analizon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, planeteve dhe trupave tjerë të këtij sistemi, formën, përmasat e Tokës dhe paraqitjen e sipërfaqes së Tokës në glob dhe hartë.</i>	
Toka, mjedisi dhe gjithësia	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	2. Vendi dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> •Analizon lëndën e studimit të gjeografisë, lidhjet e saja me shkencat tjera, konceptet bazë të kërkimit gjeografik bazuar në temat e saj: vendi/vendndodhja dhe hapësira, mjedisi, regjioni, bashkëveprimi/lidhja njeri-natyrë dhe metodat shkencore që përdoren në kërkimet gjeografike; •Shpjegon formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; •Analizon veçoritë kryesore të Tokës e Sistemit diellor, të planeteve, asteroidëve, kometave, satelitve dhe Hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës; •Shpjegon provat dhe rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vetë; •Analizon provat dhe rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth rreth Diellit; •Krahason mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan (elementet matematike të hartës në veçanti shkallën e hartës); •Diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografik; •Analizon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike); •Shpjegon përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartësinë absolute dhe relative; •Demonstron orjentimin dhe lëvizjet në hartë dhe hapësirë, përmes anëve të horizontit, objekteve, pikës së vendqëndrimit, vijave karakteristike, busollës,GPS.
	RNF: 6.2. <i>Shpjegon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, marrëdhëniet ndërvepruese ndërmjet komponentëve të gjeosferave, bashkëveprimin njeri/natyrë dhe veçoritë e popullsisë, vendbanimeve e veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regional dhe ndërkombëtar</i>	
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	

	<p>2. Sistemet fizike -Gjeosferat</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Analizon përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e brendshme e Tokës dhe marrëdhëniet shkak-pasojë të proceseve dhe dukurive në litosferë; •Përshkruan përbërjen kimike të korës së tokës dhe formimin e kontinenteve dhe oqeanëve si pasojë e lëvizjes së pllakave tektonike; •Shpjegon veçoritë shkëmbinjve (magmatik, sedimentar dhe metamorfik), kushtet e formimit të tyre dhe identifikon vetitë fizike të mineraleve dhe përdorimet e tyre; •Përshkruan ndarjen e kohës gjeologjike në era periudha dhe epoka, duke dhënë veçoritë kryesore të secilës prej tyre; • Diferencon moshën absolute dhe relative të shkëmbinjëve dhe mënyrat e përcaktimit të tyre; •Identifikon fuqitë e brendshme (endogjene), krimin e lëvizjet tektonike dhe format e relivit të krijuara me to; • Shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre; •Diferencon fuqitë e jashtme (ekzogjene), format e relivit të krijuara me to, shkaqet e tjetërsimit (alterimit) dhe kushtet në të cilat krijohet erozioni dhe format e denuacionit; •Shpjegon kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike; • Shpjegon rëndësinë e formave erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor); • Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit glacial, eolik dhe abraziv; • Shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë; • Analizon përbërjen e atmosferës dhe ndërtimin strukturor, duke dhënë karakteristikat më kryesore të shtresave të saj; •Shpjegon rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë dhe për jetën në të, ndryshimin e temperaturës në kohë (ditore e vjetore) dhe në hapësirë (vertikal e horizontal) dhe faktorët që ndikojnë në të; •Analizon ndryshimet e shtypjes atmosferike në kohë e në hapësirë dhe qarkullimin e përgjithshëm të erërave dhe formimin e tyre; •Shpjegon konceptet lagështi e ajrit, lagështi absolute e
--	---	---

		<p>relative dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon konceptet mot e klimë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; • Klasifikon zonat klimatike dhe tipat klimatik nga ekuatori në pole; • Shpjegon veçoritë kryesore të hidrosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, biosferën), qarkullimin e ujit nënatyrë dhe vetit fizike e kimike të Detit botëror etj; • Analizon veçoritë e formave të levizjeve të ujrave të oqeanit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën); • Identifikon format kryesore të zhvillshmërisë horizontale të bregdetit duke veçuar veçoritë kryesore të tyre; • Identifikon llojet e ujërave nëntokësore dhe mënyrën e formimit të tyre; • Përshkruan karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • Analizon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre; • Analizon kushtet e formimit të borës së përherëshme dhe akullnajave; • Shpjegon veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën); • Analizon kushtet e krijimit të zonave bimore dhe llojet kryesore të këtyre bimëve;
<p>RNF: 6.2. <i>Shpjegon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, marrëdhëniet ndërvepruese ndërmjet komponentëve të gjeosferave, bashkëveprimin njeri/natyrë dhe veçoritë e popullsisë, vendbanimeve e veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar.</i></p>		
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>

	3. Sistemet humane	<ul style="list-style-type: none"> •Analizon ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik); •Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë; •Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve; •Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksioniet dhe kriterit kryesore të tyre; •Analizon faktorët që ndikojn në procesin e urbanizimit; •Përshkruan elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare; •Shpjegon veçoritë themelore ekonomike-gjeografike në botë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe veprimtarit ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor); •Përshkruan degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj; •Shpjegon procesin e industrializimit, rëndësinë e resurseve natyrore, faktorët që ndikojnë në zhvillimin industrisë dhe degët kryesore të saj; •Shpjegon veçorit e komunikacionit (automobilistik, hekurudhor, ujqor, ajror), tregtisë dhe turizmi për zhvillimin e veprimtarive ekonomike;
<p>RNF: 6.2. <i>Shpjegon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, marrëdhëniet ndërvepruese ndërmjet komponentëve të gjeosferave, bashkëveprimin njeri/natyrë dhe veçoritë e popullsisë, vendbanimeve e veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regional dhe ndërkombëtar</i></p>		
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	4. Bashkëveprimi njeri/natyrë	<ul style="list-style-type: none"> •Analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; •Analizon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; • Propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore; • Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve

		natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre;
--	--	--

Udhëzimet metodologjike

Për zbatimin praktik të programit mësimor të lëndës së Gjeografisë, nevojitet përzgjedhja e metodologjive adekuate duke i harmonizuar ato me rezultatet kompetencave (RNK), rezultatet e fushës (RNF), rezultatet e të nxënit të lëndës për temat (RNL), të cilat janë pika referente për realizimin e përmbajtjeve të lëndës e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë një ndër pikat kyqe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është një e drejtë profesionale e mësimdhënësve.

Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, teorik edhe aplikativ të tregohet kujdesi i veçantë. Metodologjia duhet të përzgjidhet paraprakisht në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia është mirë të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, në radhë të parë të atyre që duhen për t'u zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

Metodat didaktike është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimin, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndorë si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

. Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësimdhënësit e kësaj lënde:

- të marrin parasyshtë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;

- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shkencat natyrore”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxëniet;
 - Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxenie cilësore, sygjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:
 - Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
 - Mësimdhënie jo e drejtëdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
 - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
 - Diskutimi dhe të nxëniet në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
 - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
 - Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
 - Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
 - Të mësuarit dhe të nxëniet përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
 - Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
 - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë në mësimin e gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të gjeografisë i udhëheq nxënësit në mnyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, duke u nisur prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmjia

Udhëzime për ndërlidhjen e fushave dhe lëndëve mësimore në funksion të mësimdhënies së integruar

Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti meqë e studjojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera sudimore.

Në Shkencën e Gjeografisë si për njohuritë teorike, ashtu dhe për njohuritë empirike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sistemesh njohurishë, sikundër janë njohuritë gjeomorfologjike, klimatologjike, hidrografike, biogjeografike etj.

Mësimdhënësi e kësaj lënde duhet të kenë në qendër të vëmendjes lidhjet integruese brenda fushës së shkencave natyrore. Shkenca e gjeografisë, fizika, kimia dhe biologjia, si lëndë të së njëjtës fushë studimi, kanë mundësi të shumta integrimi midis tyre.

Zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësishe për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planetëve në orbitën rreth Diellit, apo njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare etj., janë objekte integrimi ndërmjet Shkencës së Gjeografisë dhe fizikës. Po ashtu, zbatimi i periodës së gjysmë-zbërthimit dhe

metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., është objekt integrimi ndërmjet Shkencës së Gjeografisë dhe kimisë. Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, biodiversiteti etj., është objekt integrimi ndërmjet Shkencës së Gjeografisë me biologjisë.

Integrimi me fushat e tjera kurrikulare

• Komunikimi dhe të shprehurit

Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimit të fjalorit terminologjik. Përdor njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e eseve, gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve mediatike, të shkruarin, të lexuarin dhe komunikimin e informacioneve. Aftësitë e analizave kritike dhe logjike dhe të menduarit pasqyruës (reflektues) rreth ideve shkencore mbështeten në përdorimin e gjuhës teknike të Gjeografisë. *Shembull: Nxënësit përgatisin një ese argumentuese mbi pasojat globale të shkrirjes së akullnajav.*

• Matematika

Nxënësi zhvillon kompetencën matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj. *Shembull: Nxënësit llogarisin kohën vendore e zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike*

• Shoqëria dhe mjedisi

Lidhja e gjeografisë me Shoqërinë e mjedisin i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të tij

• Jeta dhe puna

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorin word-processor (përpunuesin e fjalës) në shkrimin e materialeve dhe punëve praktike, zbatojnë hedhjen e të dhënave në tabelë për

ndërtimin e grafikut (p.sh., ecuria vjetore e temperaturës së ajrit), përdorin powerpoint për prezantimin e një raporti, materiali informues, projekti kërkimor përmes paraqitjes në slide (p.sh., raport mbi ndotjen e ujit në rrethin tuaj) apo kërkojnë në internet (*të dhëna p.sh., për ndotjen e ajrit në një vend*), *informacion (p.sh., tornadot dhe pasojat)*, *harta (topografike, sinoptike, të shpërndarjes së tërmeteve, vullkaneve)*, *imazhe satelitore*

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media;**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

Edukimi për media

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshinë përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Për më shumë për çështjet ndërkurrikulare shih Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-gjinnaze.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - gjeografi, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktiviteti profesional, aktiviteti i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndalet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shkencat natyrore” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj; Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;

Ndërsa, mësimdhënsi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj.. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për gjeografinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- Përdorimi i simulimeve software.
- Përdorimi i grafikëve software.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Edukatë qytetare (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Histori (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Histori (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë qytetare (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e Edukatës qytetare për klasën e dhjetë i ofron nxënësit njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për një qytetari aktive, me synim që të bëhet i aftë për të kontribuar në përmirësimin e jetës në komunitet dhe shoqëri. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit t'i kuptojë më mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e veta, si dhe ato të grupeve dhe institucioneve shoqërore. Përmbajtjet mësimore të kësaj lënde ofrojnë njohuri për fenomenet dhe proceset sociale që lidhen me zhvillimin e popullsisë, shtetit, ligjit, qeverisjes, demokracisë, vendimmarrjes, qytetarisë, kulturës, mediave, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Këto tema janë me rëndësi bazike për krijimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive për një qytetar të përgjegjshëm i cili kupton raportin e tij me qytetarët tjerë, me institucionet dhe me shtetin.

Edukimi qytetar është i rëndësishëm për çdo individ, sepse përmes kësaj kuptohen natyra e marrëdhënieve shoqërore, zgjidhja paqësore e konflikteve, funksionimi i pushtetit dhe autoritetit, si dhe zhvillimi i demokracisë. Kjo lëndë i aftëson nxënësit të përdorin mirë mendjen e tyre për të jetuar dhe vepruar në një shoqëri komplekse dhe në ndryshim të përhershëm.

Nga ana tjetër, Edukata qytetare kontribuon që të nxënësi të zhvilloj njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të kuptuar drejt proceset shoqërore dhe politike, të cilat i sheh, analizon dhe gjykon dhe për të cilat vendos si të veprojnë. Kjo lëndë përgatitë nxënësin për t'u bërë qytetar aktiv duke ia zbuluar dimensionin qytetar, social dhe politik të jetës shoqërore.

Qëllimi

Programi i lëndës së edukatës qytetare për klasën e dhjetë, ka për qëllim zhvillimin e personalitetit të nxënësit në pikëpamje të kulturës qytetare, vlerave morale dhe sociale, me qëllim për ta bërë qytetar të përgjegjshëm. Kjo lëndë:

- krijon kushte që nxënësi të përfitojë njohuri të nevojshme për qytetarinë dhe aspektet e rëndësishme të saj, si: përgjegjësia, vendimmarrja, pjesëmarrja etj.
- mundëson krijimin e qëndrimeve dhe vlerave qytetare, si: toleranca, paqëja, komunikimi i hapur, respektimi i ligjit.
- mëson për strategjitë efektive të zgjidhjes paqësore të problemeve dhe për nevojën e pranimit kritik të informacionit.
- zhvillon aftësitë intelektuale dhe qytetare për të kuptuar dhe vlerësuar rolin e ligjit, institucioneve të drejtësisë, pushtetit, dhe demokracisë.
- zhvillon vetëdijen qytetare për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në zgjidhjen e problemeve të komunitetit dhe shoqërisë.
- krijon qytetarë të aftë dhe të përgjegjshëm për veprime dhe marrëdhënie të pavarura me qytetarë tjerë, me grupe dhe institucione të shoqërisë civile.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së pestë (Shk 5) të Kurrikulës Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to	
	<p>1. Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore gjatë periudhave të ndryshme historike.</p> <p>2. Krahason zhvillimet e grupeve shoqërore, institucioneve, strukturat dhe mënyrat e organizimit të tyre, dikur dhe tani.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Demokracia dhe qytetaria	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Interpreton disa aspekte të zhvillimit historik të demokracisë prej kohës së lindjes së saj e deri më sot. ▪ Analizon dhe kategorizon disa nga elementët bazike të demokracisë, si: zgjedhjet e lira, pluralizmi politik, pjesëmarrja dhe përfaqësimi, ndarja e pushtetit, të drejtat e njeriut dhe respektimi i ligjit. ▪ Vlerëson rëndësinë e komunitetit dhe vlerave të tij (solidariteti, diverziteti, gjithëpërfshirja) për qytetarinë aktive. 	
Proceset shoqërore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre	
	<p>1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
<i>Media, kultura dhe shoqëria</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Argumenton për rolin e mediave si mjet komunikimi dhe formimi të opinionit publik. ▪ Vlerëson mediet dhe ndikimin e tyre në vendimmarrjen 	

		<p>individuale.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon format e ndikimit të medieve te individët, grupet dhe proceset e shoqërore, si dhe mënyrën e se si lajmi i jep formë perceptimit tonë për realitetin. ▪ Analizon rolin e medias si mjet i ndikimit me anë të transmetimit të informatave, mesazheve dhe imazheve, si në nivelin lokal ashtu edhe atë global. ▪ Vlerëson rolin e mediave duke përfshirë edhe internetin në zhvillimin dhe shpërndarjen e vlerave artistike, kulturore dhe shkencore. ▪ Vlerëson rëndësinë e shfrytëzimit të drejtë dhe të sigurt të mediave elektronike për qëllime komunikimi dhe hulumtimi.
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet	
	<p>1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin, si: traditat, rregullat, besimet mitet, legjendat (arkitekturën autoktone), monumentet, veshjet, ushqimet etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.</p> <p>2. Analizon dhe vlerëson shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Ligji, drejtësia dhe përgjegjësia	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëshmon me shembuj argumentues funksionin e ligjit si rregullator i jetës sociale; ▪ Vlerëson procedurën e nxjerrjes së ligjeve dhe përgjegjësitë qytetare dhe institucionale për respektimin e tij. ▪ Vlerëson rolin e ligjit në përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore, parandalimin e dhunës dhe kriminalitetit, zgjidhjen e problemeve të pronës, trashëgimisë, konflikteve familjare dhe çështjeve tjera të kësaj natyre. ▪ Vlerëson rolin e organeve të drejtësisë për funksionimin e ligjit në shtetin demokratik dhe ofron parimet bazike për qasje në drejtësi nga qytetarët e Kosovës. 	

	Identiteti dhe diversiteti kulturor	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Argumenton rëndësinë e ruajtjes së identitetit dhe diversitetit kulturor duke pasë parasysh aspektin etnik, fetar, regional në Kosovë dhe më gjerë, si dhe nevojën për komunikim, mirëkuptim dhe respekt të ndërsjellë. ▪ Vlerëson rolin negativ të stereotipeve dhe paragjytimeve ndaj personave dhe grupeve me përkatësi tjetër kombëtare, racore, gjinore, sociale dhe vlerëson rëndësinë e çlirimit nga stereotipet dhe paragjykimet; ▪ Vlerëson zgjidhjen paqësore të konflikteve, duke dhënë shembuj të mirë nga jeta e komunitetit ku bashkëjetojnë grupe me përkatësi të ndryshme.
Vendimarrja dhe institucionet	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>1. Analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha të ndryshme historike.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Qeverisja, pushteti dhe autoriteti	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson demokracinë si formë të qeverisjes dhe dallimet mes pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; ▪ Analizon nivelet e pushtetit në Kosovë dhe dallimet ndërmjet e vendimarrjes në nivel lokal dhe qendror; ▪ Krahason dhe analizon rolin që luajnë institucionet e ndryshme në jetën e qytetarëve dhe zhvillimin e vendit; ▪ Vlerëson rolin e qytetarit dhe të partive politike për zhvillimin e demokracisë; ▪ Argumenton me shembuj faktit rolin e qeverisjes së mirë për mirëqenien qytetare;

	Vendimmarrja institucionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason karakteristikat e vendimmarrjes institucionale, e bazuar në procedurat ligjore dhe demokratike, nga ajo joinstitucionale, jodemokratike dhe autoritare. ▪ Vlerëson vendimmarrjen demokratike duke u bazuar në ligjshmëri, transparencë, konsultimet paraprake dhe harmonizimin e interesave mes palëve me interesa dhe pikëpamje të ndryshme. ▪ Vlerëson nevojën për vendimmarrje të drejtë dhe efikase nga ana e pushtetit dhe qeverisë, por edhe rolin e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këtë proces.
Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	<p align="center">RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>1. Bazuar në analizën paraprake, identifikon një problem konkret aktual të ndotjes në mjedisin e tij, planifikon punën, mbledh të dhëna, analizon dhe interpreton ato dhe vjen me një sërë zgjidhjesh të qëndrueshme.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Shkaqet sociale të çështjeve mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon ndikimin dhe ndërlidhjen e faktorëve social si: rritja e popullsisë, industrializimi dhe urbanizimi, si dhe vlerave dhe shprehive që lidhen me individualizmin, konsumatorizmin, militarizimin, me çështjet mjedisore si në nivelin lokal ashtu edhe global. ▪ Argumenton pasojat e veprimeve dhe sjelljeve të papërgjegjshme në raport me mjedisin për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi.
	Resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Reflektton për parandalimin e problemeve mjedisore dhe zgjidhje të qëndrueshme të atyre ekzistuese. ▪ Vlerëson rolin e resurseve natyrore për zhvillim dhe shfrytëzimin e tyre duke pasur parasyshë baraspeshën ndërmjet aspekteve sociale, ekonomike dhe mjedisore. ▪ Analizon parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kupton përgjegjësinë e gjeneratës së tashme për t'i lënë një mjedis të qëndrueshëm gjeneratave të ardhshme.

Udhëzime metodologjike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat për shkallë (RNK), rezultatet e të nxënit për fushën (RNF) dhe rezultatet e të nxënit për lëndë (RNL) paraqesin pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe metodologjive për këtë lëndën. Përmbajtjet dhe metodat për realizimin e tyre janë në harmoni me filozofinë dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës.

Në lëndën e Edukatës qytetare, sukcesi i nxënësve varet nga puna dhe angazhimi i mësimit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë metodash dhe teknikash, si: informacion i ri, detyra, aktivitete, punë me projekte, punë praktike e të tjera.

Edukata qytetare është lëndë, nëpërmjet të cilës zhvillohen kapacitetet e të rinjve për t'u përfshirë në vendimmarrjen shoqërore gjatë gjithë jetës së tyre, prandaj proceset shoqërore, aty ku është e mundur duhet të shpjegohen duke u shërbyer me aktivitete në bashkëpunim me nxënësit, ku arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, këshillohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, aktivitete praktike dhe shembuj);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues, të pavarur dhe zgjidhjen e problemeve;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur.

Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar

Në lëndët e fushës së Shoqërisë dhe mMjedisit, integrimi i disa temave është i domosdoshëm në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira. Të mësuarit e fenomeneve dhe dukurive që ndodhin në shoqëri nuk duhet të bëhet në mënyrë të ndarë ose të pjesshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimit dhe të nxënësve të lëndëve në kuadër të fushës Shoqëria dhe Mjedisit, por edhe fushave tjera, në mënyrë që tek nxënësit përmbajtjet mësimore të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra-tjetrën.

Temat mësimore që mësohen në lëndën e Edukatës qytetare integrohen edhe me lëndë tjera. Ta zëmë, temat si: demokracia, shteti, pushteti, qytetaria, kultura lidhen me historinë; temat mbi vendbanimet, mjedisin, popullsinë, resurset natyrore lidhen me gjeografinë; pastaj, temat si: vlerat personale dhe sociale, diversiteti dhe ndërvarësia, barazia dhe drejtësia lidhen me psikologjinë dhe sociologjinë. Gjithashtu, hulumtimet dhe paraqitjet e gjetjeve nga

mësimdhënësit dhe nxënësit për tema të ndryshme në këtë klasë mund të realizohen përmes TIK-ut, çka do të thotë që, përdorimi i TIK-ut është mjaft i rëndësishëm për arritjen e rezultateve siç janë paraparë me program.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare janë të ndërlidhura me rezultatet e fushës andaj duhet t'u kushtohet kujdes trajtimit adekuat të tyre edhe përmes lëndës së Edukatës qytetare. Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, rezultatet e lëndës, temat dhe njësitë mësimore se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet mësimdhënia e integruar dhe trajtim sa më i mirë i tyre. Në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë janë paraparë të trajtohen temat si në vijim:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Edukimi për qytetari demokratike – i referohet temave që kanë të bëjnë me qytetarinë dhe demokracinë. Të dy këto koncepte janë shumë të gjera, por janë të lidhura ngushtë ndërmjetveti. Të jesh qytetar i një vendi është të kesh përgjegjësi ndaj vendit dhe të kontribuosh me të gjitha mundësitë për zhvillim dhe mirëqenie. Këtë zhvillim e mundëson demokracia si sistem i qeverisjes, por ajo nuk ka të bëjë vetëm me shtetin ose pushtetin. Demokracia ka kuptim nëse reflektohet në jetën e përditshme të qytetarëve, në sigurinë, mirëqenien, lëvizjen e lirë, sundimin e ligjit, paqën dhe tolerancën.

Edukimi për paqe - iu mundëson nxënësve zhvillimin e aftësive për të menaxhuar konfliktet në mënyrë konstruktive, pastaj në mënyrë praktike të shmangin përshkallëzimet e mundshme në konfliktet ndërmjet tyre. Duke trajtuar këtë temë, gjithashtu gjejnë mënyra të cilat mundësojnë pajtimin e palëve në konflikt si dhe të kontribuojnë pozitivisht në planin personal, shoqëror dhe ndërkombëtar.

Globalizimi dhe ndërvarësia - përmban dy koncepte përbërëse; globalizimin dhe ndërvarësinë, të cilat në raport ndërmjet tyre gjatë shqyrtimit nga këndvështrime të shkencave apo lëndëve të ndryshme të nxënësi paraqesin një tërësi që kontribuon në dimensionin njohës të nxënësit. Procesi i të mësuarit duhet të shpalojë në të tria këto përmasa, të cilat, në mënyrë të ndërsjellë, mbështesin njëra-tjetrën: njohuritë, konceptet dhe të kuptuarit, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat. Në këtë mënyrë, procesi i të mësuarit do të lidhet dhe do t'i shërbejë formimit të kompetencave të nxënësit.

Edukimi për media - Është një temë që përfshin përmbajtjet lidhur me publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në kulturë, art, sport, shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Edukimi për media është një nga temat ndërkurrikulare që i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të medieve për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësisë të rinjëve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet, si: aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe

mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm. Angazhimi për një zhvillim të qëndrueshëm nënkupton edhe përgjegjësinë personale për të reaguar në mënyrë ligjore ndaj veprimeve të tjerëve që e rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmërinë ose performancën e nxënësve dhe reflektimit në mësimdhënie. Për të konstatuar nivelin e arritjes së rezultateve të planifikuara në planifikime duhet kërkuar prova dhe dëshmi në performancat e secilit nxënës. Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit si veprim i qëllimshëm, gjithëpërfshirës, i planifikuar, i vazhdueshëm, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve duhet të ndjek hapat si në vijim: së pari caktohet qëllimi i vlerësimit, pse (për çka) po vlerësojmë, p.sh. vlerësojmë për të planifikuar, vlerësojmë nivelin progresit të arritjes së kompetencave, vlerësojmë njohuritë akademike të nxënësve, vlerësojmë për të përmirësuar mësimdhënien, vlerësojmë përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënësve (stilet) etj dhe pastaj përcaktojmë metodologjinë, instrumentet, përpunimin e rezultateve dhe raportimin e tyre. Për realizuar vlerësim të sukseshëm, në mendje duhet të kemi pyetjet: pse, kujt, çka, si dhe kur?. Vlerësimi i nxënësve bëhet përmes metodave dhe instrumenteve të ndryshme, në varshëmëri të kërkesave të rezultateve të të nxënësve. Mësimdhënësi gjatë procesit të vlerësimit mund të përdor vëzhgimin, testimin, portfoliet, listën e kontrollit etj.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, në kuadër të lëndës së Edukatës qytetare, për realizimin e temave mësimore si dhe për mbërritjen e rezultateve të lëndës, përveç teksteve dhe burimeve shkollore mund të përdoren ilustrime, fotografi, dokumente, filma dokumentar e artistik, këngë, piktura, karikatura, diagrame dhe dëshmi të tjera. Po ashtu, mund të krijohet mjedis mësimor pritës e diskutues në të cilën mund të ftohen profesionist të lëmive të ndryshëm, qytetarë me përvoja jetësore të veçanta, përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile për të folur për aspekte të ndryshme të jetës personale, familjare, shoqërore dhe institucionale. Gjithashtu, mund të organizohen vizita në institucione të ndryshme në funksion të rezultateve të nxënies dhe temave mësimore.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Histori (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e Historisë si pjesë e fushës Shoqëria dhe Mjedisi, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësit. Përmes kësaj lënde nxënësi i klasës X (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore), do të thellojë njohuritë për zhvillimin e shoqërisë njerëzore që nga zanafilla e saj e deri tek periudha e Feudalizmit të Hershëm. Përmes kësaj lënde nxënësi do të fitojë njohuri për veprimtarinë e njeriut dhe shoqërisë njerëzore në të gjitha rrafshet, si atë ekonomik, shoqëror, shpirtëror, kulturor, politike, institucional etj., si dhe për

rolin e mjedisit natyror në këto zhvillime. Duke studiuar të kaluarën njerëzore në të gjitha dimensionet e saj, nxënësi do të kuptojë rolin e historisë si shkencë shoqërore, në vetëdijesimin e njeriut për vetveten, në kohë dhe hapësirë, si parakusht i rëndësishëm për të kuptuar më mirë të sotmen dhe për të pasur vizion të qartë për të ardhmen.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës së Historisë në këtë klasë, përveç thellimit të njohurive të përgjithshme historike është dhe zhvillimi i të menduarit kreativ dhe kritik si dhe të argumentuarit dhe gjykuarit logjik përmes analizës krahasuese të veprimtarisë njerëzore përgjatë këtyre periudhave historike, gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë diversitetin shoqëror dhe identitetet e përkatesitë e ndryshme individuale e grupe.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së pestë (Shk 5) në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Lartë

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore, dikur dhe sot, dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to.	
	<ol style="list-style-type: none"> Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike. Krahason zhvillimet e grupeve shoqërore, institucioneve, strukturat dhe mënyrat e organizimit të tyre, dikur dhe tani. 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Parahistoria – Fillet e njerëzimit, bashkësitë e para njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> Përkufizon veçoritë kryesore të shkencës së historisë, periudhat kryesore historike dhe mënyrat e llogaritjes së kohës. Diferencon fazat e evoluimit/zhvillimit të paraardhësve të qenies njerëzore-hominidëve, me argumente konkrete. 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Analizon karakteristikat kryesore të homo erectusit, neandertalit e homosapiensit, kohën e shfaqjes së tyre, karakteristikat e habitatit ku jetuan ata si si dhe arsyet dhe kahjet e lëvizjeve dhe emigrimeve të tyre. • Analizon rrethanat e krijimit të bashkësive të para njerëzore, përparësitë e jetës në grupe dhe format e vendbanimeve të tyre. • Vlerëson angazhimin kreativ dhe shpikjet e njerëzve në kohën e gurit dhe të metaleve. • Identifikon “profesionet” e para të njerëzve, dhe shpjegon rrethanat e ndarjes së punëve . • Identifikon dhe përshkruan ndarjen e roleve gjinore (matriarkati dhe patriarkati) dhe përshkruan marrëdhëniet shoqërore brenda tyre . • Identifikon kulturat parahistorike në Ballkan dhe analizon lokalitet e saj në Kosovë.
	<p>Personalitete të shquara të botës Antike dhe Mesjetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon personalitete historike të Lindjes së Lashtë dhe vlerëson kontributin në rrafshin e fushëveprimit të tyre në kontekstin e dhënë historik. • Identifikon dijetarët e shquar grekë në Antikë, analizon pikëpamjet e tyre filozofike dhe shkencore dhe vlerëson kontributin e tyre në trashëgiminë e mendimit njerëzor. • Identifikon personalitetet historike të Perandorisë Romake dhe vlerëson kontributin në rrafshin e fushëveprimit të tyre në kontekstin e dhënë historik. • Veçon personalitetet e shquara ilire, analizon

		<p>veprimtarinë e tyre në kontekstin e dhënë historik dhe vlerëson kontributin e tyre në shoqërinë ilire.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçon personalitetet e shquara arbërore, analizon veprimtarinë e tyre në kontekstin e dhënë historik dhe vlerëson kontributin e tyre në shoqërinë arbërore. • Analizon dhe vlerëson kontributin e personaliteteve të shquara të Perandorisë Romake të Lindjes –Bizantit. • Evidencon kontributin shkencor dhe kulturor të personaliteteve të shquara arabe.
Proceset shoqërore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre.	
	1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)

	<p>Qytetërimet e Lindjes së Lashtë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason karakteristikat kryesore të formacioneve të para shtetërore pran lumenjve të mëdhenj. • Analizon organizimin shoqëror-ekonomik në rendin skllavopronar në Lindjen e Lashtë. • Krahason të përbashkëtat dhe të veçantat e vendeve të Lindjes së Lashtë. • Identifikon llojet e shkrimeve dhe analizon veçoritë e zhvillimeve të shkencës, kulturës dhe besimit në Lindjen e Lashtë. • Krahason mënyrën e jetesës së përditshme në shoqëritë e Lindjes së Lashtë.
	<p>Qytetërimet e Mesdheut në Antikit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon popujt e lashtë të Gadishullit Ballkanik si dhe të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre në aspektin shoqëror dhe kulturor. • Përkufizon shtrirjen e grekeve të lashtë, fiset kryesore dhe dallon specifikat e organizimit shoqëror, kulturor, të besimit dhe shtetëror të qytet – shteteve greke. • Analizon shkaqet e ngulimeve të grekëve në Mesdhe dhe Iliri, dhe ndikimet e ndërsjella me autoktonët-indigjenët. • Identifikon disa nga shkaqet e luftërave greko-persiane. • Specifikon karakteristikat e shtetit maqedonas në kohën e Filipit II dhe Aleksandrit -Lekës së Madh. • Analizon rrethanat e themelimit të Romës si formacion shtetëror dhe dallon specifikat e organizimit shoqëror, kulturor, të besimit.

		<ul style="list-style-type: none"> • Analizon periudhat e ndryshme qeverisëse të Romës së Lashtë (periudhën monarkike, republikane, perandorake) dhe specifikat e tyre. • Analizon rrethanat shoqërore-politike të lindjes, përhapjes, legalizimit dhe zyrtarizimit të krishterimit në Perandorinë Romake. • Dallon veçoritë e kulturës romake dhe dallon të përbashkëtat dhe të veçantat e kulturave mesdhetare në Antikë.
	<p>Qytetërimi ilir</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon shtrirjen territoriale të fiseve ilire dhe “Ilirisë”, dhe evidencon qytetet kryesore dhe shtrirjen e Mbretërive Ilire. • Krahason organizimin shoqëror, ekonomik dhe politik të mbretërive ilire. • Krahason veçoritë e kulturës dhe besimit ilir me ato greke, romake dhe etnive tjera fqinje. • Analizon rolin e gruas ilire në jetën shoqërore dhe vlerëson angazhimin e Mbretëreshës Teutë. • Analizon ndryshimet në jetën shoqërore, kulturore, ekonomike dhe politike të ilirëve gjatë sundimit romak, si dhe shkallën e integrimit të tyre në shoqërinë romake. • Vlerëson rezistencën e ilirëve ndaj pushtimit dhe sundimit romak.
	<p>Arbërit në Mesjetë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon efektin e ndarjes së Perandorisë Romake (Vija e Teodosit) tek arbërit. • Përkufizon ndryshimet politike, administrative (Themata) dhe shoqërore në Perandorinë

		<p>Romake të Lindjes -Bizanti dhe pozitën e arbërve brenda saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon rrethanat e lindjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve feudale tek arbërit • Evidencon fazat e zhvillimit të Shtetit të Arbrit dhe krahason formacionet mesjetare shtetërore - pirincipatat tek arbërit. • Analizon karakteristikat e kulturës dhe qytetërimit arbëror nga Antika në Mesjetën e Hershme. • Përshkruan raportet shoqërore dhe mënyrën e jetës së përditshëm të arbërve.
	<p>Dyndjet e popujve – zhvillimi i qytetërimeve mesjetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Evidencon dyndjet e popujve dhe analizon pasojat e ngulitjeve të tyre në Evropë: në rrafshin kulturor, shoqëror dhe politik. • Përshkruan depërtimin e fiseve sllave në Evropën Juglindore dhe rrjedhojat e ngulitjes së tyre në këtë gadishull. • Identifikon formacionet e para shtetërore sllave në Ballkan dhe raportet në mes popujve ballkanas. • Përkufizon karakteristikat e marrëdhënieve shoqërore në Feudalizmin e Hershëm, shtresat shoqërore në feudalizëm dhe krahason rendin feudal me atë skllavopronar.
	<p>Evropa, Perandoria Romake e Lindjes - Bizanti, Arabët, Turqit selxhuk</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rolin dhe rëndësinë e shtetit Frëng nën udhëheqjen e Karlit të Madh . • Përkufizon shtrirjen territoriale të Bizantit, si dhe analizon zhvillimet shoqërore, politike, ekonomike e organizative.

		<ul style="list-style-type: none"> • Analizon rrethanat politike, shoqërore dhe ekonomike të formimit dhe forcimit të formacioneve shtetërore arabe. • Vlerëson rolin e botës kulturore-shkencore arabe në ringritjen dhe përhapjen e mendimit filozofik e shkencor të botës antike dhe ndikimin e saj në zhvillimin kulturor dhe shkencor evropian. • Veçon pozitën e popujve të Ballkanit gjatë kohës së pushtimeve të para turke-osmane, dhe përpjekjen e tyre për rezistencë. • Analizon arsyet e ndërmarrjes së kryqëzatave, rrjedhojat e tyre në shoqërinë evropiane të kohës dhe ndikimin e tyre në marrëdhënien e kulturave lindje – perëndim.
	Perandoritë e Mëdha të Lindjes	<ul style="list-style-type: none"> • Veçon aspektet kryesore të qytetimit kinez në këtë kohë dhe identifikon të arriturat kulturore e shkencoro-teknike të tij. • Shqyrton karakteristikat e Perandorisë Mongole, pushtimet e Xhingis Kanit dhe ndikimin e tyre në botën mesjetare.
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	<p>RNF: 3 . Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin njerëzor, si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone, monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global. 2. Analizon dhe vlerëson shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme. 	

	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Marrëdhëniet shoqërore në Antikë dhe Mesjetë	<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh disa nga nenet e Ligjit të Hamurabit, analizon ato dhe debaton rreth të drejtave dhe përgjegjësive në shoqëritë e lashta njerëzore. • Përshkruan qeverisjen romake në kohën e Republikës dhe shpjegon përse e Drejta Romake konsiderohet si paradigmë e së Drejtës së sotme. • Shquan veçoritë e Kodit të Justinianit dhe ndikimin e gjithëmbarshtëm të tij në Perandorinë Bizantine. • Identifikon veçoritë e “Të drejtës salike” (të shtetit frank në Mesjetën e Hershme), dhe ndikimin e saj në sistemet e ardhshme juridike të vendeve evropiane .
	Besimet dhe religjionet	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton format e para të besimit të njeriut. (animizmi, totemizmi, politeizmi). • Analizon kontekstin historik të lindjes dhe përhapjes së feve kryesore (Judaizmit Krishterimit, Budizmit, Hinduizmit, Islamit,) dhe krahason karakteristikat kryesore të tyre. • Përshkruan kontekstin historik të përhapjes së Krishterimit në Iliri, dallon disa nga qendrat e para kishtare ilire dhe shpjegon ndikimin e besimit të ri monoteist në shoqërinë ilire.
Vendimmarrja dhe institucionet	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>1. Analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimmarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëta, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha të ndryshme historike.</p>	

	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Institucioni i vendimmarrjes në shoqërinë antike dhe në shoqërinë mesjetare	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason veçoritë kryesore të vendimmarrjes në familje dhe shoqëri gjatë periudhës së antikitetit dhe Mesjetës së Hershme si dhe përshkruan marrëdhëniet brenda tyre. • Analizon funksionimin e demokracisë në Athinën e Lashtë. • Identifikon tiparet dalluese të organizimit shtetëror monarkist në Evropë.
Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF.5 Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm	
	1. Bazuar në analizën paraprake, identifikon një problem konkret aktual të ndotjes në mjedisin e tij, planifikon punën, mbledh të dhëna, analizon dhe interpreton ato dhe vjen me një sërë zgjidhjesh të qëndrueshme.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Qyteti dhe qytetaret, organizimi i hapësirës së banimit	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon hapësirat e para të vendbanimeve të njerëzve, analizon kushtet mjedisore dhe organizimin e tyre në të mirë të shoqërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. • Përshkruan veçoritë e qyteteve antike dhe mesjetare dhe bënë krahasimin e tyre në aspektin e planifikimit ambiental dhe nivelin e akomodimit të qytetarëve të tyre. • Shpjegon funksionimin e familjes, mënyrën e jetësësë dhe analizon veprimtaritë ekonomike, zejet. • Evidencon të arriturat kulmore arkitektonike në Antikë dhe Mesjetë dhe vlerëson rolin e tyre si trashëgimi kulturore dhe inxhinierike të njerëzimit.

Udhëzime metodologjike

Realizimi i programit lëndor kërkon përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie të suksesshme. Rekomandohet që mësimdhënësi të lexoj me kujtesë rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së historisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por edhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore.

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e Historisë, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u harmonizuar njera me tjetrën në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulës.

Suksesi i nxënësve në lëndën e Historisë është i ndërlidhur dhe varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, forma të shumëllojta të punës duke respektuar personalitetin dhe stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimin të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, punë individuale e grupore, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Duke pasur në konsideratë specifikat e lëndës, preferohet që aty ku është e mundur të përdoren: loja në përgjithësi dhe loja me role në veçanti, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializim; Intervista dhe rrëfimet (historia orale) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës gjë që zhvillon shkathtësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit; bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, si forma që mund të realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore, gjithmonë në bashkëpunim me nxënësve, ku mësimdhënësi duhet të ketë rol këshillues, orientues.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësve për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që i ndihmon atyre në kompletimin e thithjes së informacioneve dhe përgatitjes për angazhim të suksesshëm. Gjithashtu organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve. Ato mundësojnë që nxënësve të zhvillojnë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit.

Mësimdhënësi duhet të merr parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënësve të integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integruese, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomene që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëme,

prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve së historisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së Historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së Historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndër kurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Këto tema mund të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull kur trajtohen temat për qytetërimet, institucionin e vendimmarrjes ose demokracinë mund të ndërlidhen me edukimin për qytetari demokratike, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohen në konteste dhe periudha të ndryshme, si ka ndodhë evoluimi i tyre etj. E njëjta qasje vlen edhe në trajtimin e temave tjera si edukimi për paqe, që mund të ndërlidhet me përmbajtjet kur trajtohen diversiteti në shoqëri, toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa, dinjiteti njerëzor. Po ashtu edhe tema e globalizimit dhe ndërvarësisë mund të ndërlidhet fare mirë trajtimin e çështjeve ekonomike, arsimore në periudhat që trajtohen në këtë klasë. Tema e edukimit për media mund të shërbej në kontekstin e hulumtimit të nxënësve për përmbajtje të ndryshme duke siguruar material, fotografi, harta të ndryshme etj. Ndërsa çështja e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm mund të ndërlidhet me raportet dhe ndërvarësinë njeriut me mjedisin jetësor që në fillimet e shoqërisë njerëzore dhe nëpër etapat tjera historike që trajtohen në këtë klasë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek nxënësi. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektiv të vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësve në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të

testimit, si ai verbal, jo verbal, vlerësimi i nxënësit në punë grupore, i punës me projekte etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve, dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit pikë referimi janë rezultatet e lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre.

Qasja kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës dhe instrumenteve që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Që në këtë moshë është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësit.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojnë arritje sa më të larta.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Krahas teksteve mësimore bazë sugjerohet që gjatë procesit mësimor, nxënësit dhe mësimdhënësit të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive siç janë: fletoret e punës, materiale tjera alternative, broshurat, atlasat, hartat, enciklopeditë, softuerët arsimorë, vizitat e ndryshme njohëse, si, p.sh., monumentet shoqërore, kulturore dhe natyrore.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë gazetën, revistën, literaturën të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në krijimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Histori (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e Historisë, si pjesë e fushës Shoqëria dhe Mjedisi, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve. Përmes kësaj lënde nxënësit e klasës së X (gjimnazi i shkencave natyrore) do të thellojnë njohurit për zhvillimet shoqërore, ekonomike, kulturore, shkencore, politike etj., nga gjysma e dytë e shek. XIX (procesi i formimit të shteteve kombëtare) e deri në ditët e sotme, si dhe për rolin e personaliteteve të shquara në të gjitha fushëveprimet njerëzore dhe për institucionet dhe vendimmarrjen në rrethana të ndryshme të organizimit politik (pluralizmi, demokracia, format e ndryshme të diktaturave si fashizmi, nazizmi, komunizmi). Përveç kësaj, duke studiuar të kaluarën në të gjitha dimensionet e saj, nxënësit vlerësojnë rolin e shkencës së historisë në vetëdijesimin e njeriut për të kaluarën e tij, për të kuptuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës së historisë në këtë nivel, përveç thellimit të njohurive të përgjithshme për këtë periudhë historike është dhe zhvillimi i të menduarit kreativ dhe kritik si dhe të argumentuarit dhe gjykuarit logjik përmes analizës krahasuese të veprimtarisë njerëzore të asaj periudhe, gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, e shkathtësive, e vlerave dhe e qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, orientimit seksual etj.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së pestë (Shk 5) në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Lartë

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore, dikur dhe sot, dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to 1. Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara shoqërore, politike, kulturore e arsimore në nivel kombëtar e botëror, gjatë periudhave të ndryshme historike. 2. Krahason zhvillimet e grupeve shoqërore, institucioneve, strukturat dhe mënyrat e organizimit të tyre, dikur dhe tani.
	Tema Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)

	<p>Roli i personaliteteve të shquara të Historisë Moderne dhe Bashkëkohore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Hulumton mbi veprimtarinë e personaliteteve historike të periudhës Moderne dhe Bashkëkohore. - Analizon kontributin e personaliteteve të shquara në rrafshet e caktuara veprimtari (shoqëri, kulturë, shkencë) dhe krahason kontributin e tyre me atë të pararendësve në fushëveprimet e caktuara.
<p>Proceset shoqërore</p>	<p>RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre</p> <p>1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.</p>	
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>
	<p>Nacionalizmi - formimi i shteteve kombëtare</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan rolin e nacionalizmit në formimin e shteteve kombëtare në nivel rajonal, evropian dhe botëror. - Analizon arsyet e formimit të aleancave politike dhe ushtarake në nivel rajonal, evropian dhe botërore. - Argumenton rolin e fuqizimit ekonomik dhe ushtarak të Fuqive të Mëdha në rindarjen e kolonive (Afrikë, Azi) për shfrytëzimin e pasurive natyrore të vendeve të pushtuara dhe zgjerimin e tregut për mallrat e tyre. - Vlerëson luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar të vendeve të okupuara.
<p>Epoka e shpikjeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon rrethanat e zhvillimit të ideve liberale dhe ndikimin e tyre në shoqërinë e shekullit XIX. - Vlerëson arsyet e lindjes së Revolucionit Industrial në Angli dhe ndikimet e tij në shoqëri. - Identifikon shpikjet kryesore shkencore-teknike të kësaj periudhe. - Vlerëson ndikimin e të arriturave shkencore- 	

		<p>teknike dhe kulturore të shekullit XIX në jetën e përditshme të njeriut.</p>
	Lëvizja Kombëtare Shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton rëndësinë e ndikimit të kujtesës historike kolektive, traditës, gjuhës, kulturës, arsimit kombëtar si dhe iluminizmit evropian në kultivimin e identitetit kombëtar. - Shqyrton karakterin, qëllimin dhe mënyrën e zbatimit të reformave të pushtetit osman në Shqipëri dhe ndikimin e tyre në Lëvizjet Kombëtare Shqiptare. - Argumenton pozitën dhe trajtimin e shqiptarëve nga pushteti osman. - Identifikon subjektet politiko-ushtarake shqiptare bartëse të përpjekjeve për çlirim kombëtar. - Vlerëson synimet e Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për mëvetësi dhe kontributin e saj në çlirimin e Ballkanit nga Perandoria Osmane. - Argumenton dhe vlerëson rolin e rilindësve dhe veprimtarëve kombëtarë shqiptarë në emancipimin kombëtar dhe politik të shqiptarëve. - Analizon raportet shoqërore dhe mënyrën e jetës së përditshëm të shqiptarëve në periudhën e Rilindjes Kombëtare. - Kupton ndikimin e Krizës Lindore në dinamizmin e Lëvizjes Kombëtare dhe vlerëson përpjekjet e shqiptarëve për arritjen e synimeve politike dhe mbrojtjen e integritetit territorial.
Proceset shoqërore	Shqipëria, Kosova dhe viset tjera shqiptare në periudhën e kompozimit të ri politik të Ballkanit	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon kontekstin historik të Kuvendit të Vlorës dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. - Definon pozitën specifike të shqiptarëve në konfrontimin ballkanik 1912-1913.

	<p>1912-1914</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon rolin e faktorit të jashtëm (Fuqitë e Mëdha, shtetet ballkanike, Perandoria Osmane) në fazën e lindjes dhe ngritjes së shtetit shqiptar: vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për Shqipërinë (statusi, rregullimi i brendshëm, kufijtë) dhe implementimi i tyre. - Argumenton vështirësitë (pengesat) objektive të brendshme në hapat e parë të shtetit shqiptar. - Shqyrton shkaqet e krizës shtetërore në periudhën e sundimit të Princ Vidit. - Përshkruan procesin e pushtimit dhe aneksimit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga Mali i Zi dhe Serbia. - Hulumton pozitën e shqiptarëve në viset e pushtuara (Kosovë, Dibër, Malësi, Çamëri) nga shtetet fqinje Serbia, Mali i Zi dhe Greqia dhe politikat e tyre për spastrim etnik. - Arsyeton rezistencën e shqiptarëve kundër pushtimit, trajtimit eliminues nga shtetet fqinje dhe vendimeve të padrejta të faktorit ndërkombëtar.
	<p>Evropa Juglindore midis Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Definon pozitën e shteteve autonome në kuadër të Perandorisë Osmane dhe marrëdhëniet e tyre me pushtetin qendror osman. - Krahason synimet dhe politikat e Austro-Hungarisë dhe të Rosisë ndaj Ballkanit. - Analizon qëndrimin e fuqive evropiane ndaj Perandorisë Osmane dhe lëvizjeve kombëtare të popujve të Ballkanit. - Vlerëson përpjekjet e popujve të Ballkanit për

		çlirim kombëtar dhe shtet të pavarur (pavarësi).
Proceset shoqërore	Periudha e imperializmit, ndarja e sferave të interesit-kolonializmi	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon arsyet e zhvillimit e hovshëm industrial të Fuqive të Mëdha evropiane dhe synimet e tyre për koloni të reja. - Vlerëson Abolucionizmin si lëvizje e rëndësishme për të drejtat e njeriut. - Analizon rrjedhojat e bashkimit kombëtar (fuqizimit) të Gjermanisë dhe të Italisë në formimin e aleancave të reja në Evropë. - Evidencon përplasjet midis fuqive evropiane për sferat e interesit në Afrikë dhe Azi.
	Lufta e Parë Botërore, Sistemi i Versajës dhe zhbërja e tij.	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon faktorët e ndarjes së Evropës në dy blloqe dhe shkaqet e përshkallëzimit të krizës në marrëdhëniet midis tyre. - Identifikon frontet kryesore të Luftës së Parë Botërore si dhe humbjet njerëzore në këtë luftë. - Përshkruan karakterin e Konferencës së Paqes, të Sistemit të Versajës dhe rolin e Lidhjes së Kombeve. - Përkufizon rrethanat e lindjes dhe fuqizimit të ideologjive dhe kapjes së shteteve nga to (BRSS, Itali fashiste, Gjermani naziste, Japoni militariste) si dhe krahason specifikat mes tyre. - Evidencon faktorët që ndikuan në zhbërjen e Sistemit të Versajës dhe përpjekjet e demokracive perëndimore për ruajtjen e status-quo. - Vlerëson zhvillimet në rrafshin shoqëror, kulturor, artistik dhe shkencor gjatë viteve 1919-1939. - Analizon aspekte të jetës së përditshme të qytetarëve dhe ushtarëve gjatë Luftës së Parë Botërore dhe vlerëson ndikimin e saj në jetën e tyre.

<p>Proceset shoqërore</p>	<p>Shqipëria dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon pozitën e Shqipërisë Neutrale dhe shqiptarëve jashtë saj në fillim të Luftën e Parë Botërore (1914-1915). - Identifikon zonat pushtuese në Shqipëri dhe në Kosovë, kohëzgjatjen e tyre dhe politikat e zbatuara nga regjimet pushtuese (organizimi administrativ, arsimit, ekonomia etj.). - Analizon angazhimin politik të shqiptarëve gjatë luftës dhe në fund të saj. - Evidencon prezencën e huaj në Shqipëri pas Luftës së Parë Botërore 1918-1920.
	<p>Shqiptarët (Shqipëria, Kosova, viset tjera) ndërmjet dy Luftërave Botërore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon trajtimin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Parisë dhe pozitën ndërkombëtare të saj 1919-1921. - Analizon sfidat e brendshme për konsolidim politik, ekonomik dhe shtetëror të Shqipërisë (1920-1924). - Identifikon zhvillimet kryesore në rrafshin politik, ekonomik, shoqëror, arsimor dhe kulturor gjatë periudhës së Republikës (1925-1928) dhe të Monarkisë (1928-1939). - Vlerëson zhvillimet dhe të arriturat modernizuese të shoqërisë shqiptare. - Analizon orientimet dhe veprimet politike të emigracionit politik shqiptar 1925-1939. - Argumenton pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë SKS-Jugosllavi: programet, format dhe metodat e shtypjes dhe përndjekjes në funksion të pastrimit etnik. - Përkufizon format e rezistencës si dhe organizimin dhe veprimin politik të shqiptarëve për realizimin e të drejtave qytetare dhe kombëtare të tyre.

	<p>Lufta e Dytë Botërore, ndarja në blloqe dhe Lufta e Ftohtë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, frontet kryesore të luftës, operacionet përfundimtare të Koalicionit antifashist dhe përmasat e tragjedisë njerëzore në nivel botëror. - Analizon aspekte të jetës së përditshme të qytetarëve dhe ushtarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe vlerëson ndikimin e saj në jetën e tyre. - Përkufizon konceptet kryesore të Holokaustit dhe evidenton pasojat e tij. - Evidencon dhe vlerëson rolin e shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjëve gjatë Holokaustit. (Fisnikët/të nderuarit mes popujve/kombeve). - Vlerëson përpjekjet për dënimin e krimeve të luftës, akterëve të saj (Gjykata e Nurnbergut, Tokios etj.) dhe ndikimin e tyre në vazhdimësi. - Evidencon aktivitetin diplomatik gjatë Luftës së Dytë Botërore (takimet, konferencat) dhe vendimet e Koalicionit antifashist për sistemin e ri ndërkombëtar të pasluftës. - Vlerëson kontributin dhe rolin e SHBA–ve në Luftën e Dytë Botërore dhe pas saj. - Analizon faktorët e ndarjes në blloqe, shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë dhe shpërthimet e nxehta të saj (krizat dhe luftërat lokale). - Vlerëson rolin e Bashkësisë Evropiane në ruajtjen e paqes dhe përparimin ekonomik e kulturor evropian.
<p>Proceset shoqërore</p>	<p>Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qartëson rrethanat (e brendshme dhe të jashtme) të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. - Përshkruan përfshirjen e Kosovës në Luftën e Dytë Botërore, zonat e pushtimit dhe pozitën e shqiptarëve dhe komuniteteve tjera në to. - Krahason qëndrimin (politikën) e Koalicionit Antifashist dhe atë të Koalicionit Nazifashist ndaj

		<p>Shqipërisë dhe shqiptarëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizon programet dhe rolin e formacioneve politiko-ushtarake shqiptare gjatë LDB dhe vizionin e tyre për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në përfundim të luftës. - Argumenton kontributin e shqiptarëve në luftën antifashiste. - Analizon kontekstin historik të instalimit të sistemit komunist në Shqipëri dhe fazat e thellimit të tij. - Argumenton transformimet shoqërore dhe jetën e përditshme të qytetarit të zakonshëm në sistemin komunist dhe pasojat e trashëguara të tij. - Evidencon rolin e arsimit, shkencës dhe kulturës në sistemin komunist.
	<p>Evropa Juglindore gjatë periudhës komuniste</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon rolin e faktorit ndërkombëtar në përfshirjen e shteteve ballkanike në Bllokun Lindor. - Shpjegon arsyet e largimit të Jugosllavisë nga ky Bllok dhe pozitën ndërkombëtare të saj. - Evidencon përfshirjen e shteteve komuniste të Ballkanit në organizmat ekonomik e ushtarak të Bllokut Lindor. - Përshkruan efektet e pushtetit komunist në planin shoqëror, ekonomik dhe kulturor në këto shtete me theks të veçantë në Jugosllavi . - Debaton për shkaqet e rënies së sistemit monist-komunist në Ballkan dhe në veçanti për shpërbërjen e Jugosllavisë.
<p>Proceset shoqërore</p>	<p>Kosova 1945-2008: Lindja e një shteti të ri evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan fazën e ripushtimit, aneksimit dhe instalimit të sistemit komunist jugosllav në Kosovë - Përkufizon politikën e regjimit komunist

		<p>jugosllav ndaj shqiptarëve 1945-1966 dhe vlerëson Lëvizjen kombëtare të shqiptarëve (grupet dhe personalitetet e ndryshme, si: Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare – NDSH, Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve-LRBSH etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerëson të arriturat në rrafshin shoqëror, arsimor, kulturor dhe politik të shqiptarëve në periudhën 1966-1981. - Evidencon masat e regjimit jugosllav-serb për degradimin politik, kushtetues, arsimor, shëndetësor dhe ekonomik të Kosovës 1989-1999 dhe vlerëson rezistencën e shqiptarëve ndaj tyre. - Përshkruan veprimet konkrete politike, diplomatike, të shqiptarëve dhe komuniteteve tjera (boshnjak, turk etj.) dhe vlerëson Luftën Çlirimtare për shtetin e pavarur të Kosovës. - Vlerëson rolin e Diasporës shqiptare për mbijetesën ekonomike të popullit të Kosovës, për çlirimin dhe shtetndërtimin e saj. - Analizon rolin e faktorit ndërkombëtar në çlirimin e Kosovës dhe shtetndërtimin e saj 1989-2008.
	<p>Ramja e rendit bipolare në botë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton arsyet e reformave në BRSS: Perestrojka dhe Glasnost. - Evidencon lëvizjet politike dhe shoqërore (disidenca) në shtetet komuniste dhe rolin e tyre në rënien e komunizmit. - Analizon rolin e fuqive të mëdha demokratike në shthurjen e Bllokut Komunist Lindor.

		<ul style="list-style-type: none"> - Evidencon efektet globale të rënies së botës bipolare. - Kupton jetën e përditshme të njerëzve gjatë procesit të tranzicionit shoqëror, ekonomik e kulturor në ish- shtetet komuniste.
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3 . Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet	
	<p>1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone, monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.</p> <p>2. Analizon dhe vlerëson shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Integrimet evropiane dhe Evropa Juglindore	<ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon parakushtet dhe procesin e integrimi evropiane nga një Bashkësi në një Bashkim Evropian - Analizon të drejtën, obligimet dhe fazat e anëtarësimit të shteteve evropiane në Bashkimin Evropian. - Identifikon mekanizmat vendimmarrës të Bashkimit Evropian dhe analizon mënyrëne e funksionimit të tyre. - Përkufizon Ballkanin Perëndimor dhe arritjet e tij në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. - Vlerëson aspiratat dhe përpjekjet e shqiptarëve për anëtarësim në BE.
Siguria kolektive (OKB, Këshilli i Evropës, KSBE/OSBE)	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon mekanizmat e sigurisë dhe bashkëpunimit Evropian dhe Botëror. - Shpjegon funksionimin e OKB-së dhe rolit të saj 	

		<p>në mbrojtjen e paqes botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizon fushëveprimin dhe funksionimin e mekanizmave të KSBE-së/OSBE. - Argumenton dhe vlerëson rolin dhe rëndësinë e NATO-s në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në botë.
Vendimmarrja dhe institucionet	RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme	
	1. Analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimmarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëta, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha tëndryshme historike.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Ideologjitë dhe shtetet totalitare (komunizmi, nacizmi, fashizmi)	<ul style="list-style-type: none"> - Specifikon format e sistemeve totalitare. - Shpjegon shkaqet e lindjes së sistemeve totalitare në vende të ndryshme. - Analizon arsyet e ngadhënjimit të komunizmit, nacizmit e fashizmit në periudhën mes dy luftërave botërore.
	Vendimmarrja në shtetet demokratike	- Vlerëson përpjekjet dhe vlerat demokratike në raport me sistemet totalitare.
Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5 Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin qëndrueshëm	
	1. Bazuar në analizën paraprake, identifikon një problem konkret aktual të ndotjes në mjedisin e tij, planifikon punën, mbledh të dhëna, analizon dhe interpreton ato dhe vjen me një sërë zgjidhjesh të qëndrueshme.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Sfidat dhe perspektivat e globalizimit	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon sfidat bashkëkohore nëpër të cilat po kalon njerëzimi. - Krahason dhe analizon sfidat dhe perspektivat e

		<p>globalizimit (terrorizmi, ngrohja globale, emigracionin etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Argumenton rolin e globalizimit në jetën e përditshme të njerëzve dhe ndërvarësinë e tyre. - Vlerëson te arriturat shkencore e teknike ne funksion të zhvillimit ekonomik-shoqëror.
--	--	---

Udhëzime metodologjike

Realizimi i programit lëndor kërkon përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie të suksesshme. Rekomandohet që mësimdhënësit të lexoj me kujtesë rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së historisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por edhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore.

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e Historisë, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u harmonizuar njera me tjetrën në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulare.

Suksesi i nxënësve në lëndën e historisë është i ndërlidhur dhe varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, forma të shumëllojta të punës duke respektuar personalitetin dhe stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimin të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, ushtrime, punë individuale e grupore, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Duke pasur parasysh veçoritë e lëndës, preferohet që aty ku është e mundur të përdoren: loja në përgjithësi dhe loja me role në veçanti, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializim; Intervista dhe rrëfimet (historia orale) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës gjë që zhvillon shkathtësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit; bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, si forma që mund të realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore, gjithmonë në bashkëpunim me nxënësit, ku mësimdhënësi duhet të ketë rol këshillues, orientues.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësve për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që iu ndihmon atyre në kompletimin e thithjes së informacioneve dhe

përgatitjes për angazhim të suksesshëm. Gjithashtu organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve . Ato mundësojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit .

Mësimdhënësi duhet të merr parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënit e integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integrale, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomenet që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëshme, prandaj nevojitet bashkëpunim midis mësimdhënësve të lëndës së historisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi , ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndërkurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Këto tema mund të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull kur trajtohen temat për qytetërimet, institucionin e vendimmarrjes ose demokracinë ato mund të ndërlidhen me edukimin për qytetari demokratike, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohen në kontekste dhe periudha të ndryshme, si ka ndodhë dhe evoluimi i tyre etj. E njëjta qasje vlen edhe në trajtimin e temave tjera si edukimi për paqe, që mund të ndërlidhet me përmbajtje si diversiteti në shoqëri, toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa, dinjiteti njerëzor. Po ashtu edhe tema e globalizimit dhe ndërvarësisë mund të ndërlidhet fare mirë me trajtimin e çështjeve ekonomike, arsimore. Tema e edukimit për media mund të shërbej në kontekstin e hulumtimit të nxënësve për përmbajtje të ndryshme duke siguruar materiale, fotografi, harta të ndryshme etj. Ndërsa çështja e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm mund të ndërlidhet me raportet dhe ndërvarësinë njeriut me mjedisin jetësor që në fillimet e shoqërisë njerëzore dhe nëpër etapat tjera historike që trajtohen në këtë klasë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar ta arrijë tek nxënësi. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektiv të vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësve në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të testimit, si ai verbal, jo verbal, vlerësimi i nxënësve në punë grupore, i punës me projekte, hulumtimet etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve dhe shkallës së zhvillimit së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit pikë referimi janë rezultatet e lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve së tyre.

Qasja e kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtuqjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Që në këtë moshë është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësve.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synoj të arritje sa më të larta.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Krahas teksteve mësimore bazë sugjerohet që gjatë procesit mësimor, nxënësit dhe mësimdhënësit të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive siç janë: fletoret e punës, materiale tjera alternative, broshurat, atlaset, hartat, enciklopeditë, softuerët arsimorë, vizitat e ndryshme njohëse, si, p.sh., monumentet shoqërore, kulturore dhe natyrore.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënësit. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e produkteve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA

Kurrikula lëndore/programi mësimor

TIK (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

TIK (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e kurrikulës:” Jeta dhe Puna” synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe punë. Përmes lëndës së TIK-ut, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në fushën “Jeta dhe Puna” në klasën e X lëndë bartëse është Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ku edhe përfshihen disa nga konceptet kryesore të kësaj fushe si Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK, Punë dhe edukim për ndërmarrësi, Këshillim dhe orientim në karrierë, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Teknologjia e informimit dhe e komunikimit - për klasën e dhjetë (X) është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprahe nga kjo fushë. Kjo lëndë nxënësit i aftëson me teknologjitë moderne të informimit dhe të komunikimit siç janë: puna me programet aplikative të avancuara, puna me pajisjet tjera përcjellëse moderne, demonstrimi i shkathtësive në përdorimin e këtyre pajisjeve dhe programeve përkatëse. Gjithashtu përfshinë edhe sistemet e avancuara që mundësojnë grumbullimin, organizimin, ruajtjen, përdorimin dhe transmetimin e informacioneve në forma të ndryshme. Kjo nënkupton edhe komunikimet audio (zëri) dhe video (grafika), si dhe përdorimin e multimedive interaktive. Në klasën e dhjetë, nxënësit gjithashtu marrin dituri nga programi aplikativ për përpunim tabelar dhe grafik të të dhënave, mundësitë multimediale në sistemet kompjuterike si dhe nga programi aplikativ për përgatitjen e prezantimeve.

Nëpërmjet TIK-ut, nxënësit krijojnë shprehi dhe shkathtësi gjatë punës teorike dhe praktike për kërkim të pavarur të informacioneve nga të gjitha fushat kurrikulare. Në klasën e dhjetë nxënësit gjithashtu do të zbatojnë analizimin e të dhënave, formulat dhe funksionet, krijimin e prezantimeve, multimediat, duke demonstruar me raste konkrete. Lënda e TIK-ut ka një lidhje të veçantë me të gjitha fushat e Kornizës Kurrikulare e cila iu mundëson lëndëve avansimin dhe promovimin modern të tyre përmes TIK-ut. Përdorimi i TIK-ut ndihmon në përvetësimin më të mirë të lëndëve tjera duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse.

Qëllimi i lëndës

Me përdorimin e TIK-ut nxënësit zhvillojnë aftësi për t’iu qasur dhe menaxhuar informacioneve të ndryshme, për të krijuar, analizuar dhe prezantuar informacionet, për të zgjidhur probleme, për të marrë vendime, për të komunikuar, për të shprehur dhe arsyetuar propozimet e dhëna etj.

TIK-u dhe përdorimi i tij nxënësve iu ndihmon që njohuritë dhe shkathtësitë e zhvilluara t’i transferojnë me sukses në mjedisin ku jetojnë dhe veprojnë. Nxënësit mësojnë të përdorin TIK-un me kujdes, duke kuptuar mundësitë dhe kufizimet e tij, si dhe ndikimin tek individët, grupet dhe më gjerë.

Nëpërmjet lëndës së TIK-ut nxënësit do t'i njohin dhe t'i përdorin pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit si dhe të tregojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për punë dhe ndërlidhjen e shkathtësive personale me karrierën e tyre, edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm, të cilat kanë të bëjnë me analizimin, përpunimin e të dhënave në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore.

Përmes lëndës së TIK-ut rritet niveli për nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme duke përfshirë konceptet bazë të fushës “Jeta dhe Puna”.

Qëllimet kryesore të lëndës së TIK-ut të nxënësit janë:

- Zhvillimi dhe thellimi i njohurive në lëminë e TIK-ut dhe rëndësia e saj në jetë dhe punë.
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit, analizimit dhe prezantimit të informacioneve nga fusha e TIK-ut.
- Formulatat, funksionet, grafikët dhe prezantimet me përdorimin e programeve aplikative kompjuterike, janë gjithashtu thelbësore në praktikat teknologjike për përcaktimin dhe sqarimin e ideve dhe zgjidhjeve të propozuara.
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë.
- Aftësimi për mësim gjatë tërë jetës.

Temat dhe rezultatet dhe të nxënësve

Nxënësit në klasën e dhjetë arrijnë rezultatet e të nxënësve të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalin nga rezultatet e të nxënësve të fushës (RNF) Jeta dhe Puna, të shkallës së pestë (Shk 5) në kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL
Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK	<p>RNF:</p> <p>1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.</p> <p><i>1.1. Analizon ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.</i></p> <p><i>1.2. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.</i></p> <p>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë</p> <p><i>2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënësve.</i></p> <p>4. Përdorimi i TIK-ut për të avansuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.</p> <p><i>3.1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese.</i></p> <p>8. Komunikimi për jetë dhe punë.</p>

<i>4.1. Përdorë multimedia për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.</i>	
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Formulat dhe Funksionet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpjegon veprimet në lidhje me formulat. ▪ Lokalizon vendosjen e formulave në qeli. ▪ Cekë shprehjet aritmetikore. ▪ Demonstron përmes shembujve përdorimin e disa funksioneve elementare, insertimin e tyre (përdorimi i funksioneve të ndryshme, llogaritja e shumës, e prodhimit etj.). ▪ Përdorë funksione për punën me tekst, funksionet financiare dhe shpjegon rëndësinë e tyre. ▪ Identifikon zgjidhjen e problemeve gjatë përdorimit të funksioneve.
Analizimi i të dhënave, rregullimi i faqeve, shtypja dhe grafiku	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpjegon sortimin rritës dhe zvogëlues si dhe bën filtrimin e të dhënave. ▪ Tregon hapat për printimin e të dhënave. ▪ Emërton fillimin dhe fundin e faqes. ▪ Demonstron organizimin e fletës punuese. ▪ Ndërlidh hapat që duhet të përdoren për aktivizimin e sistemit grafik (insertimi i një grafiku për tabelën e dhënë). ▪ Shpjegon llojet e grafikëve duke demonstruar hapat e insertimit të tyre.

	Krijimi i prezantimeve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason përparësitë e aplikacionit PowerPoint për prezantim me aplikacionet e tjera. ▪ Tregon krijimin e një prezantimi të një teme të caktuar duke pasur parasysh edhe përdorimin e teknologjisë për të realizuar prezantimin. ▪ Tregon mënyrën e editimit të të dhënave në sllajde duke pasur parasysh stilin e përdorur, madhësinë e tij dhe vendosjen e tekstit në pozitën e caktuar. ▪ Interpreton dizajnimet e ndërtruara duke dhënë sqarime për secilin sllajd të dizajnuar për prezantim. ▪ Shpjegon rëndësinë e paraqitjes së tekstit në sllajde. ▪ Tregon se gjatë krijimit të prezantimit në PowerPoint përveç teksteve mund të shfrytëzon edhe materiale të tjera multimediale, si: fotografi, incizime multimediale, vizatime, animacione etj. ▪ Demonstron përdorimin e efekteve në sllajde. ▪ Diskuton rëndësinë e prezantimit. ▪ Përshkruan hapat gjatë fazës së printimit.
--	------------------------	--

	Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tregon për avansimin dhe përparësitë e multimedias. ▪ Tregon për elementet themelore të grafikës, përpunimit të fotografive (figurave). ▪ Dallon kompjuterët të cilët shfrytëzohen gjatë dizajnit ose prezantimit të sekuencave multimediale. ▪ Dallon cilësinë e prezantimit të një materiali multimedial. ▪ Tregon krijimin e sekuencave multimediale duke përdorur programet përkatëse. ▪ Krijojnë sekuenca filmike dhe bëjnë prezantimin e tyre duke marrë për bazë punët në dizajnim, përpunim grafik dhe projektim.
Këshillim dhe orientim në karrierë	<p>RNF: 3. Këshillim dhe orientim në karrierë</p> <p><i>3.1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.</i></p> <p><i>3.2. Ndërlidhë njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.</i></p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Karriera ime	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tregojnë për qëllimet dhe planifikimet e karrierës “se çfarë janë të aftë të bëjnë”. ▪ Shpjegojnë se si mund t’i arrijnë qëllimet për të zhvilluar karrierën. ▪ Përdorin pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë. ▪ Tregojnë për azhurnimin/përditësimin e portfolios personale. ▪ Përdorin aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV, përzgjedhin formën e duhur të CV-së dhe ndërtojnë përmbajtjen e saj.

Punë dhe edukim për ndërmarrësi	RNF: 5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë. <i>5.1. Prezanton ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës.</i> 7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme. <i>7.1. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacionin dhe kërkesat e tregut të punës.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Ndermarrësi i ri. Tregu i punës dhe përgatitja për hulumtimin e tregut të punës.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan rolin e tregut. ▪ Hulumton tregun ▪ Kërkesat dhe nevojat në kohë dhe vend të caktuar. ▪ Prezanton në power point kërkesat dhe nevojat në kohë dhe vend të caktuar.
Edukim për zhvillim të qëndrueshëm	RNF: 9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit <i>9.1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Përdorimi i teknologjisë me shpenzim të ulët të energjisë elektrike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon pajisjet teknologjike duke bërë krahasime rreth shpenzimeve energjetike dhe procesit të shpejtësisë së tyre të përpunimit.
	Ndikimi i Wifi në shëndetin e njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tregon rëndësinë e pajisjeve të Teknologjisë Informative në shëndetin e njeriut.
	Sulmet kibernetike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përpunon informata rreth sulmeve kibernetike dhe shpjegon rëndësinë e tyre. ▪ Tregojnë për rreziqet nga interneti.

Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve mësimore që përcaktohen në lëndën e TIK-ut mund të përdoren metoda të ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka fusha, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si:

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore duke përfshirë ligjërimi, demonstrimi dhe puna individuale dhe grupore.
2. Ligjërimi i përmbajtjes programore në klasë apo kabinet të bëhet me anë të prezantimeve kompjuterike e jo përmes tabelës. Inkurajohet edhe përdorimi i tabelës elektronike gjatë ligjërimin.
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të ideve dhe shkathtësive (puna interaktive).
4. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara.

TIK-u mund të zhvillohet në forma nga më të ndryshmet, duke shfrytëzuar metodat interaktive të cilat kombinohen me format, si: Demonstrime përmes mjeteve teknologjike, punë individuale në grupe të vogla, puna me projekte.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare në kuadër të fushës” Jeta dhe Puna” përkatësisht lëndës së TIK-ut si qëllim kryesor ka realizimin e çështjeve ndërkurrikulare që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK. Gjatë fazave të planifikimeve të identifikohen rezultatet e ndryshme që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave dhe rezultateve të fushave, përmes temave të përbashkëta. Çështjet ndërkurrikulare që përfshihen në lëndën e TIK-ut janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Identifikimi i temave të përbashkëta nga lëndët e ndryshme në 7 fushat kurrikulare ndihmojnë nxënësit në arritje e rezultateve të parapara në KK dhe KB.

Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft e rëndësishme e mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.

Lënda e TIK-ut për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe punës, konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, që përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

Buletini i pjesëmarrjes, përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon dhe sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit, është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit.

Portfolio e nxënësit është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve.

Portfolio elektronike është një formë e cila tashmë mundëson integrimin e teknologjisë në detyrat dhe aktivitetet e nxënësve. Vlerësimi i të nxënësve ka shumë metoda të cilat mund t'i përdorim gjatë realizimit si p.sh.: testimi, vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike, kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe.

Materiale dhe burime mësimore

Për realizim më të suksesshëm të lëndës së TIK-ut duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, internet, enciklopedi, softuerë arsimore, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune.

Mësimdhënësit mund të krijojnë portofolio, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

FUSHA KURRIKULARE: EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

(Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

(Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Edukata Fizike Sportet dhe Shëndeti është pjesë domethënëse e veprimtarisë njerëzore pasi kapin një hapësirë shumë të rëndësishme dhe me ndikim të padiskutueshëm në gjendjen psiko-sociale, e fiziko shëndetësorë të njeriut.

Veprimtaria fizike-lëvizore dhe sporti janë konsideruar gjithnjë si pjesë e pandarë e formimit fizik dhe mendor, pasurisë shpirtërore dhe kulturës njerëzore në të gjitha etapat e jetës.

Lënda Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti synon të përforcojë njohuritë e çdo nxënësi/etj dhe të sigurojë përvoja, aftësi dhe njohuri të reja, të cilat do të zgjerojnë edhe më tej formimin kulturor, fizik e shëndetësor. Njohja, realizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë fiziko-lëvizore e sportive nga të gjithë nxënësit është një formë e të vepruarit në grup, dhe ndikon në përforcimin e marrëdhënieve shoqërore dhe komunikuese.

Edukata Fizike Sportet dhe Shëndeti synon që përmes studimit edhe të lëndëve të tjera në fushat sociale, shkencore, si dhe të arteve të arrihet krijimi dhe plotësimi i përgjithshëm i kulturës dhe formimit të nxënësve, formim i cili arrihet përmes disa linjave kryesore të procesit mësimor.

Organizimi dhe realizimi i kësaj lënde do t'i ndihmojë nxënësit të vlerësojnë efektet e pozitive të saj në shumë drejtime, jo vetëm në aspektin shëndetësor dhe fizik por edhe në atë të bashkëpunimit, zgjerimit të njohurive për kulturat e rajoneve të vendeve të ndryshme të cilat kontribuojnë në krijimin e një mjedisi më shoqëror në nivel lokal dhe global.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti është të zhvillojë, të stimulojë një shëndet sa më të plotë të nxënësit në aspektet fizike, psikologjike, psikike dhe shoqërore. Përmes kësaj lënde synohet promovimi i aktivitetit të rregullt fizik, edukimi për stilin shëndetshëm të jetës, menaxhimi i stresit, aftësia për marrë vendime të drejta dhe të jete i shkathtë për përdorim të drejt dhe adekuat të mjedisit ku jeton .

Temat dhe rezultatet dhe të nxënit

Nxënësit në klasën e dhjetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Edukata Fizike Sportet dhe Shëndeti i shkallës së pestë të kurrikulës (Shk 5) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Mirëqenie plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale	RNF: <i>1.Përdor strategji adekuate në situata të vështira fizike, psikike, emocionale dhe sociale duke vepruar në mënyre të koordinuar me përgjegjësi në situata të jashtëzakonshme.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Ruajtja dhe përparimi i shëndetit fizik dhe psikik	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon situatat stresuese dhe njeh simptomat e stresit në aktivitete fizike sportive ,çrregullimet në frymëmarrje, sjellje të pakontrolluara, problem në përqendrim. ▪ Menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë dhe pas aktiviteteve sportive. ▪ Identifikon shenjat e mbilodhjes gjatë dhe pas veprimtarive fizike ▪ Aplikon rregullat e sigurisë gjatë ushtrimeve specifike për aktivitetet e ndryshme sportive. ▪ Zbaton rregullat fillestare të dhënies se ndihmës së parë në raste të traumave të ndryshme që mund të ndodhin gjatë ushtrimeve me veprimtari fizike e sportive
Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive	RNF: <i>1. Vlerëson rëndësinë dhe rolin e trashëgimisë kulturore sportive</i> <i>2. Merr pjesë në aktivitetet e sforcuara fizike dhe sportive dhe shfaq qëndrim pozitiv për ndikimin e tyre në ruajtjen e shëndetit.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Historiku dhe zhvillimi i sporteve	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njeh kuptimin dhe lashtësinë historike të edukimit fizik, sportit dhe vlerat e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore; ▪ Përshkruan përmbajtjen dhe organizimin e lojërave olimpike, vlerën e tyre historike e shoqërore, simbolet dhe kuptimin e tyre . ▪ Njeh emrat e sportistëve olimpikë shqiptarë, figurave të shquara nga qyteti apo krahina e tyre. ▪ Përdorë burimet të ndryshme që japin informacion për aktivitetet, historinë e sportit, aktivitetet rekreative, fitnessin, si dhe pajisjet e teknologjitë e aplikuara.

	Sportet individuale dhe rëndësia e tyre	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon dhe zbaton rregullat e lojërave në sportet individuale. • Përforcon dhe demonstroi elementet teknike të disiplinave të atletikës • Përforcon dhe demonstroi teknikat e gjimnastikës pa vegla me vegla në vegla dhe gjimnastikës ritmike. • Përforcon elementet teknike taktike në pingpong, tenis, badminton • Demonstroi elementet taktike në sulm dhe mbrojtje në sportet luftarake. • Diskuton, përshkruan rëndësinë e qëndrueshmërisë, forcës, shpejtësisë, fleksibilitetin për zhvillimin e trupit dhe shëndetit. • Përforcon elementet teknike në ujë. • Përforcon elementet teknike në borë. • Kupton vlerat estetike të kulturës fizike
	Sportet kolektive	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon dhe zbaton rregullat e lojërave sportive. • Aplikon dhe përforcon elementet teknike bazë të lojërave sportive. • Aplikon taktikë të thjeshta në sulm dhe në mbrojtje gjatë lojërave sportive • Zhvillon teknika të avancuara në sportin e zgjedhur.
Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës	<i>RNF: 3. Demonstron shkathtësi për përzgjedhjen dhe përgatitjen e ushqimeve dhe analizon ndikimin e reklamave dhe mediave për ushqyerje të shëndetshme.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Ushqimi dhe të ushqyerit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Diskuton rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete fizike dhe zgjedhjen e ushqimit të shëndetshëm. ▪ Përshkruan vlerat ushqyese të ushqimit natyral me përmbajtje sasiore dhe cilësore.
Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri	<i>RNF: 4. Përdorë strategji për të bërë zgjedhje bazuar në informata të drejta të cilat mund t'i aplikojë në situata sfiduese, përfshirë edhe presionin e bashkëmoshatarëve</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Substancat që krijojnë e	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shenjat e varësisë nga drogat, alkooli,

	varshmëri	<p>duhani si dhe pasojat në organizmin e njeriut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezanton strategji për ruajtjen nga substancat të cilat krijojnë varshmëri.
Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	<i>RNF: 5. Demonstron shkathhtësi për përdorim të drejt dhe adekuat të mjedisit për avancimin shëndetit</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Mjedisi si faktor për avancimin e shëndetit fizik	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorë mjedise të ndryshme natyrore për zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe sportive • Propozon dhe merr pjesë në iniciativat e ndryshme në shkollë dhe komunitet për rregullimin e terreneve sportive për zhvillimin e aktiviteteve fizike

Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në Lëndën Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti mund të përdoren metodat e ndryshme me qëllim të arritjes së rezultateve të kompetencave të cilat metoda janë të përbashkëta për të gjitha lëndët përfshirë edhe lëndën Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti. Në kuadër të kësaj fokusi i mësimdhënësit duhet të jetë në zbatimin e metodologjive të cilat sigurojnë një mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit siç janë:

- Mësimdhënia dhe nxënia me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirja;
- Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në qasjen e integruar;
- Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në arritjen e kompetencave;
- Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar;

Për arritjen e rezultateve të kompetencave të fushës për veç metodave të përbashkëta secila lëndë mësimore ka edhe veçantitë e saja për organizimin e punës mësimore.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e nxënësit.

Organizimi i mirë i procesit të mëimit të kësaj lënde do të thotë që nxënësit të vendosen edhe në situata konkrete praktike ku zhvillojnë dhe zbatojnë elementët lëvizorë e sportivë. Loja dhe sporti janë aktivitete që dominojnë shumicën e jetës së tyre shkollore dhe jashtë saj, duke u zënë pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke krijuar aftësi, shkathhtësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme.

Në orët e mëimit të Edukatës Fizike Sportet dhe Shëndeti duhet t'i vihet theks i veçantë në mbajtjes së higjienës personale para, gjatë dhe pas aktiviteteve fizike.

Motivimi i nxënësve për aktivitete sportive mbetet ndër qëllimet kryesore të mësimdhënësit. Ai këtë duhet ta arrijë përmes zgjedhjes përkatëse të përmbajtjeve programore, përkatësisht me nxitjen dhe vlerësimin e përparimit në arritjet e nxënësve. Detyrat e shtruara nga mësimdhënësi duhet të jenë të tilla që nxënësi të mund t'i kryejë ato. Mësimdhënësi në këtë grup-moshë, duhet të marrë parasysh interesimin dhe talentin e nxënësve për degë të caktuara sportive në mënyre që të stimuloj dhe përkrah arritjen e rezultateve sa më të larta. Me interes është organizimi i mësimin në grupe, sipas aftësive dhe nevojave, duke pasur kujdes që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe të përfitojnë maksimalisht bazuar në mundësitë individuale të tyre.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të lëndës është një aspekt me shumë rëndësi pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:

- **Globalizimi dhe ndërvarësia** (i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha)
- **Edukimi për media** (i referohet përdorimit të mediave për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes mediave tradicionale dhe digjitale, kritiken ndaj mediave, gjuhën e mediave dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediat dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë)
- **Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë** (edukimi për konsumim dhe kursim; respekti për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërmbajtja, aftësia për marrëveshje; vetiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen).
- **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm** (i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global)

Në përgjithësi rezultatet e fushës i prekin çështjet ndërkurrikulare andaj kujdes do t'i kushtohet trajtimit adekuat edhe në njësitë mësimore. Megjithatë mësimdhënësit gjatë punës se tyre duhet t'i kushtojnë kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit të analizojnë, tema apo njësitë mësimore se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen në mënyre që të sigurohet mësimdhënie e integruar të trajtohet nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme e cila mundësohen edhe arritjen e kompetencave të përcaktuara me KK.

Udhëzime për vlerësim

Lënda Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e shëndetit, konceptet dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, shkathtësitë por edhe qëndrimet dhe vlerat dhe sjelljet e nxënësve.

Mësimdhënësi/ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi për shembull:

- Përdorimin e fjalëve e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Korrigjim i lëvizjeve të gabuara me takt.
- Vlerëson përdorimin adekuat të veglave
- Vlerëson veprimet lëvizor mbi bazën e arritjeve individuale;
- Vlerëson shpejtësinë në distanca të shkurtra dhe të mesme mbi bazën e arritjeve individual;
- Vlerësim kompleks të ushtrimeve me pikë.
- Vlerësim kompleks të ushtrimeve të veçanta me pikë.
- Vlerësimi me pikë i elementeve kompozuese në gjimnastikë sportive dhe ritmike
- Vlerësimi i elementeve teknike me pikë.
- Vlerësimi me teste për njohuri mbi edukimin shëndetësor.
- Vlerësimi në bazë të listës së kontrollit

Këtyre vlerësimeve mund t'i shtohet edhe vlerësimet mbi pjesëmarrjen në veprimtaritë e ndryshme sportive.

Në angazhimin e nxënësve me grupe apo skuadra të vogla, mësimdhënësi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Si rregull nxënësit dhe mësimdhënësi duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive dhe aftësive të fituara të orëve të kaluara. Herë pas here mësimdhënësi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij. Vlerësimi me shkrim (vetëm për linjën e njohurive) shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Portofoli i nxënësit si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një përmbledhje e performancës së nxënësit gjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë detyra tematike (artikull sportiv, programe sportive, planifikime të aktivitetëve sportive), foto dhe CD të demonstrimit të aftësive lëvizore për linja të ndryshme të programit, angazhime në veprimtari të ndryshme shkollore.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë nxënësit dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të krijojnë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për jetë. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënit, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera, të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza, raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.